



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
II. HYRJA	13
a. Titulli: Projekt Raport Auditimi mbi auditimin e “Përputhshmërisë” në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës.....	13
b. Marrësi:.....	13
c. Objektivat dhe qëllimi:.....	13
d. Identifikimi i çështjes:.....	13
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:	13
f. Përgjegjësitë e audituesve:.....	14
g. Kriteret e vlerësimit:	14
h. Standardet e auditimit:	15
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	16
1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.	16
2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	22
3. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomik-financiar në qendër dhe në njësitë e vartësisë.	28
4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	32
5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).	47
6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	54
7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave	62
8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.	93
9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale	98
10. Përdorimi i subvencioneve shtetërore	104
11. Hartimi, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre.	113
12. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr.8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.	120
13. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të H.Sh.	121
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	130
A. MASA ORGANIZATIVE	131
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	153
C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.	156
VI. ANEKSET	157
A. Shkurtime	157



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II.a. Përshkrimi i shkurtër i projektit.

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

II.b. Gjetjet kryesore të konstatuara.

Mos zbatim i rekomandimeve të KLSH, si dhe krijim provizione në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore në funksion të tyre, ardhur nga diziformimi që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i njësisë ekonomike, për krijimin e provigjoneve për debitorët pa shpresë arkëtimi”, në vlerën 44,321,985 lekë. Konkretisht:

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 201.12.2018 dhe vendimi i Administratorit të Shoqërisë nr.14, datë 05.11.2018, për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, është marrë mbi bazën e informacionit pa numër protokollit, datë 11.10.2018 i firmosur nga SH.Xh. me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i Njësisë Ekonomike.

Ky informacion është diziformues dhe i pa vërtetë (i rrem) për sa i përket: Zbatimit të procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 24,280,462 lekë nga Kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe Shoqërtia “S.S.” ShPK. Durrës për arkëtimin e vlerës 20,041,523 lekë nga personi fizik jo tregtar Xh.GJ..

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionim si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron qartazi një krizë të mprehtë likuiditeti të Shoqërisë “H.Sh.”. Për posë krizës, Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj, në vlerën 1,895,812 mijë lekë .

Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, jo vetëm është në krizë të mprehtë likuiditeti, por është plotësisht e falimentuar.

Më date 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat : Raiffeisen Bank (7 numra llogarie), ABI Bank (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Kombëtare Tregtare (11 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Credins (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Pro Credit Bank (1 numër llogarie), Fibank (2 numër llogarie), Alpha Bank (2 numër llogarie), Union Bank (2 numër llogarie), Tirana Bank (1 numër llogarie), Intesa San Paulo (5 numra llogarie) Veneto Bank (1 numër llogarie), Societe Generale (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra llogarie me urdhëra sekuestro nr.11 në vlerën totale 44,938,145 lekë .

Referuar sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Përpos sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk i është dhënë vëmendja e duhur në investime shtetërore, që s’duhet ti mungonin si e vetmja shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtareve, ashtu siç i jepen infrastrukturës automobilistike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot, datë 20.06.2018, ka çuar për indicie për ndjekje penale për përdorimin e subvencionit për vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Aplit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr (11-2019-1312)309 datë 06.03.2019 të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe **pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale** nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019

Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 58 të nenit 5 të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet përkufizimi i rrjetit hekurudhor konkretisht: *“Rrjet” janë linjat, stacionet, terminallet dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.*” Pra rrjeti nuk është veprimtari (subjekt) por objekt.

Referuar sa mësipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuzë dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga H.Sh., duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

-Mos zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., me risk të lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, që vjen nga mos mbikëqyrja e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie Konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.” ShPK., A., Shoqëria “H.Sh.” ShA. si dhe po bëhet gati të filloj operatori “A.”.

-Mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penaltetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që H.Sh., ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve,.

Janë kontabilizuar vetëm principiali mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë dhe jo penaltetet.

- Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penaltetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penaltetet 211,431 euro.

- UIC (Internation+al union of railëays) dhe SK (serbia cargon) kanë organizuar në 18/09/2018 forumet e debitorëve/kreditorëve, për të cilat janë kërkuar borxhet e hekurudhave të Byroja e borxheve (Beograd Serbi).

Ministria përgjegjëse merr përsipër administrimin e borxhit sipas Neni 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”. Në referencë me nenin 12.4 të ligjit të sipërpërmendur, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar (të përlllogaritur) deri në hyrjen në fuqi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SH.A DURRËS

të këtij ligji. Për këtë qëllim, H.Sh. ka dorëzuar bilancet (31.12.2017) në formë zyrtare pranë Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë, duke përfshirë çështjet e transportit hekurudhor dhe pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si aksionere e vetme e kësaj shoqërie. Deri më datë 31.07.2019, datë në të cilin përfundoj auditimi, borxhet ndaj hekurudha të huaja rëndojnë mbi hekurudhën shqiptare (janë në kontabilitetin e kësaj shoqërie). Nuk ka asnjë veprim konkret, nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

-Përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) është bërë pjesërisht nga punonjësit e H.Sh.. Përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, deri në 31.07.2019 datë në të cilën përfundon auditimi, nuk është bërë e qartë nga punonjësit mënyra e llogaritjes. Përfshirja në kontabilitet ka ndikuar direkt në rezultatin financiar, duke krijuar vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet H.Sh. ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

Përgjithësisht kontratat e lidhura me transportuesit hekurudhor nuk janë plotësuar me të gjitha gjenalitet konformë kodit civil dhe librit tarifor (Ato nuk kanë të përcaktuar afatin, sasinë, distancë dhe tarifën).

- Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të ardhurat në përgjithësi janë korrekte dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Dobësitë e identifikuara në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit dhe kontabilitetin, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë, si psh harxhimin e karburantit për shkak të makinerive të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, dëmshpërblimet nga zgjidhjet e pa arsyeshme të kontratave të punësimit, transportit të mallrave dhe mungesën e një rregulloreje për provizione etj.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nuk ka ndërmarr *aktivitete shitesë* për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut, pasi.

- Gjurmët e auditimit nuk janë hartuar, miratuar dhe arkivuar nga çdo njësi biznesi.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, funksionon në nivel Drejtorie, por jo për çdo njësi biznesi, si dhe regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi biznesi.

-Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Sektorët nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Ka struktura të tepërta që duhet të suprimohen.

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës.

-Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe janar-maj 2019 me vendimin nr.7 datë 08/05/2019 i cili përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 gërma a.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Kontabiliteti i njësisë mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve nuk janë hartuar nga çdo njësi.

-Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe janar-maj 2019 me vendimin nr.7 datë 08/05/2019 i cili përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.

-Kontabiliteti i njësisë mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve nuk janë hartuar nga çdo njësi.

- Në 2 procedura prokurimi për vlerën 22,330 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 7 procedura prokurimi për vlerën 63,946 mijë lekë, në urdhrat e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, por është cilësuar, ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. ShA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri, në kundërshtim me VKM nr.914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”.

-Për 4 procedura prokurimi për vlerën 46,713 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 3 procedura prokurimi për vlerën 40,047 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 3 raste për vlerën 34,169 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsytet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsytet për anulimin e procedurës duhet të jenë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në 3 raste për vlerën 1,790,556 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave për punë publike dhe i mallrave, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

- Shoqëria “H.Sh.” është penalizuar në dy raste në vlerën 3,068,020 lekë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L.G. në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016 në vlerën 1,914,720 lekë, si dhe B.Gj. në vlerën 1,153,300 lekë, veprim në kundërshtim ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues.

-Niveli i pagave për vitin 2018 është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2018, ku niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri në dhjetë vjet dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet por, *ky nivel nuk është miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit të vetëm). E njëjta situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 08.05.2019, janë miratuar tabelat e pagave për punonjësit e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, duke filluar nga data 01.05.2019. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.* Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë ngarkon me përgjegjësi P.Sh. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 01.01.2018-01.03.2018, B.A. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Theksojmë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm (Pronari) i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkon me përgjegjësi T.B. në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 21.03.2018-31.05.2019, si përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është në detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në këtë Ministri. Theksojmë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Shoqërinë “H.Sh.”, është Ministria e Linjës që monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë shoqëri

- Nga vlerësimi i tabelës së pagave konstatohet se nuk është ruajtur raporti i tyre ndërmjet shkallëve të vjetërsisë dhe kategorive të punës, për punonjësit që paguhen me kategori, kryesisht ato të riparimit të mjeteve hekurudhore është barazuar paga e kategorisë I-rë me atë të kategorisë IV dhe në disa raste me atë të kategorisë V. Për punonjësit e sektorit të lëvizjes dhe mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, është barazuar paga për vjetërsi në punë 1-5 vjet me atë mbi 25 vjet. Paga minimale është përafëruar dhe në disa raste është barazuar dhe me pagën e punonjësve në përbërje të personelit administrativ. Situatë e cila krijon demotivimin e punonjësve për punë dhe mund të bëhet shkak për largimin e specialistëve të kualifikuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Në Hekurudhën Shqiptare ShA. konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik. Qëllimi i programit ekonomik në përgjithësi është arritja e synimeve të Shoqërisë sipas prioriteteve të saj. Për vitin 2018 sipas analizave të buxhetit, realizimi i të ardhurave në raport me planin e të ardhurave, është në masën 93.2 %. Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, performanca e treguesve ekonomik-financiar, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet. Në Shoqërinë H.Sh. ShA. për çdo lekë të shpenzuar në vitin 2017 është përfutur një e ardhur prej 0.69 lekë, në vitin 2018 për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.58 leke. Për vitin 2019 për pesëmujorin e parë të vitit për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.53 lekë. Pra siç vërehet për vitin 2018 ka një ulje 0.11 lekë nga viti paraardhës 2017, ndërsa për pesëmujorin e parë të vitit 2019 ka një zvogëlim me 0.05 lekë nga viti 2018. Risku bazë para të cilit ndodhet Shoqërisë “H.Sh.” ShA. është risku i gjendjes të pamjaftueshme të likuiditeteve. Një kompani me aftësi paguese është ajo që zotëron më shumë se sa u detyrohet të tjerëve, me vlerë neto pozitive e borxh të menaxhueshëm. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2018, paraqitet 1.4 % (1.148.514 mijë detyrime /81.895.037 mijë lekë) me tendencë rritje për vitin 2019. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penaltitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvecion nga buxheti i shtetit për vitin 2016, 2017, 2018 dhe për vitin 2019 në vlerat respektive 390.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyrë të ndjeshme rezultatit financiar (humbje).

- Nga analizimi i dokumenteve ligjore me të cilët është rregulluar veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës të “H.Sh.” ShA., Durrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ato nuk janë të harmonizuara dhe të bashkërenduara nga pikëpamja juridike, konkretisht përsa i përket mbledhjes së këshillit, zgjedhjes së kryetarit dhe zv/kryetarit dhe shpërblimit të këshillit.

Në statut neni 9 përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar ndërsa në udhëzim nr.318 datë 08.04.2009 të Ministrit të ish-METE, i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi, kryetari i këshillit zgjidhet me propozim të Ministrit, neni 10.1 i statutit të shoqërisë përcakton se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se 2 herë në vit, ndërsa në VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, pika 8, dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 pika 9, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit, neni 12 i statutit për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, i cili aktualisht është i shfuqizuar dhe statuti duhet t’i referohet VKM nr.570 dt 03.10.2018 në nenin 11. Pika 4 të statutit, nuk ka një rregullore të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së këshillit.

Statuti i shoqërisë neni 8.2 përcakton se kohëzgjatja e anëtarëve të këshillit është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje, nga auditimi u konstatua se dy prej anëtarëve të këshillit e kanë mbaruar afatin 3 vjeçar por, nuk ka asnjë shkresë nga ministria për rizgjedhjen e tyre, konkretisht K.M. emëruar në datë 01.07.2015 dhe Th.Xh. emëruar në 01.07.2016. Gjithashtu edhe A.Sh. anëtarë tjetër i Këshillit Mbikëqyrës ka paraqitur dorëheqjen gjatë fazës së auditimit nga grupi në subjekt, situatë kjo e cila ndikon në kuorumin e organit kolegjal.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” SHa DURRËS

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka zgjedhur zv/kryetarin, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreut II, pika 5 (i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi) dhe statutit të shoqërisë neni 9 pika 9.1, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar. Sipas statutit neni 9.3 dhe 10.1, këshilli mbledhet me kërkesë të kryetarit ose në mungesë të tij të zv/kryetarit. Zgjedhja e zv/ kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj.

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 04.12.2017 është emëruar Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., A.D.. Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë sipas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.17516 prot., datë 04.12.2017. Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë me Administratorin e “H.Sh.” ShA. , veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statutin e shoqërisë neni 11, pika i, ku përcaktohet se me emërimin e administratorit të shoqërisë, këshilli lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

Gjatë shqyrtimit të vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se në shumicën e tyre këshilli nuk është i shprehur qartë dhe nuk ka dhënë një vendim të argumentuar, fakt i cili lë vend për interpretim nga ana e shoqërisë.

Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.6 datë, 30.04.2018, shprehet se miratohet struktura organizative e Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj por, nuk përcakton numrin e drejtorive dhe numrin e punonjësve respektiv. E njëjta situatë konstatohet edhe me vendimet e miratimit të strukturës organizative për vitin 2019 me vendimin nr.5 datë 7.03.2019. Vendimi nr.2, datë 02.02.2018 për miratimin e Strukturës Organizative dhe organigramës së “H.Sh.” ShA. me fillim zbatimi nga 01.04.2018 (nga 1068 punonjës do të operohet me 992 punonjës, duke shkurtuar 76 punonjës në total.) Por, numri i punonjësve të miratuar për vitin 2018 ka qenë 1100 punonjës dhe jo 1068 siç shprehet këshilli dhe për të shkuar në numrin 992 duhet të shkurohen 110 punonjës. Në këtë vendim këshilli është bazuar në programin ekonomik të parashikuar nga strukturat e shoqërisë dhe jo në atë të miratuar nga vetë këshilli më përpara. Vendimi nr.8, datë 30.04.2018 dhe vendimi nr.4 datë 27.03.2019 ku këshilli shprehet se vendosi në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 kreu II pika 1/d të Këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në njësinë e infrastrukturës sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë por, nuk është shprehur për numrin e këtyre ambienteve ose lista e paraqitur nga administratori të firmosej nga këshilli. Vendimi nr.12 datë 18.07.2018 për miratimin e Kodit të Etikës të Auditit të Brendshëm. Vendim ky i panevojshëm pasi ky kod është i miratuar me urdhrin nr.56 datë 2015 të Ministrit të Financave dhe është detyrimisht i zbatueshëm për të gjithë audituesit e brendshëm të sektorit publik pa kërkuar një miratim të dytë nga këshillat mbikëqyrës i sha-ve. Pra, ky kod nuk ka dashur miratimin e këshillit që të bëhej i zbatueshëm nga njësia e auditit të brendshëm. Vendimi nr.21 datë 20.12.2018 për miratimin në parim të materialit të paraqitur për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri në 31.12.2017. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë materialin për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri më 31.12.2017. Ky vendim nuk ka të përcaktuar numrin e rasteve dhe vlerën përkatëse, si dhe nuk është firmosur as nga këshilli as nga hartuesit e saj, pasqyra e detyrimeve debitorë llogaria 4671 “Detyrime të tjera në konflikt” gjendje datë 31.12.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

- Shpenzimet e shoqërisë janë rënduar nga vendimet gjyqësore, si pasojë e mos likuidimeve në kohë të faturave ndaj kreditorëve në 1 rast për vlerën 1,655,413 lekë, si dhe për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi në vlerën 3,988,638 lekë në vitin 2012, i marr në zbatim të KPP. Shoqëria ka paguar penalitete për mos likuidim në kohë të faturës (detyrimeve), ndaj operatorit ekonomik “S.ShPK.”, i cili e ka fituar këtë të drejtë me Vendim Gjykatë të Rethit Gjyqësor Durrës nr.111, datë 29.01.2018 ku shuma e interesave ligjorë është 1,655,413 lekë.

Po me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.946, datë 26.05.2015, shoqëria është penalizuar në vlerën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi të kryer në vitin 2012, me fond limit 35,000,000 lekë, në të cilën Operatori ekonomik S. ShPK., është shpallur fitues në fazën e parë të vlerësimit të ofertave. Më pas është bërë ankesë nga operatori “Z. ShPK. në KPP, i cili e ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “S.” duke shpallur fitues “Z. ShPK.”. Ky vendim i KPP-së, është ankimuar nga operatori “S. ShPK.” më pas në shkallët e tjera të Gjykimit, i cili ka fituar një dëmshpërblim në shumën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë.

Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, nuk kanë të bashkëlidhura listëpagesat, ato mbahen në njësitë respektive. Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, në të gjitha rastet nuk kanë të bashkëlidhur listëpagesat përkatëse si dokumentacion justifikues. Theksojmë se listë pagesat mbahen në secilën njësi, pavarësisht se ku bëhet likuidimi, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësit zbatues të cilët kanë hartuar dhe nënshkruar Urdhër Transfertat përkatëse.

Procedura prokurimi të blerjeve me vlera të vogla, të kryera jo në përputhje me Legjislacionin e Prokurimit Publik, kjo pasi:

-Autoriteti Kontraktor H.Sh. ShA., Durrës i kryen këto procedura pa patur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion, pra janë lidhur kontrata apo janë pranuar fatura tatimore për blerje mallrash apo shërbimesh në nivel të konsiderueshëm në 54% për të gjithë vitin 2018 dhe në 83% për 5-mujorin e parë të vitit 2019. Konkretisht për vitin 2018 janë realizuar 85 procedura prokurimi me vlerë totale oferte në shumën 8,935,077 lekë nga të cilat nuk janë likuiduar 28 procedura me vlerë kontrate në shumën 4,821,733 lekë. Për vitin 2019 për 5-mujorin e parë janë realizuar 32 procedura me vlerë totale oferte në shumën 3,108,130 lekë nga të cilat nuk janë likuiduar 19 procedura me vlerë kontrate në shumën 2,583,969 lekë. Këto veprime nuk i përmbahen VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 70, i cili përcakton se *“Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor”*.

-Në të gjitha rastet e audituara rezulton se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë, kjo pasi urdhri i prokurimit i shoqëruar me ftesën për ofertë, i cili u drejtohet operatorëve ekonomikë, nuk ka të përcaktuar të dhënat e nevojshme të operatorëve të përzgjedhur, që lidhen me objektin e prokurimit.

-Në 18 raste fatura tatimore e pranuar nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, por nënshkruhet vetëm nga njëri prej anëtarëve apo magazinieri i njësisë, ndërkohë që fatura tatimore duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRES

-Në të gjitha rastet e audituara, llogaritja e fondit limit të procedurës, nuk është e dokumentuar, pavarësisht se në disa raste komisioni i cili ka llogaritur fondin limit, shprehet se është bazuar në kontrata të mëparshme, apo në testime tregu, në dosje nuk evidentohet asnjë referencë në të cilën është bazuar komisioni për nxjerrjen e fondit limit përkatës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, pika 2, Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pikat 5, 7 dhe 19.

Pagesa nëpërmjet arkës jashtë limitit ditor të pagesave. Rezulton se në 25 raste janë kryer pagesa nëpërmjet arkës me para në dorë duke tejkaluar limitin ditor të veprimeve në arkë, kryesisht për likuidim faturash telekom, shërbime postare, fatura uji dhe likuidime për shpenzime blerje me vlera të vogla. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 64.

-Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, huatë afatgjata dhe huatë e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,258,197 mijë lekë. Në këtë shumë Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Siç përmendet në shënimin nr.11, Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Për më tepër, në lidhje me detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, bazuar në shkresën me numër protokollit 505 të paraqitur nga shoqëria, pretendimet aktuale nga hekurudhat e huaja përveç shumës së principalit, janë 1,140,580 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pallogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, çka mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “H.Sh.” ShA., Durrës. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2018 është në vlerën 382,798,300 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 34% për vitin 2018, e zënë kërkesat e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 47,823,005 lekë dhe Tvsh me saldo debitore në vlerën 53,242,511 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2018, kjo gjendje paraqitet në vlerën 47,823,005 lekë. Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 1,148,514,060 lekë. Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitore zë 18 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 18% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 32% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 55% për vitin 2018.

Në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare nuk është pasqyruar penaliteti që ka Shoqëria “H.Sh.” ShA. që vjen si pasojë e mos likuidimit të detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja lidhur me transportin e mallrave për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e H.Sh.. Pasqyrimi në kontabilitet dhe pasqyrat financiare bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit) pa u llogaritur kamatëvonesat. Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH.A DURRËS

hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro.

H.Sh. ShA., në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë.

Në llogaritë jashtë bilancit në shumën 3,274,893 mijë lekë paraqitet vlera e aktiveve afatgjata materiale të cilat priten ti transferohen Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet.

Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, aktivet afatgjata materiale paraqiten në vlerën 84,156,200 mijë lekë (2017: 84,941,444 mijë lekë), Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve të veta. Aktivet afatgjata materiale, sipas politikave kontabël mbeten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. SKK 5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale” kërkon që nëse një kompani zgjedh modelin e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-ve do të kryhej në datën e raportimit. Rivlerësimi më i fundit i aktiveve të shoqërisë daton në vitin 2013; 5 vjet më parë dhe normat e amortizimit të aplikuara nga shoqëria gjatë 2018 janë ato të miratuara me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr, 24, datë 18.12.2006 të 11 viteve më parë. SKK 5 kërkon kryerjen e një testi zhvlerësimi në datën e mbylljes së bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies së vlerës, e cila nuk është kryer nga shoqëria. Grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë efektet që ky vlerësim do të kishte në pasqyrat financiare. Aktualisht Shoqëria është në proces rivlerësimi të aktiveve, kjo sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarit me nr.120 datë 11.10.2018. Sipas kontratës së lidhur me grupin e eksperteve të miratuar për këtë qëllim, procedura e rivlerësimit pritet të përfundojë brenda vitit 2019. Veprime në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr.5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale”, ligjin nr.33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar.

- Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave u konstatuan rastet e kontratave të cilat nuk i kanë plotësuar dokumentet sipas kërkesave ligjore konkretisht mungojnë foto dhe gent plani i konfirmuar nga prefektura.

Në asnjë dosje nuk gjenden procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit.

Nga sektori i menaxhimit të kontratave nuk janë ushtruar kontrole periodike për asnjë kontratë në ambientet e dhëna me qira mbi zbatimin e kushteve të kontratës dhe nuk janë verifikuar informacionet e shefave të nën njësive rajonale në terren.

Në dy raste kontratat e qirave janë lidhur në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar dhe në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, duke e përjashtuar nga procesi i konkurrimit.

Aktivitetet e shoqërisë HSH ShA. Durrës, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. Në shkresën nr.1313/11 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr. 50, datë 17.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës i janë lënë për zbatim 23 masa organizative, 9 masa për shpërblim dëmi, 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 16 masa disiplinore.

Nga 23 masa organizative të lëna për zbatim, janë pranuar 100% e tyre. Nga masat e rekomanduara 5 (21.7%) janë zbatuar plotësisht dhe 18 (78.3%) janë në proces zbatimi.

Nga 9 masa për shpërblim dëmi, masa 4.1 dhe 4.2, janë revokuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr.1313/15 prot., datë 01.08.2018. Nga masat për shpërblim dëmi të rekomanduara, 2 masa (22.2%) në vlerën 14,223,134 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, 5 masat e tjera në vlerën 8,473,988 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në vlerën 1,474,183,493 lekë, 2 masa (40%) në vlerën 1,230,000,000 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, ndërsa 3 masa (60%) në vlerën 1,474,183,493 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar plotësisht 100%.

Mos zbatimi i rekomandimeve sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c dhe ka shkaktuar mungesë eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë H.Sh.” ShA., Durrës, si pasojë e mos korrektesës institucionale të organeve drejtuese të shoqërisë në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.

III.c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Nga auditimi mbi përputhshmërinë sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti -Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat janë materiale, por jo të përhapura, në: Dëm ekonomik me vlerë 52,509 mijë lekë, dhe efekte financiare negative në vlerën 10,954 mijë lekë, në procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave të punëve publike, provigjonime për çështje që janë në proces gjyqësor dhe me vlerë të përcaktuar në kundërshtim me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe standartet kombëtare të kontabilitetit.

Baza për Opinionin.

Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000):

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kualifikuar :

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) në administrimin e shpenzimeve, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur *nga gabime materiale*, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar*.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr.415/1 prot., datë 07.06.2019, nga data 10.06.2019 deri më datë 31.07.2019, në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 30.05.2019, u krye auditimi “Përputhshmërisë” me përbërje:

1. F.I., Përgjegjës grupi,
2. A.B., Auditues,
3. E.M., Auditues,
4. M.R., Auditues,

a. Titulli: Projekt Raport Auditimi mbi auditimin e “Përputhshmërisë” në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës.

b. Marrësi: Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, me Administrator A.D..

c. **Objektivat dhe qëllimi:** Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, raporti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë*, ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

d. **Identifikimi i çështjes:** Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiençë dhe efektivitet.

e. **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Drejtimi dhe Administrimi i Shoqërisë realizohet nga:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

a. Këshilli Mbikëqyrës.

b. Administratori i Shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori i Shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të Shoqërisë dhe kryhen të gjitha veprimet e Administrimit të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i H.Sh. ShA. është transporti i mallrave dhe i udhëtarëve si dhe dhënia me qira Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.” ShPK., A., Shoqëria “H.Sh.” ShA. si dhe po bëhet gati të fillojë operatori “A.”.

Aktiviteti i H.Sh. administrohet nga Drejtoria Qendrore, ne përbërje të së ciles janë kater njësi Biznesi të ndara administrativisht dhe financiarisht midis tyre.

Këto Njësi Biznesi janë :

a.Njësia e biznesit të transportit hekurudhor të Mallit.

b.Njësia e biznesit të transportit hekurudhor të Udhëtarëve.

c.Njësia e biznesit të menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore.

d.Njësia e biznesit të mirëmbajtjes të mjeteve Lëvizëse (lokomotiva dhe vagonë).

Transporti i mallrave dhe i udhëtarëve, kryhet respektivisht nga operatori i Njesisë Biznesit të Mallit dhe ai i Njesisë të Biznesit të Udhëtarëve, të cilët për sigurimin e shërbimeve të tyre të transportit shfrytëzojnë Infrastrukturën Hekurudhore, që është pronë e Shtetit.

Operatori i Njesisë të Biznesit të transportit të Mallrave dhe ai i Njesisë të Transportit të Udhëtarëve e kryejnë shërbimin e tyre të transportit hekurudhor, si të mallit ashtu edhe të udhëtarit vetëm brenda rrjetit hekurudhor Shqiptar dhe nuk kryejnë shërbime të transportit ndërkombëtar jashtë rrjetit hekurudhor Shqiptar.

Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës ka për detyrë dhe përgjegjjet për mirëmbajtjen, rinovimin, ruajtjen e infrastrukturës hekurudhore, organizimin dhe rregullimin e trafikut hekurudhor të mallrave dhe të udhëtarëve.

Njësia e Biznesit e Mirëmbajtjes të Mjeteve Lëvizëse (lokomotiva dhe vagonë) ka për detyrë mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve Lëvizëse lokomotiva dhe vagonëve të mallit dhe të udhëtarëve.

E ardhura kryesore e H.Sh. ShA. është nga aktiviteti i transportit të mallrave dhe të udhëtarëve, të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve të saj si dhe të ardhurat nga taksa e përdorimit të infrastrukturës nga operatorët privat të transportit hekurudhor.

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit: Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”; Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar; Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr.9920,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, ligji nr.7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr.9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; Ligji nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Ligji nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar; VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr.781, datë 14.11.2007, ndryshuar; VKM nr.864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”; etj; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; Udhëzimi i APP nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”; Udhëzimi i APP nr.2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”; Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktivitetëve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë. Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

h. Standardet e auditimit:

- ISSAI100- (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).
- ISSAI400- (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).
- Kodi etik i KLSH.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë në zbatim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Kodit hekurudhor dhe Statutit të Shoqërisë. Shoqëria “H.Sh.” ShA. është shoqëri anonime me kapital 100 % shtetëror, me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe supervizohet nga Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura.

- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është transporti i udhëtarëve dhe mallrave, ngarkim, shkarkim dhe shërbime të tjera hekurudhore. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e Shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërive të tjera jashtë vendit.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.01.2018 deri më datë 30.05.2019.

Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, programimi ekonomik dhe realizimi i tij, alokimi dhe përdorimi i subvencioneve, transporti i udhëtarëve dhe mallrave etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

1. Titulli i Gjetjes: Mos zbatim i rekomandimeve të KLSH ardhur nga diziformimi që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik dhe nga A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, për krijimin e provigjoneve për debitorët pa shpresë arkëtimi”, në vlerën 44,321,985 lekë.

Situata: Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 201.12.2018 është vendosur të miratohet në parim materiali i paraqitur për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, si dhe është ngarkuar Administratori i Shoqërisë të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë materialin për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017. Vendimi është firmosur nga T.B. në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës dhe antarët A.Sh., K.M., F.M., Th.Xh., P.Sh.. Ky vendim nuk ka të përcaktuar gjenealitetet si numrin e rasteve dhe vlerën përkatëse, si dhe nuk është firmosur as nga Këshilli as nga hartuesit e saj pasqyra e detyrimeve debitorë llogaria 4671 “Detyrime të tjera në konflikt” gjendje datë 31.12.2017. Ky vendim është marrë mbi bazën e informacionit të dërguar nga Administratori i Shoqërisë me nr.1136 prot, datë 05.11.2018. Për këtë informacion Administratori ka marr vendimin nr.14, datë 05.11.2018, ku ka vendosur të miratojë në parim informacionin e përgatitur nga Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse dhe Njësia Ekonomike për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, *si dhe ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse dhe Njësia Ekonomike, të cilët duhet të nxjerrin personat përgjegjës për mos arkëtimin e detyrimeve në vite, duke ndjekur rrugët ligjore.*

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 201.12.2018 dhe vendimi i Administratorit të Shoqërisë nr.14, datë 05.11.2018 për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, është marr mbi bazën e informacionit pa numër protokoll, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

11.10.2018 i firmosur nga SH.Xh. me detyrë shëf i sektorit juridik dhe nga A.H. me detyrë Drejtues i Njësisë ekonomike.

Ky informacion është diziformues dhe i pa vërtetë (i rrem) për sa i përket:

- a. detyrimin në vlerën 13,695,167 lekë që kompania “K.SH.G.” Gjermani, jo vetëm në vlerë, por në argumentin e dhënë për kalimin e këtij detyrimi në provigjion. Konkretisht në këtë informacion shprehet në mënyrë eksplicite “Kompania “K.SH.G.” Gjermani, me 13,695,167 lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson shërbim transporti me hekurudhë (hekur nikel)që i përket ish-rajonit hekurudhor Elbasan në vitin 2007. *Për këtë detyrim janë ndjekur procedurat ligjore si dhe civile ashtu edhe kallëzim penal, nga ana e sektorit juridik të HSH, por me sa kemi dijeni nuk ka një vendim të gjykatës pasi personi nuk është gjetur po ashtu dhe adresa e tij. Ky detyrim nuk ka shpresë për tua arkëtuar, prandaj NJBM nga ana e saj gjykon që kjo vlerë të hiqet nga kontabiliteti i saj dhe detyrimisht duhet kaluar në rezultat.*

Në kundërshtim me sa kërkon Administratori i Shoqërisë me vendimin nr.14, datë 05.11.2018 brenda kompetencave ligjore dhe statutore të Tij, dy personat më të rëndësishëm për këtë çështje (Dëmshtëpërblim) SH.Xh. me detyrë shëf i sektorit juridik dhe A.H. me detyrë Drejtues i Njësisë Ekonomike, jo vetëm nuk veprojnë, por me dashje diziformojnë Administratorin e Shoqërisë dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë informacion të pa vërtetë (të rrem) duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “*Për këtë detyrim janë ndjekur procedurat ligjore si dhe civile ashtu edhe kallëzim penal, nga ana e sektorit juridik të HSH, por me sa kemi dijeni nuk ka një vendim të gjykatës pasi personi nuk është gjetur po ashtu dhe adresa e tij, duke arritur deri atje sa të propozojnë “Prandaj NJBM nga ana e saj gjykon që kjo vlerë të hiqet nga kontabiliteti i saj dhe detyrimisht duhet kaluar në rezultat”.*

Për sa trajtua më lartë.

Personat e sipërcituar nuk kanë vënë në dijeni Administratorin e Shoqërisë që KLSH me shkresën nr.1051/11 prot, datë 30.04.2015 ka kërkuar që:

“Nga Shoqëria “H.Sh.”, nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **198,386 USD**, e konvertuar **në lekë vlera 24,280,462 lekë** (198,386 x 122.39 kursi i dollarit datë 09.02.2015 i Bankës së Shqipërisë) nga kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.”, në cilësinë e agjentit të përgjithshëm të kompanisë “K.SH.G.” Gjermani, detyrim i lindur në vitin 2007.

Edhe pse KLSH-ja me shkresën nr.412/7 prot, datë 25.03.2010, ka rekomanduar “Të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 194,386 USD nga K.SH.G. dhe “S.S.” Durrës, në cilësinë e agjentit të përgjithshëm të kompanisë K.SH.G..

Deri më datën 10.02.2014, nga H.Sh. ShA. Durrës, nuk është bërë ndryshimi i kërkesë padisë, por vazhdon çështja gjyqësore me kompaninë “K.SH.G.” Gjermani), kompani për cilën Konsullata Shqiptare në Gjermani ka dërguar zyrtarisht konfirmimin e saj, duke cituar që kjo kompani në vitin 2001 ka falimentuar, veprim për të shmangur vjeljen e këtij detyrimi nga “S.S.” ShPK. Durrës, me përfaqësues ligjor E.Ç., i cili ka firmosur faturat dhe fletëngarkesat e transportit të qymyrit koks nga Elbasani me destinacion shtetin Kinë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 24,280,462 lekë**, nga shoqëria “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.” ShPK. Durrës, për shkeljet e konstatuara për transportin i mineralit të hekur-nikelit nga stacioni hekurudhor të Gurit të Kuq-Elbasan me destinacion Kinë, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SHa DURRËS

Po me shkresën nr.1313/11 prot, datë 18.06.2018 KLSH ka kërkuar zbatimin e këtij rekomandimi.

Pra referua sa më sipër nga KLSH nuk është kërkuar për shpërblim dëmi vetëm nga shoqëria “K.SH.G.” Gjermani, por edhe “S.S.” ShPK. Durrës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion

- Nuk ka asnjë procedurë juridike, civile, administrative për shpërblim dëmi nga shoqëria “S.S.” ShPK. Durrës.

Grupi i auditimit i kërkoi SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik, A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, kallëzimin penal për këtë çështje ashtu siç citohet në informacionin dërguar Administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës, si dhe nga deklarimi verbal që i bënë grupit të auditimit për këtë çështje (pra ka kallëzim penal), të cilët nuk kanë vendosur në dispozicion të grupit të auditimit gjatë auditimit, dokumentacionin e kërkuar dhe të konsideruar si të nevojshëm për zbatimin e këtij rekomandimi, veprim ky që bie ndesh me detyrimet dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe që ka penguar veprimtarinë audituese në shoqërinë H.Sh. për këtë çështje.

Theksojmë se SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik, A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, kallëzim penal dhe kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për Kompaninë “K.SH.G.” Gjermani, e vunë në dispozicion me observacionin 2.08.2019, pra pasi kishte përfunduar auditimi (auditimi përfunduar datë 31.07.2019, por nuk vuri në dispozicion asnjë procedurë gjyqësore ose penale për shoqërinë “S.S.” ShPK. Durrës.

Në opinionin e grupit të auditimit

Efektet e mos ekzekutimit të këtij detyrimi duhet të interpretohen në zbatim;

- Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nenet 476-495. Për të pasur përgjegjësi civile është e kërkueshme që veprimet/mosprimet të jenë bërë me faj. Ky rregull vlen qoftë për dëmin e shkaktuar nga mos ekzekutimi i detyrimeve. Kodi nuk jep përkufizime të fajit me dashje direkte, por referuar doktrinës civile. Me faj me dashje direkte në kuptimin juridiko-civil do të kuptojmë se personi/personat i parashikon/parashikojnë pasojat e paligjshme të veprimit/mosveprimit të tij/tyre dhe i dëshirojnë këto pasoja. Dashja direkte përfaqëson shkalën më të lartë të ndërgjegjësimit të personi/personave dhe si rrjedhojë sjell edhe edhe shkallën më të lartë të përgjegjësisë juridiko-civile.

Në shkenca të tjera të së drejtës, sidomos në të drejtën penale parashikohen edhe forma të tjera dashje të tilla si dashje e paramenduar dhe dashje e përcaktuar.

-Ligjit nr.38/2017, datë 30.03.2017, neni 399/1 dhe neni 399/6

Për sa trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi;

SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik, A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, për krijimin e provigjoneve për debitorët pa shpresë arkëtimi”, në vlerën 44,321,985 lekë.

b. Detyrimin në vlerën 20,041,523 lekë që personi fizik Xh.GJ., jo vetëm në vlerë, por në argumentin e dhënë për kalimin e këtij detyrimi në provigjion. Konkretisht në këtë informacion shprehet në mënyrë eksplicite “Xh.GJ., me 20,041,523 lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson diferencë gazoili e ndodhur në vitin 2009, për këtë janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore nga ana e sektorit juridik të H.Sh.. ***Për këtë çështje janë bërë procedurat ligjore me padi civile, por është e pa mundur që të gjendet adresa e personit pasi është larguar me kohë jashtë shtetit. Mendojmë se në këtë kohë kjo vlerë të kalojë në rezultat pra të krijohet provigjioni.***

Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument për sa trajtuar në informacionin pa numër protokoll, datë 11.10.2018 i firmosur nga SH.Xh. me detyrë Shef i sektorit juridik dhe nga A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë Ekonomike, dhënë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Mbikëqyrës gjatë auditimit. Për pasojë vlejné interpretimet juridike të dhëna nga grupi i auditimit për mos ekzekutimin e detyrimit nga kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.”.

Theksojmë se SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik, A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, kallëzim penal dhe kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për Kompaninë “Xh.GJ.”, e vunë në dispozicion

me observacionin 2.08.2019, pra pasi kishte përfunduar auditimi (auditimi përfunduar datë 31.07.2019, por nuk vuri në dispozicion asnjë procedurë gjyqësore ose penale për shoqërinë “S.S.” ShPK. Durrës.

Konkretisht grupit të auditimit ju vu në dispozicion nëpërmjet observacioneve:

Kallëzimi penal me nr.927 prot, datë 09.12.2009 të firmosur nga ish-Administratori i Shoqërisë Z.R.

Shkresa ndatë 19.07.2011 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës me objekt: Gjykimin e çështjes penale nr 1759, datë 11.12.2009 në ngarkim të të pandehurit Xh.Gj., akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar neni 248.

Vendim i Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës nr.812 9111-2011-6424) , datë 19.12.2011 ky person është dënuar me kusht, dy vjet burgim n.q.s brenda tre vjetëve nuk kryen tjetër veprë penale, si dhe gjobë 300,000 lekë.

Autorizimi datë 23.04.2012 e ish-Administratorit Z.R., ku autorizon SH.Xh. jurist pranë drejtorisë së përgjithshme të hekurudhave, G.Gj. me detyrë kryeinxhinier, të përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave në Gjykatën të Rrethit Gjyqësor Durrës për shpërblim dëmi.

Kërkesë padi pa numër prot., pa datë dokument i fotokopjuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për shpërblim dëmi në vlerën 20,465,245 lekë për Xh.Gj., firmosur nga ish-Administratori i Shoqërisë Z.R., konceptuar nag jurist SH.Xh..

Kërkesë për sigurim padie pa numër protokolli, datë 29.03.2012 bërë nga T.C. drejtuar ish-Administratori i Shoqërisë Z.R.

Dhe për dijëni Sektorit të financës, ku së bashku me depozitimin e kërkesë padisë në gjykatë të derdhet dhe shuma 613,957 lekë (3 % i shumës së kërkuar kërkesë padisë) si dhe 200 lekë pulla e taksës së lajmërimit. Referuar të vetmit dokument i takon që edhe kërkesë padia në gjykatë të jetë bërë rreth datës 29.03.2012.

Kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me numër 723 prot, datë 18.06.2019 për shpërblim dëmi në vlerën 20,465,245 lekë për Xh.Gj., është formale, pasi në këtë kërkesë padi është cituar “.....duke u nisur sa më lart, **ripërsërisim** kërkesën për gjykimin e kësaj padie dhe pranimin e kërkesës për shpërblim dëmi nga ana e të paditurit Xh.Gj., në favor të H.Sh., në vlerën 20,465,245 lekë”.

Është formale pasi:

-Nga shoqëria është bërë njëherë kërkesë padi pa numër prot., pa datë dokument i fotokopjuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për shpërblim dëmi në vlerën 20,465,245 lekë për Xh.Gj., firmosur nga ish-Administratori i Shoqërisë Z.R., konceptuar nga jurist SH.Xh..

-Në doktrinën juridike dhe në kodin e procedurës civile, nuk njihet termi juridik **ripërsërisim** kërkesën për gjykimin e kësaj padie, por njihen terma të tjerë si: Kërkesë padi për rivendosje në afat, neni 458 I K.PR.Civile, Prekluziviteti i ankimit, kërkesë padi, për rishikimin e vendimit të Gjykatës nenet 494-498 të kodit të procedurës civile, kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshtetimit të procedurave nenet 399/1-399/9 të K.Pr.Civile.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

-Referuar kallëzimit penal, pjesa arsyetuese më datë 25.11.2009 grupi i ngritur nga drejtori i përgjithshëm, i përbërë nga A.H. kryetar, V.C., S.P., I.B. dhe M.B. anëtar, dhe përfaqësuesit e njësisë PMH I.S., R.G., V.G. dhe A.M. M.q.s këtë grup e kryesonte vet A.H., sot drejtor i njësisë ekonomike, që ka hartuar edhe ralicion për provigjoimin e dëmit, me siguri është prerë udhër zhdëmtimi si diferencë malli në magazinë, urdhër zhdëmtimi është kontabilizuar, si dhe është njoftuar magazinieri për shlyerjen e detyrimit, konformë ligjit nr.6942 datë 25.12.1984, “Për administrimin, ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, neni 23 pika c, ku në mënyre eksplicite është shprehur “...në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vlefte, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësve me përgjegjësi materiale kurse tepricat shkojnë në dobi të ndërmarrjes”.

Me kundërshtimin e personit me përgjegjësi materiale, Hekurudha i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi për shlyerje detyrimi në vlerën 20,465,245 lekë.

Nuk provohet nëse ka ose jo vendimmarrje të gjykatës, si dhe a janë ndjekur/ose jo shkallët e procesit gjyqësor nga hekurudha dhe në veçanti nga personat e autorizuar me autorizim të datës 23.04.2012 nga Drejtori i përgjithshëm Z.R. që në rastin konkret ka qenë SH.Xh. me detyrë jurist pranë drejtorisë së përgjithshme, sot shef i sektorit juridik i cili ka hartuar dhe relacionin për administratorin dhe Këllishin Mbikëqyrës për provigjionimin e vlerës 20,465,245 lekë.

Provizionimi është bërë në kushtet që çështja është në proces gjyqësor, kundërshtim me SKK6, provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara, pasi nuk i plotëson kushtet e njohjes si i tillë. Në përkufizimin e njohjes së provizionit po citojmë pikën 7, të SNKK 6, “Provizionit është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shumën janë të pasigurta. Ngjarja detyruese është ngjarja që krijon një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike. Detyrimi ligjor është detyrim që rrjedh nga:

1. një kontratë (nëpërmjet kushteve të shprehura ose të nënkuptuara të kontratës);
2. legjislacioni apo një akt tjetër ligjor.

Detyrimi konstruktiv është detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomike ku:

a. në bazë të një modeli të vendosur nga praktikat e shkuara, politika të shpallura ose një deklarami specifik, njësia ekonomike ua ka bërë të ditur palëve të tjera se do të pranojë përgjegjësi të caktuara:

b. si rezultat, njësia ekonomike ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme të palët e tjera, se ajo do t’i shlyejë këto përgjegjësi. Detyrim i kushtëzuar është:

1. një detyrim që krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike;
2. një detyrim ekzistues që rrjedh nga ngjarje të shkuara, por që nuk është njohur pasi:

(I) ka mundësi që shlyerja e detyrimit nuk do të shoqërohet me dalje të burimeve ekonomike; (II) shumën/vlerën e detyrimit nuk mund të vlerësohet me saktësi të mjaftueshme. Aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e krijuar nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e së cilës do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike.

Në opinionin e grupit të auditimit provizionet janë situata që njësia ekonomike, shoqëria ka drejt të tretëve dhe sipas kushteve sa më sipër kur ka një detyrim ligjor dhe nuk e di me saktësi vlerën krijon një provizion. Në rastin konkret kemi një vlerë të saktë, e verifikuar dhe e pranuar si dhe dënuar me vendim e sipërpërmendur të Gjykatës Rrethit Durrës, pra kemi një detyrim që një palë tjetër ka ndaj shoqërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Me veprimet apo mosveprimet në kohën e duhur për arkëtimin e vlerës sa më sipër si dhe duke e njohur në rezultatin e shoqërisë si shpenzim duke zvogëluar aktivet, është krijuar dëmi në vlerën sa më sipër.

Për sa trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit juridik, A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, të cilët me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që i jep Ligji, kanë kryer mos përmbushje të rregullt të detyrës, me efekt financiar të mundshëm në dëm të shoqërisë në vlerën **20,041,523 lekë**.

Vo. Vlen të theksohet në efektin financiar të mundshëm në dëm të shoqërisë mësipërm nuk janë llogaritur **kamatat ligjore të arrira** që prej datës së fillimit të vonesës së debitorëve si mësipër ndaj H.Sh., në zbatim të ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 450, vendimit unifikues të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart 932/2000, të interpretuar me vendimin unifikues nr.40, datë 12.04.2002 (vendimi unifikues 40/2002), për të cilat SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit juridik dhe A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, *duhet ti kishin llogaritur* dhe dhënë informacion Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Kriteri: Ligji 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligji nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 450, vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart 932/2000, të interpretuar me vendimin unifikues nr.40, datë 12.04.2002 (vendimi unifikues 40/2002).

Ndikimi/Efekt: Efekt financiar i mundshëm në dëm të Shoqërisë “H.Sh.” në vlerën 44,321,985 lekë.

Shkaku: Diziformimi që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik dhe nga A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike,

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi 1.1 : Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të merren masat për kthimin në gjendjen fillestare në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të vlerës 44,321,985 lekë, si dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e kësaj vlere. Kjo vlerë ka të bëjë me diziformimin që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i Njesisë Ekonomike, lidhur me provigjonimet në pasqyrat financiare të vitit 2018. Konkretisht për subjektin tregtar Xh.GJ. në vlerën 20,041,523 lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson diferencë gazoili e ndodhur në vitin 2009 dhe i vlerës 24,280,462 lekë, nga kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.” ShPK. Durrës, për transportin i mineralit të hekur-nikelit nga stacioni hekurudhor të Gurit të Kuq-Elbasan me destinacion Kinë, detyrim i krijuar që nga viti 2007.

Rekomandimi 1.2- Nga Administratori i shoqërisë të ngrihet grup pune për të llogaritur **kamatat ligjore të arrira** që prej datës së fillimit të vonesës së debitorëve Xh.GJ. në vlerën 20,041,523 dhe kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.” ShPK. Durrës në vlerën **vlerës 24,280,462 lekë**, ndaj Shoqërisë “H.Sh.” ShA., në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 450, vendimit unifikues të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart 932/2000, të interpretuar me vendimin unifikues nr.40, datë 12.04.2002 (vendimi unifikues 40/2002), për të cilat SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit juridik dhe A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike, *duhet ti kishin llogaritur* dhe dhënë informacion Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

2. Titulli i Gjetjes: Mos zbatim i plotë rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëpashmëm i KLSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Situata: Në shkresën nr.1313/11 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr.50, datë 17.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shoqërisë “H.Sh.” Sha. Durrës i janë lënë për zbatim 23 masa organizative, 9 masa për shpërblim dëmi, 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 16 masa disiplinore.

Nga 23 masa organizative të lëna për zbatim, janë pranuar 100% e tyre. Nga masat e rekomanduara 5 (21.7%) janë zbatuar plotësisht dhe 18 (78.3%) janë në proces zbatimi.

Nga 9 masa për shpërblim dëmi, masa 4.1 dhe 4.2, janë revokuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr.1313/15 prot., datë 01.08.2018. Nga masat për shpërblim dëmi të rekomanduara, 2 masa (22.2%) në vlerën 14,223,134 lekë konsiderohet të zbatuar plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, 5 masat e tjera në vlerën 8,473,988 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në vlerën 1,474,183,493 lekë, 2 masa (40%) në vlerën 1,230,000,000 lekë konsiderohet të zbatuar plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, ndërsa 3 masa (60%) në vlerën 1,474,183,493 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar plotësisht 100%.

Kriteri: Ligji 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Ndikimi/Efekti: Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Shkaku: Mos korrektesë e plotë institucionale e në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandime: H.Sh. Sha. duhet të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga rekomandimet e mëparshme të KLSH së cilat nga auditimet kanë rezultuar pjesërisht të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Titulli i Gjetjes 1: Mos harmonizimi i statutit me aktet ligjore në fuqi.

Situata: Nga analizimi i dokumenteve ligjore me të cilët është rregulluar veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës të “H.Sh.” ShA., për periudhën objekt auditimi u konstatua se ato nuk janë të harmonizuara dhe të bashkërenduara nga pikëpamja juridike, konkretisht përsa i përket mbledhjes së këshillit, zgjedhjes së kryetarit dhe zv/kryetarit dhe shpërblimit të këshillit

Në statut neni 9 përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar ndërsa në udhëzim nr.318 dt 08.04.2009 të Ministrit të ish-METE, i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi, kryetari i këshillit zgjidhet me propozim të Ministrit, neni 10.1 i statutit të shoqërisë përcakton se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se 2 herë në vit, ndërsa në VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, pika 8, dhe VKM nr.570, Dt 03.10.2018 pika 9, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit, neni 12 i statutit për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr.642, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, e cila aktualisht është e shfuqizuar dhe statuti duhet t’i referohet VKM nr.570 dt 03.10.2018 në nenin 11. Pika 4 të statudit, nuk ka një rregullore të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së këshillit

Kriteri: VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, udhëzimi nr.318 datë 08.04.2009 të Ministrisë së Ish-METE, (të cilët kanë qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi), VKM Nr.570, datë 03.10.2018, statuti i shoqërisë.

Ndikimi/Efekti: Paqartësi në lidhje me përcaktimet e bëra në aktet ligjore në fuqi duke ndikuar në mbarëvajtjen e funksionimit të shoqërisë, veçanërisht të funksionimit të këshillit mbikëqyrës.

Shkaku: Këshilli Mbikëqyrës nuk i ka propozuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë miratimin e ndryshimeve në statutin e shoqërisë, duke e përshtatur atë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 11. Pika 4 të statudit.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i “H.Sh.” ShA. të marrë masa për implementimin dhe harmonizimin e të gjitha ndryshimeve të bazës ligjore për funksionimin e këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare me statutin e shoqërisë, si dhe të hartojë një rregullore për funksionimin e tij me qëllim mbarëvajtjen e punës duke përcaktuar qartë detyrat funksionale të këshillit.

Titulli i Gjetjes 2: Kuorumi dhe zgjedhja e zv/kryetarit të këshillit.

Situata 1: Statuti i shoqërisë neni 8.2 përcakton se kohëzgjatja e anëtarëve të këshillit është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje, nga auditimi u konstatua se dy prej anëtarëve të këshillit e kanë mbaruar afatin 3 vjeçar por, nuk ka asnjë shkresë nga ministria për rizgjedhjen ose zëvendësimin e tyre, konkretisht K.M. emëruar në datë 01.07.2015 dhe Th.Xh. emëruar në 01.07.2016. Gjithashtu edhe një anëtarë tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, A.Sh. ka paraqitur dorëheqjen gjatë fazës së auditimit nga grupi në subjekt, fakt i cili ka krijuar një situatë e cila ndikon në kuorumin e organit kolegjal.

Situata 2: Këshilli Mbikëqyrës nuk ka zgjedhur zv/kryetarin, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreut II, pika 5 (i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi) dhe statudit të shoqërisë Neni 9 pika 9.1, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar. Sipas statudit nenit 9.3 dhe 10.1, këshilli mbledhet me kërkesë të kryetarit ose në mungesë të tij të zv/kryetarit. Zgjedhja e zv/ kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj.

Kriteri: Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 për “Funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Statuti i shoqërisë H.Sh. sh. a.

Ndikimi/Efekti: Pa pasur kuorumin e nevojshëm nuk mund të thirret mbledhja e këshillit dhe nuk mund të merren vendime në lidhje me administrimin e shoqërisë për sa kohë që mbledhja e organit kolegjal, është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Gjithashtu edhe zgjedhja e zv/kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURREË

Shkaku: Mbarimi i afatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në këtë detyrë. Mos zbatimi i kërkesave të nenit 9 pika 9.1 të statutit të shoqërisë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës i HSH ShA./ kryetari të njoftojë Ministrin e Financave dhe të kërkojë zgjidhjen sa më të shpejtë të situatës së krijuar në organin kolegjal të “H.Sh.” ShA. dhe më pas të zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij edhe një zv/kryetar në mënyrë që të vazhdojë funksionimi normal i tij duke e kthyer në gjendje të ligjshme dhe duke shmangur pengimin e punës në rastet kur nuk mund të jetë kryetari.

Titulli i Gjetjes 3: Kontratë me administratorin mbi detyrimet në administrimin e shoqërisë

Situata: Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 04.12.2017 është emëruar Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., z.A.D. Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë sipas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.17516 prot datë 04.12.2017, nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë me Administratorin e “H.Sh.” ShA., veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statutin e shoqërisë neni 11, pika i, ku përcaktohet se me emërimin e administratorit të shoqërisë, këshilli lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nenin 21, pika 4 dhe statuti e shoqërisë neni 11, pika i,

Ndikimi/Efekti: Ndikim në detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

Shkaku: Mos zbatim i përcaktimeve të bëra në statutin e shoqërisë dhe kodin e punës.

Rëndësia: e ulët

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës i “H.Sh.” ShA., të marrë masa për të rregulluar marrëdhënien juridike të punës me administratorin e shoqërisë duke lidhur kontratë me të për periudhën e mbetur të emërimit, me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve mbështetur në interesat e ligjshëm të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes 4: Vendimet të Këshillit Mbikëqyrës të pa arsyetuara plotësisht konformë legjislacionit në fuqi dhe mos pasja e një rregullore për funksionimin e tij.

Situata: Gjatë shqyrtimit të vendimeve të marra nga këshilli mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se në shumicën e tyre këshilli nuk është i shprehur qartë dhe nuk ka dhënë një vendim të argumentuar, fakt i cili lë vend për interpretim nga ana e shoqërisë. Gjithashtu vendimi për miratimin e planit ekonomik për vitin 2018 është bërë me shumë vonesë ndërsa për vitin 2019 nuk është dhënë deri në përfundim të punës audituese në terren.

Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.6 datë, 30.04.2018, këshilli shprehet se miratohet struktura organizative e Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj por, nuk përcakton numrin e drejtorive dhe numrin e punonjësve respektiv. E njëjta situatë konstatohet edhe me vendimet e miratimit të strukturës organizative për vitin 2019 me vendimin nr.5 dt 7.03.2019. Vendimi nr.2, datë 02.02.2018 për miratimin e Strukturës Organizative dhe Organigramës së “H.Sh.” ShA. me fillim zbatim nga 01.04.2018 (nga 1068 punonjës do të operohet me 992 punonjës, duke shkurtuar 76 punonjës në total.) Por, numri i punonjësve të miratuar për vitin 2018 ka qenë 1100 punonjës dhe jo 1068 siç shprehet këshilli dhe për të shkuar në numrin 992 duhet të shkurohen 110 punonjës. Në këtë vendim këshilli është bazuar në programin ekonomik të parashikuar nga strukturat e shoqërisë dhe jo në atë të miratuar nga vetë këshilli më përpara. Vendimi nr.8, datë 30.04.2018 dhe Vendimi nr.4 datë 27.03.2019 ku këshilli shprehet se vendosi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 Kreu II pika 1/d të Këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në njësinë e infrastrukturës sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë por, nuk është shprehur për numrin e këtyre ambienteve ose lista e paraqitur nga administratori të firmosej nga këshilli. Vendimi nr.12 datë 18.07.2018 për miratimin e Kodit të Etikës të Auditit të Brendshëm. Vendim ky i panevojshëm pasi ky kod është i miratuar me urdhrin nr.56 datë 2015 të Ministrit të Financave dhe është detyrimisht i zbatueshëm për të gjithë audituesit e brendshëm të sektorit publik pa, kërkuar një miratim të dytë nga këshillat mbikëqyrës të sha-ve. Pra, ky kod nuk ka dashur miratimin e këshillit që të bëhej i zbatueshëm nga njësia e auditit të brendshëm. Vendimi nr.21 datë 20.12.2018 për miratimin në parim të materialit të paraqitur për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri në 31.12.2017 ku shprehet se ngarkohet Administratori i Shoqërisë të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë materialin për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri më 31.12.2017. Ky vendim nuk ka të përcaktuar numrin e rasteve dhe vlerën përkatëse, si dhe nuk është firmosur as nga këshilli as nga hartuesit e saj pasqyra e detyrimeve debitorë llogaria 4671 “Detyrime të tjera në konflikt” gjendje datë 31.12.2017

Kriteri: Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin nr.7926, datë 20.04.1995, për “Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, Udhëzimin e METE nr.318, datë 08.04.2009, VKM nr.570, datë 03.10.2018 për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore dhe me Statutin e “H.Sh.” ShA. të miratuar nga Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me shkresën nr.3260/2 prot, datë 30.04.2012, kreu IV nenet 8-12.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në veprimtarinë e këshillit mbikëqyrës ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe financiar të shoqërisë.

Shkaku: Mungesa e vlerësimit të rëndësisë që ka veprimtaria e këshillit mbikëqyrës për zhvillimin ekonomik financiar të shoqërisë, nëpërmjet drejt;imit dhe orientimit të saktë

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës në të ardhmen të shqyrtojë dhe të analizojë me përgjegjësi relacionet e projekt-vendimeve të shoqërisë H.Sh. ShA. duke kërkuar paraprakisht një vlerësim juridik nga strukturat përkatëse të shoqërisë, me qëllim që vendimet e marra nga ana e tij të kenë bazueshmëri të saktë ligjore, të shprehen qartë duke mos lënë vend për keq interpretim, si dhe në rastet kur e përcakton ligji të mos anashkalohej miratimi i tyre nga ministri përkatës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës të “H.Sh.” ShA., për periudhën objekt auditimi rregullohet me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin nr.7926, datë 20.04.1995, për “Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, Udhëzimin e METE nr.318, datë 08.04.2009, VKM nr.570, datë 03.10.2018 për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore dhe me Statutin e “H.Sh.” ShA. të miratuar nga Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me shkresën nr.3260/2 prot, datë 30.04.2012, kreu IV nenet 8-12.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Nga analiza e këtyre dokumenteve ligjore rezulton se nuk janë të bashkërenduar dhe të harmonizuar nga pikëpamja juridike, pasi:

Në statut neni 9 përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar ndërsa në udhëzim nr.318 dt 08.04.2009 të Ministrit të ish-METE, i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi, kryetari i këshillit zgjidhet me propozim të Ministrit.

-neni 10.1 i statutit të shoqërisë përcakton se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se 2 herë në vit, ndërsa në VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, pika 8, dhe VKM nr.570, Dt 03.10.2018 pika 9, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit.

-neni 12 i statutit për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, e cila aktualisht është e shfuqizuar dhe statuti duhet t’i referohet VKM nr.570 dt 03.10.2018.

Këshilli Mbikëqyrës nuk i ka propozuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë miratimin e ndryshimeve në statutin e shoqërisë, duke e përshtatur atë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 11. Pika 4 të statutit.

-Nuk ka një rregullore të brendshme të organizimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, e cila të jetë edhe e harmonizuar me të gjithë bazën ligjore të funksionimit të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore dhe të veprimtarisë së “H.Sh.” ShA..

-Për periudhën e vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës, nuk e ka kryer veprimtarinë e tij mbi bazën e një programi vjetor të miratuar, në kundërshtim me udhëzimin e METE nr.318, datë 08.04.2009, kreu IV, pika III. 1

Për periudhën objekt auditimi, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë gjithsej 29 vendime. Përgjithësisht vendimet janë marrë konformë dispozitave ligjore.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan shkelje dhe mangësi të dispozitave ligjore, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Nga veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2018 janë zhvilluar gjithsej 8 mbledhje, janë marrë 21 vendime, ndërsa për periudhën 01.01 deri në 31.05.2019 janë zhvilluar 3 mbledhje të Këshillit dhe janë marrë 8 vendime. Janë plotësuar periodikisht deklaratat e anëtarëve të këshillit mbi pjesëmarrjen në këshilla të tjera mbikëqyrës apo borde. Për zhvillimin e mbledhjeve janë bërë njoftimet në kohën e duhur si dhe janë dërguar materialet që do shqyrtohen. Janë mbajtur raporte të rregullta të mbledhjeve nga sekretarja e këshillit mbikëqyrës të cilat janë firmosur nga anëtarët në fund të çdo mbledhje, si dhe për praktikën që kanë lidhje me Këshillin Mbikëqyrës është mbajtur një libër protokollit i veçantë nga ai i drejtorisë.

Për periudhën objekt auditimi anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës kanë qenë A.Sh. përfaqësues i MIE, K.M. përfaqësues i ish-MZHETTS, F.M. përfaqësues i ish-MZHETTS, Th.Xh. nga bota akademike, P.Sh. përfaqësues i MFE, G.K. përfaqësues i MIE, T.B. përfaqësuese e MIE dhe B.A. përfaqësues i MFE, të cilët gjatë viteve janë ndryshuar si më poshtë:

-Me urdhrin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr.133 datë 15.11.2017 janë emëruar anëtarë këshilli z. A.Sh. dhe z. G.K. përfaqësues të MIE.

-Me urdhrin nr.5370 datë 01.07.2015 të ministrit të MZHETTS është emëruar z. K.M. përfaqësues i ish-MZHETS (prej 4 vjetësh)

-Me urdhrin nr.4099 datë 20.04.2017 të ministrit të MZHETTS është emëruar anëtar i këshillit F.M..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Me urdhrin nr.5419, datë 01.07.2016 të ministrit të MZHETTS është emëruar Th.Xh.. (prej 3 vjetësh)

-Me vendimin nr.44 datë 21.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e anëtarit të vetëm të Asamblesë së Përgjithshme të “H.Sh.” ShA. është liruar nga detyra si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës G.K. dhe është emëruar T.B.

-Me vendim e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve nr.73, datë 01.03.2019 është liruar nga detyra e anëtarit të këshillit mbikëqyrës P.Sh. dhe është emëruar B.A., dërguar me shkresën nr.3525 prot datë 01.03.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kryetar të Këshillit Mbikëqyrës kanë qenë G.K. i zgjedhur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 01.12.2017 dhe T.B. e zgjedhur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 04.04.2018.

Të dy këto vendime për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreut II, pika 5.(i cili ka qenë në fuqi në momentin e zgjedhjes së tyre) ku përcaktohet se zgjedhja e tyre duhet të ishte bërë me propozim të Ministrit të METE-s (aktualisht MFE), ose nga përfaqësuesi i tagrave të tij. Këshilli Mbikëqyrës nuk ka zgjedhur zv/kryetarin, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreut II, pika 5 dhe statutit të shoqërisë Neni 9 pika 9.1, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar. Sipas statutit nenit 9.3 dhe 10.1, këshilli mbledhet me kërkesë të kryetarit ose në mungesë të tij të zv/kryetarit. Zgjedhja e zv/ kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj.

-statuti i shoqërisë neni 8.2 përcakton se kohëzgjatja e anëtarëve të këshillit është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje, nga auditimi u konstatua se dy prej anëtarëve të këshillit e kanë mbaruar afatin 3 vjeçar por, nuk ka asnjë shkresë nga ministria për rizgjedhjen e tyre, konkretisht z. K.M. emëruar në datë 01.07.2015 dhe Th.Xh. emëruar në 01.07.2016.

- Këshilli Mbikëqyrës, nuk ka mbajtur raporte në lidhje me mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë vitit financiar, në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë, neni 11, gërma e.

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 04.12.2017 është emëruar Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., A.D. Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë sipas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.17516 prot datë 04.12.2017, nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë me Administratorin e “H.Sh.” ShA. , veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statutin e shoqërisë neni 11, pika i, ku përcaktohet se me emërimin e administratorit të shoqërisë, këshilli lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

Vendimet përgjithësisht janë marrë për miratim rregulloresh, ndryshim strukturë, dhënie me qira të aseteve të shoqërisë, miratim programi ekonomik, nxjerrje jashtë përdorimi etj.

Gjatë shqyrtimit të vendimeve të marra nga këshilli mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se në shumicën e tyre këshilli nuk është i shprehur qartë dhe nuk ka dhënë një vendim të argumentuar, fakt i cili lë vend për interpretim nga ana e shoqërisë.

Psh: Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.6 datë, 30.04.2018, këshilli shprehet se miratohet struktura organizative e Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj por, nuk përcakton



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

numrin e drejtorive dhe numrin e punonjësve respektiv. E njëjta situatë konstatohet edhe me vendimet e miratimit të strukturës organizative për vitin 2019 me vendimin nr.5 dt 7.03.2019 Vendimi nr.2, datë 02.02.2018 për miratimin e Strukturës Organizative dhe Organigramës së “H.Sh.” ShA. me fillim zbatimi nga 01.04.2018 (nga 1068 punonjës do të operohet me 992 punonjës, duke shkurtuar 76 punonjës në total.) Por, numri i punonjësve të miratuar për vitin 2018 ka qenë 1100 punonjës dhe jo 1068 siç shprehet këshilli dhe për të shkuar në numrin 992 duhet të shkurohen 110 punonjës. Në këtë vendim këshilli është bazuar në programin ekonomik të parashikuar nga strukturat e shoqërisë dhe jo në atë të miratuar nga vetë këshilli më përpara.

Vendimi nr.8, datë 30.04.2018 dhe Vendimi nr.4 datë 27.03.2019 ku këshilli shprehet se vendosi në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 Kreu II pika 1/d të këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në njësinë e infrastrukturës sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë por, nuk është shprehur për numrin e këtyre ambienteve ose lista e paraqitur nga administratori të firmosej nga këshilli .

Vendimi nr.12 datë 18.07.2018 për miratimin e Kodit të Etikës të Auditit të Brendshëm. Vendim ky i panevojshëm pasi ky kod është i miratuar me urdhrin nr.56 datë 2015 të Ministrit të Financave dhe është detyrimisht i zbatueshëm për të gjithë audituesit e brendshëm të sektorit publik pa, kërkuar një miratim të dytë nga këshillat mbikëqyrës të sha-ve. Pra, ky kod nuk ka dashur miratimin e këshillit që të bëhej i zbatueshëm nga njësinë e auditit të brendshëm.

Vendimi nr.21 datë 20.12.2018 për miratimin në parim të materialit të paraqitur për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri në 31.12.2017. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë materialin për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri më 31.12.2017.

Ky vendim nuk ka të përcaktuar numrin e rasteve dhe vlerën përkatëse, si dhe nuk është firmosur as nga këshilli as nga hartuesit e saj pasqyra e detyrimeve debitorë llogaria 4671 “Detyrime të tjera në konflikt” gjendje datë 31.12.2017

Nga ana e drejtorisë rezulton se janë nxjerrë urdhra të ndryshëm dhe vendime që kanë të bëjnë me ndryshime për ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë, përgjithësisht këto vendime janë miratuar në parim duke kërkuar më pas edhe miratimin e Organit Mbikëqyrës të Shoqërisë. Nga ana e drejtorisë është raportuar në Këshillin Mbikëqyrës për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë.

Në opinionin e grupit të auditimit, vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës do të ishte më e drejtë, n.q.s projektvendimet (materialet e përgatitura për vendimmarrje në Këshillin Mbikëqyrës), do të vlerësoheshin paraprakisht nga një jurist në funksion të Këshillit Mbikëqyrës.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Për periudhën objekt auditimi, Këshilli Mbikëqyrës i “H.Sh.” ShA. e ka zhvilluar aktivitetin e tij pa një program vjetor të miratuar, nuk ka një rregullore të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së këshillit, statuti i shoqërisë nuk është përshtatur me ndryshimet ligjore dhe nënligjore të bëra për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës së SHA-ve, nuk është zgjedhur zv/kryetari i Këshillit në mes radhëve të antarëve të tij, nuk është lidhur kontratë ndërmjet Këshillit dhe Administratorit, vendimet në disa raste nuk janë të qarta, të shqyrtuara me përgjegjësi dhe në kohë (miratimi i pagave, plani ekonomik, struktura organizative)

Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi G.K. (për periudhën deri në 04.03.2018), T.B. në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

3. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomik-financiar në qendër dhe në njësitë e vartësisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Titulli i Gjetjes: Planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik

Situata: Në Hekurudhën Shqiptare ShA. konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik. Qëllimi i programit ekonomik në përgjithësi është arritja e synimeve të Shoqërisë sipas prioriteteve të saj. Për vitin 2018 sipas analizave të treguesve të buxhetit, realizimi i të ardhurave në raport me planin e të ardhurave, është në masën 93.2 %. Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, performanca e treguesve ekonomik-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet. Në Shoqërinë H.Sh. ShA. për çdo lekë të shpenzuar në vitin 2017 është përfutur një e ardhur prej 0.69 lekë, në vitin 2018 për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.58 leke. Për vitin 2019 për pesëmujorin e parë të vitit për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.53 lekë. Pra siç vërehet për vitin 2018 ka një ulje 0.11 lekë nga viti paraardhës 2017, ndërsa për pesëmujorin e parë të vitit 2019 ka një zvogëlim me 0.05 lekë nga viti 2018. Risku bazë para të cilit ndodhet Shoqërisë “H.Sh.” ShA. është risku i gjendjes të pamjaftueshme të likuiditeteve. Një kompani me aftësi paguese është ajo që zotëron më shumë se sa u detyrohet të tjerëve, me vlerë neto pozitive e borxh të menaxhueshëm. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2018, paraqitet 1.4 % (1.148.514 mijë detyrime /81.895.037 mijë lekë) me tendencë rritje për vitin 2019. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvecion nga buxheti i shtetit për vitin 2016, 2017, 2018 dhe për vitin 2019 në vlerat respektive 390.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvecionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyre të ndjeshme rezultatin financiar (humbje).

Kriteri: Ligji nr.109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, ligji nr.99/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të viti 2019”.

Ndikimi: Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Shkaku: Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së një analize të saktë lidhur me aftësinë e shoqërisë për gjenerimin e të ardhurave si dhe për shkak të analizave jo reale për realizimin e projekteve kapitale. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët, sidomos për të ardhurat dhe investimet kapitale, çka mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të shoqërisë. Ndërsa mungesa e informacioneve lidhur me burimet e financimit mund të rezultojë me mos realizim të projekteve.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Nga ana e organeve drejtuese duhet të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2018

Programi ekonomik-financiar është hartuar nga njësitë e Shoqërisë H.Sh. dhe është miratuar nga Administratori i saj me shkresën nr.1043/1 prot., datë 29.12.2017 përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë i cili me vendimin nr.4 datë 04.04.2018 ka miratuar programin e zhvillimit për vitin 2018 dhe parashikimin për vitin 2019 dhe 2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Programi ekonomik-financiarë është dërguar me shkresën nr.392 datë 12.04.2018 për miratim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kërkesa për miratim i është ridërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.392/1 datë 22.05.2018.

Kur ka përfunduar edhe mbyllja e bilancit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i është ridërguar edhe njëherë kërkesa për miratim të programit ekonomik financiar me shkresën nr.392/2 datë 18.06.2018 ku kolona "realizimi i pritshëm i vitit 2017" në pasqyrat financiare është zëvendësuar me "realizimi i vitit 2017".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar programin ekonomik për vitin 2018 dhe parashikimin për 2019-2020 me shkresën nr.6291/5 datë 09.07.2018.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar programin ekonomik të shoqërisë për vitin 2018 me shkresën nr.13425/1 datë 20.07.2018.

Për vitin 2019

Programi ekonomik-financiar është hartuar nga njësitë e Shoqërisë H.Sh. dhe është miratuar nga Administratori i saj me shkresën nr.1190 prot., datë 29.11.2018 përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë, i cili me vendimin nr.20 datë 20.12.2018 ka miratuar programin e zhvillimit për vitin 2019 dhe parashikimin për vitin 2020 dhe 2021. Me vendim nr.1 datë 10.01.2019 Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë miraton disa ndryshime në programin ekonomik.

Programi ekonomik-financiarë është dërguar me shkresën nr.31 datë 11.01.2019 për miratim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kërkesa për miratim i është ridërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.31/1 datë 21.02.2019.

Kërkesa për miratim i është ridërguar për të tretën herë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.31/2 datë 17.04.2019.

Kërkesa për miratim i është ridërguar përsëri Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.31/3 datë 06.05.2019.

Deri më datën 31.07.2019 datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është bërë miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i programit ekonomik të vitit 2019.

Gjate auditimit janë shqyrtuar burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1 Treguesit ekonomik-financiar të realizuar për periudhën 2017-2019

H.Sh.	2017		2018		2019	
	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim 5 mujori I
Të ardhura	733000000	939500000	772500000	719642017	1124470000	259.155.337
Shpenzime	1281800000	1356900000	1327479000	1246881000	1340120000	487.631.687
Raporti	0.57	0.69	0.58	0.58	0.84	0.53

Burimi i të dhënave H.Sh.

-Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e së të ardhurave, performanca e treguesve ekonomik-financiar, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet.

Në Shoqërinë H.Sh. sha për çdo lekë të shpenzuar në vitin 2017 është përftuar një e ardhur prej 0.69 lekë, në vitin 2018 për çdo lekë të shpenzuar është përftuar një e ardhur prej 0.58 leke. Për vitin 2019 për pesë mujorin e parë të vitit për çdo lekë të shpenzuar është përftuar një e ardhur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

prej 0.53 lekë. Pra siç vërehet për vitin 2018 kanë një ulje 0.11 lekë nga viti paraardhës 2017, ndërsa për pesë mujorin e parë të vitit 2019 ka një zvogëlim me 0.05 lekë nga viti 2018. *Treguesit ekonomiko-financiar, në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon.*

TREGUESIT EKONOMIKO FINANCIAR (në 000/ lekë)				
VITI	2016/Fakt	2017/Fakt	2018/Fakt	2019/Program
TE ARDHURA	566,778	939,533	719,642	1,124,470
SHPENZIME	1,105,692	1,356,898	1,246,881	1,347,730
REZULTATI	(538,914)	(417,365)	(527,239)	(223,260)

Burimi i të dhënave H.Sh.

Referua sa më sipër ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron qartazi paaftësi likuiduese të Shoqërisë “H.Sh.”. Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtra e afatgjata, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj, në vlerën 2.643.960 mijë lekë.

Risku bazë para të cilët ndodhet Shoqërisë “H.Sh.” është risku i gjendjes të pamjaftueshme të likuiditeteve. Një kompani me aftësi paguese është ajo që zotëron më shumë se sa u detyrohet të tjerëve, me vlerë neto pozitive e borxh të menaxhueshëm.

Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2018, paraqitet 1.4 % (1.148.514 mijë detyrime /81.895.037 mijë lekë) me tendencë rritje për vitin 2019. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvencion nga buxheti i shtetit për vitin 2016,2017, 2018 dhe për vitin 2019 në vlerat respektive 390.000 mijë lekë,400.000, mijë lekë 400.000 mijë lekë, do të çonte në **rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore.**

Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyrë të ndjeshme rezultatit financiar (humbje). Përlllogaritja për vitet jepet konkretisht si më poshtë:

TREGUESIT EKONOMIKO FINANCIAR (në 000/ lekë)				
VITI	2016/Fakt	2017/Fakt	2018/Fakt	2019/Programi
TE ARDHURA	176,778	539,533	319,642	724,470
SHPENZIME	1,105,692	1,356,898	1,246,881	1,347,730
REZULTATI	(928,914)	(817,365)	(927,239)	(623,260)

Burimi i të dhënave H.Sh.

Pra kjo shoqëri jo vetëm është në gjendjen e paaftësisë paguese, por është plotësisht e falimentuar.

Më datë 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat: Raiffeisen Bank (7 numra llogarie)me urdhëra sekuestro nr 11, ABI Bank (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Kombëtare Tregtare (11 numra llogarie) me të njëjtet urdhëra sekuestro, Banka Credins (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Pro Credit Bank (1 numër llogarie), Fibank (2 numër llogarie), Alpha Bank (2 numër llogarie), Union Bank (2 numër llogarie),Tirana Bank (1 numër llogarie), Intesa San Paulo (5 numra llogarie)Veneto Bank (1 numër llogarie),Societe Generale (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra me vlerë totale 44,938,145 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Kredia me shoqërinë Mediocredita Centrales Itali, kredi e miratuar me VKM nr.178, datë 18.04 1995, e cila deri në 31.12.2018, është **në vlerën 169.976.294 lekë (pa përfshirë detyrimin ndaj MFE)**.

- Kredia me Bankën Botërore e cila deri në 31.12.2018, është në **vlerën 107.820.000 lekë**.

-Granti japonez i cili deri në 31.12.2018, është në **vlerën 193.314.769 lekë**.

-detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, të cilat deri më datën 31.12.2018 është **në vlerën 218.812.510 lekë** (1.772.909 euro x 123.42kurs këmbimi).

-detyrimeve të tjera më datë 31.12.2018, **në vlerën 1,148,514,060 lekë**.

Si konkluzion kjo performancë mund të rrezikojë vijimësinë e kësaj shoqërie në të ardhmen.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2018 dhe 5-mujorin 2019, treguesit kryesor të realizuar nga HSH dhe njësit e vartësisë paraqiten në tabelën si më poshtë:

H.Sh.	2018	5-mujori 2019
Të ardhura	719.642.000	259.155.337
Shpenzime	1.246.881.000	487.631.687
Raporti	0.58	0.53
Nësia e Biznesit të Mallit		
Të ardhura	159.654.000	46.977.503
Shpenzime	237.889.000	64.373.783
Raporti	0.67	0.73
Njësia e Biznesit të Udhëtarëve		
Të ardhura	404.276.000	167.232.759
Shpenzime	403.629.000	57.376.107
Raporti	1	2.91
Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infstrukturës		
Të ardhura	18.709.000	4.707.543
Shpenzime	605.363.000	298.827.705
Raporti	0.03	0.02
Njësia e Biznesit të mirëmbajtjes të Mjeteve Lëvizëse		
Të ardhura	25.945.000	40.237.510
Shpenzime	0	41.339.156
Raporti		0.97

Burimi i të dhënave H.Sh.

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Titulli i Gjetjes 1: Mosmiratimi i nivelit të pagave nga Ministri i linjës.

Situata: Niveli i pagave për vitin 2018 është miratuar me vendimin i Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2018, ku niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri në dhjetë vjet dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet por, *ky nivel nuk është miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit të vetëm), veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.* Me shkresën nr.129 prot, datë 05.02.2018 dhe nr.129/1 prot., datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA Durrës

07.03.2018 të Administratorit të Përgjithshëm drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është përcjellë për miratim niveli i pagave të punonjësve të shoqërisë, por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka patur përgjigje. E njëjta situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 08.05.2019, janë miratuar tabelat e pagave për punonjësit e Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, duke filluar nga data 01.05.2019. Me shkresën nr.360/1 prot., datë 10.05.2019 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është kërkuar miratimi i nivelit të pagave të miratuara nga shoqëria me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk është kthyer përgjigje. Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti P.Sh. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 01.01.2018-01.03.2018 i cili ka përfutuar vlerën 28,760 lekë, B.A. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët në detyrën e këshilltarit të Ministrit në këtë Ministri, edhe pse nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., ka përfutuar për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, vlerën 64,710 lekë, me pagë bazë 21,570 lekë në muaj. Theksojmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm (Pronari) i Shoqërisë “Hekurudha Shqipare” ShA., Durrës.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti T.B. në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 21.03.2018-31.05.2019, si përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në këtë Ministri, edhe pse nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. ka përfutuar për periudhën 21.03.2018-31.05.2019 vlerën 618,340 lekë, me pagë bazë mujore 43,140 lekë. Theksojmë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Shoqërinë “H.Sh.”, është Ministria e Linjës që monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë shoqëri.

Në opinionin e grupit të auditimit, mos miratimi i programit ekonomik për vitin 2019 nga këto Ministri, mos miratimi i nivelit të pagave, si dhe përdorimin e subvencionit, si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh. ShA. Durrës (trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr.15, datë 23.07.2019), nuk justifikon qenien e këtyre tre përfaqësuesve të lart të këtyre Ministrive në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë “H.Sh.” ShA..

Kriteri: Ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”

Ndikimi/Efekti: Situatë konfuzë dhe e paqartë në shpërblimin e punonjësve të shoqërisë

Shkaku: Mosmiratimi nga pronari i shoqërisë

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga organet drejtuese të “H.Sh.” ShA. të rikërkohët miratimi i nivelit të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave.

Titulli i Gjetjes 2: Nuk është ruajtur raporti ndërmjet shkallëve/nivelit të vjetërsisë dhe kategorive të punës.

Situata 1: Nga vlerësimi i tabelës së pagave konstatohet se nuk është ruajtur raporti i tyre ndërmjet shkallëve të vjetërsisë dhe kategorive të punës, për punonjësit që paguhen me kategori, kryesisht ato të riparimit të mjeteve hekurudhore është barazuar paga e kategorisë I-rë me atë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

kategorisë IV dhe në disa raste me atë të kategorisë V. Për punonjësit e sektorit të lëvizjes dhe mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, është barazuar paga për vjetërsi në punë 1-5 vjet me atë mbi 25 vjet. Paga minimale është përafshuar dhe në disa raste është barazuar dhe me pagën e punonjësve në përbërje të personelit administrativ. Situata e cila krijon demotivimin e punonjësve për punë dhe mund të bëhet shkak për largimin e specialistëve të kualifikuar

Situata 2: Në 27 raste, shefat e sektorëve kanë paga të ndryshme edhe pse kanë emërtim të njëjtë. Konkretisht: Një rast shef i sektorit me pagë 56,000 lekë, 20 raste shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë, 6 raste me pagë 45,000 lekë. Në 2 raste, specialist të thjeshtë kanë pagën 48,900 lekë sa 6 shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë (Specialistët e Sigurimit teknik). Pese specialist PIU edhe pse është strukturë e Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, kanë pagë 75,000 lekë, edhe drejtuesi i kësaj njësie paguhet më shumë se drejtuesit e tjerë, pra me paga preferenciale ndryshe nga specialistët e tjerë të të njëjtit nivel.

Kriteri: Kodi i punës, kontratat kolektive dhe individuale të punonjësve, rregullorja e organizimit dhe funksionimit të HSH ShA. dhe struktura organizative e shoqërisë.

Ndikimi/Efekti: Mos motivim i punonjësve sipas kontributit dhe vështirësisës së vendit tyre të punës.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me shpërblimin e pagës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës i H.Sh. ShA. të rishikohet dhe llogaritet niveli i pagave të punonjësve duke u bazuar në shkallën e vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune duke synuar motivimin e tyre.

Titulli i Gjetjes 3: Risk nga mos përfaqësimi i shoqërisë në proceset gjyqësore.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës/ Sektori Juridik në Njësinë e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore nuk provohet përfaqësimi në 5 raste në gjykatë, si palë e paditur nga ish-punonjësit e larguar. Konkretisht për çështjen me palë paditëse ish punonjësit M.A., A.K., A.K., D.D..

Gjatë auditimit rezultoi se për këto çështje janë protokolluar shkresat e ankimit në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, brenda afateve ligjore të ankimit por, nuk është marr protokoll i Gjykatës së Apelit, fakt i cili nuk dokumenton nëse procedura e ankimit është vazhduar brenda afateve ligjore.

Në opinionin e grupit të auditimit, Shoqëria “H.Sh.” ShA. duhet të jetë shumë e kujdesshme në marrëdhëniet me Gjykatat, për arsye se nga mos paraqitja në gjykatë dhe mos parashtrimi i fakteve mbrojtëse për HSH ShA. (*prapësimeve ndaj padisë*), përbën shkak për humbjen e çështjeve gjyqësore, humbje të cilat ndikojnë negativisht në situatën financiare të shoqërisë.

Kriteri: Kodi i punës, kontrata kolektive dhe kontratat individuale të punësimit, kodi i procedurës civile, kodi i procedurës administrative, rregullore e brendshme e funksionimit të HSH ShA...

Ndikimi/Efekti: Risk i mundshëm që shoqëria mund të penalizohet financiarisht nga proceset gjyqësore në vazhdim.

Shkaku: Ekzekutim i vendimeve gjyqësore nga shoqëria për proceset të cilat lidhen me zgjidhjen e kontratës së punësimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Shoqëria “H.Sh.” ShA. duhet të jetë shumë e kujdesshme në marrëdhëniet me Gjykatat, për arsye se nga mos paraqitja në gjykatë dhe mos parashtrimi i fakteve mbrojtëse për HSH ShA. (*prapësimeve ndaj padisë*), përbën shkak për humbjen e çështjeve gjyqësore, humbje të cilat ndikojnë negativisht në situatën financiare të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes 4: Nga mos kryerja e ankimit brenda afateve të përcaktuara në ligj në Gjykatën e Apelit shoqëria është penalizuar në dy raste për vlerën 3,068,020 lekë.

Situata: Në dy raste për vlerën 3,068,020 lekë u konstatua se Shoqëria “H.Sh.” ShA. është penalizuar nga mos ndjekja e shkallëve të gjykimit të Gjykatës së Apelit. Konkretisht:

Me urdhër transfertën datë 6 shkurt 2017 të Raiffeissen Bank në shumën 957.360 me përfitues L.G. sipas vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016 të lidhur ndërmjet përmbartuesit gjyqësor privat dhe ish-administratorit I.D. Ky transaksion është nënshkruar nga ish-administratori I.D. dhe nën/zbatues A.H.

Me urdhër transfertën datë 09.12.2016 në Raiffeissen Bank ndaj L.G., është likuiduar kësti në shumën 957.360 lekë sipas vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pagesë ndaj L.G..

Shuma totale e likuidimit është në vlerën **1,914,720 lekë**.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit gjyqësorë Durrës me nr.(11-2019-2703) 730 datë 15.05.2019, nuk është bërë apelim, veprim në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues dhe si pasojë e mos apelimit Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit i është krijuar një dëm ekonomik në vlerën 1,914,720 lekë. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik.

Me mos kryerjen e ankimit në Gjykatën e Apelit nga SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit Juridik në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues, provon se me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mos përbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 1,914,720 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në vendimin nr.(11-2018-3332) 1106 me datë 02.07.2018 H.Sh. ka humbur në procesin gjyqësorë me palë paditëse B.Gj., vendim i cili ka marrë formë të prerë në datë 07.08.2018 dhe i është përcjellë përmbartimit shtetërorë dhe privat për ekzekutim pasi të ketë marrë formë të prerë. Në këtë proces Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, ka qenë e përfaqësuar nga juriste L.A. me autorizimin me datë 23.04.2018. Lidhur me këtë praktikë ankimi i vendimit në gjykatën e Apelit është bërë jashtë afateve ligjore në datë 09.08.2019, duke i shkaktuar dëm ekonomik Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës, në vlerën 1,153,300 lekë.

Në bazë të praktikës së ndjekur nga H.Sh. vendimet gjyqësore të cilat vijnë në Shoqërinë “H.Sh.” SHA, Durrës kalojnë nga administratori tek NJSHBM dhe kjo njësi duhet t’i kalojë për ndjekje tek sektorët sipas rastit (praktikë kjo e konfirmuar nga sekretarja e administratorit M.A.). Në rastin e B.Gj., administratori i HSH ka qenë me leje dhe për pasojë administratori referuar kodit të procedurës dhe statutit të shoqërisë i ka deleguar kompetencat e tij zv/administratorit të shoqërisë z. S.P. me autorizimin nr.799/1 prot., datë 19.07.2018.

Vendimi nuk është protokolluar në Hekurudhën Shqiptare SHA, Durrës në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat shtetërore”, i ndryshuar, por nga dokumentacioni i marrë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SHa DURRËS

Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës, nga sekretarja M.A. provohet se ky vendim ka ardhur në Shoqërinë “H.Sh.” SHA, Durrës, më datë 23.07.2018 dhe ky vendim i është përcjellë dorazi më datë 25.07.2018 SH.Xh.t me detyrë shef i sektorit juridik Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, (sipas deklaratës së sekretar-protokollistes M.A. datë 31.07.2019), i cili sipas (sipas deklaratës të juristes L.A. datë 30.07.2019) ja ka kaluar për kompetencë kësaj juristeje në datë 08.08.2019 këtë procedurë, po dorazi.

Po më datën 08.08.2019 juristja L.A. me detyrë shefe e sektorit juridik në NJBMI ka përpiluar ankimimin për në Gjykatën e Apelit i cili është protokolluar me dt 08.08.2019 në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës dhe sipas citimeve të saj është depozituar në Gjykatë në datë 09.08.2019. Pra në datën 09.08.2018 ka mbaruar afati i ankimimit, afat i cili është 15 ditë, referuar Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, 442 e në vijim.

Referuar sa më sipër nga data 25.07.2018 deri më datën 08.08.2018 datë në të cilën përfundon afati i ankimimit, është mbajtur nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik , pastaj i është dhënë dorazi juristes L.A..

Për këtë praktik në datë 12.11.2018 është mbajtur një procesverbal ndërmjet përmbartuesit gjyqësorë privat Luan Hoti dhe shefit të sektorit juridik SH.Xh.. Në këtë procesverbal SH.Xh. në tejkallim të kompetencave të tij ka firmosur një procesverbal të veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit i cili deklaron në emër të Hekurudhës se: *Jemi në dijeni të detyrimit dhe procedurës përmbartimore nuk kemi kundërshtime dhe se HSH do të shlyejë detyrimin me këste. Gjithashtu në rast se HSH do të krijojë likuiditet të mjaftueshëm mund ta shlyejmë si detyrim total para kohe. Ky procesverbal i ka kaluar sektorit të financës për ndjekje dhe veprim nga drejtuesi i njësisë ekonomike A.H. në datë 12.11.2018 (brenda të njëjtës ditë). Këta dy punonjës janë në kushtet e tejkallimit të kompetencave, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Administrative.*

Për këtë subjekt është likuiduar vlera prej **1,153,300** lekë me 6 urdhër transfertë bankare.

Me mos kryerjen e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik në kundërshtim Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues, i cili provon se me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 1,153,300 lekë, vlerë që përbën dëm ekonomik për Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar praktikës së procedurave të ndjekura ndërmjet NJBMI dhe NJSHBM-së procedura behet me shkresë përcjellëse konkretisht në lidhje me vendim nr.(11-2018-2486) 844 datë 18.05.2018 të rrethit gjyqësor Durrës me palë paditëse S.Sh. dhe palë të paditur Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk janë kaluar me shkresë përcjellëse

Ndërsa pas kësaj praktike përcjellja e vendimeve gjyqësore është bërë me shkresa përcjellëse konkretisht me shkresën nr.568/1 datë 10.05.2019 të administratorit të shoqërisë është dërguar tej NJBMI vendimi i gjykatës së Apelit Durrës i cili i përket palës paditëse z. S.Sh..

Kriteri: Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues. Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik shoqërisë në vlerën 3,068,020 lekë

Shkaku: Tejkallim kompetencash nga drejtori i njësisë ekonomike dhe shefi I sektorit juridik mos kryerje e detyrave funksionale bazuar në rregulloren e H.Sh. ShA..

Rëndësia: E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Rekomandime: Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera 3,068,020 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me penalizmin në dy raste të shoqërisë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L.G. në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016, shuma totale e likuidimit është në vlerën 1,914,720 lekë si dhe B.Gj. në shumën totale 1,153,300 lekë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “H.Sh.” ShA. dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik”.

Titulli i Gjetjes 5: Shoqëria është penalizuar nga vendimet gjyqësore si pasojë e zgjidhjes së kontratave të punësimit.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 11 vendime të formës së prerë në vitet 2018, 5-mujori 2019 me vlerë të efektit negativ financiar në shumën 10,953,875 lekë. Ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjykimit, fakt i cili riskon ta rëndojë akoma më tej situatën financiare të shoqërisë në të ardhmen n.q.s këto procese do të fitohen nga ish-punonjësit

Kriteri: Kodi i punës, kontrata kolektive dhe kontratat individuale të punësimit, kodi i procedurës civile.

Ndikimi/Efekti: Efekt financiar shoqërisë në vlerën 10,953,875 lekë

Shkaku: Ekzekutim i vendimeve gjyqësore nga shoqëria për proceset të cilat lidhen me zgjidhjen e kontratës së punësimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 5.1: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë H.Sh. SHA, Durrës, duhet të shqyrtojë efektin financiar në vlerën totale **10,953,875 lekë**, e cila ka ardhur si pasojë e zgjidhjes së pa arsyeshme të kontratës së punësimit të punonjësve.

Rekomandimi 5.2: Për çështje gjyqësore të hapura në vitet e kaluara me punonjës të larguar, për të cilat konfirmohet se janë çështje të humbura Administratori i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës të njohë provizionet për të gjitha vendimet gjyqësore si ngjarje detyruese të ndodhur para datës së raportimit, për të cilat është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për shoqërinë dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij (Referenca ligjore SKK6).

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nr.415/1 datë 07.06.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Kontrata kolektive e lidhur ndërmjet administratorit dhe përfaqësuesit të sindikatës së pavarur.
- 2) Kontratat individuale
- 3) Rregullorja e organizimit dhe funksionimit.
- 4) Struktura organizative e shoqërisë
- 5) Vendime të miratimit të strukturës.
- 6) Listëpagesat me zgjedhje

Për periudhën objekt auditimi marrëdhëniet e punës në “Hekurudhën Shqiptare” ShA. janë rregulluar në bazë të:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

- Kodit të Punës së RSH, ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.
 - Kontratës kolektive të lidhur në datë 22.02.2016, ndërmjet Administratorit të Shoqërisë në cilësinë e punëdhënësit dhe përfaqësuesit të sindikatës së pavarur të transportit hekurudhor e njohur në bazë të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, me afat për një periudhë tre vjeçare nga data e nënshkrimit të saj.
 - Kontratës kolektive të lidhur në datë 01.02.2019 ndërmjet Administratorit të Shoqërisë në cilësinë e punëdhënësit dhe përfaqësuesit të sindikatës së pavarur të transportit hekurudhor e njohur në bazë të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë me afat për një periudhë pesë vjeçare nga data e nënshkrimit të saj.
 - Kontratave individuale të punës të lidhura ndërmjet punonjësve dhe njësive përkatëse përfaqësuar nga drejtuesi i tyre në cilësinë e punëdhënësit, e drejtë e deleguar për rastet e njësive nga administratori me vendimin nr.8, datë 12.07.2018, ku në bazë të rregullores së Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës neni 5 pika 15, ka miratuar draft- kontratat individuale të punës për vitin 2018 dhe ka autorizuar të gjithë drejtuesit e njësive për nënshkrimin e kontratës individuale të punës me të gjithë punonjësit në varësi.
 - Rregulloren e organizimit dhe funksionimit si dhe strukturën organizative të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.3, datë 14.06.2013 për periudhën e auditimit të tre mujorit të parë të 2018.
 - Struktura organizative dhe organiG. e shoqërisë miratuar me vendimin nr.2 datë 02.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës me fillim zbatimi nga 01.04.2018, ku numri i punonjësve është reduktuar në 992 punonjës.
- Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, menaxhohet nga Administratori dhe sipas strukturës organizative të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.2 datë 02.02.2018, është e organizuar në gjashtë njësi si më poshtë:
- Administratori i Shoqërisë 1
 - ZV/Administratori i Shoqërisë 1
 - Zyra e Asistencës pranë Administratorit të Shoqërisë (2 këshilltar, 1 specialist, 1 sekretare, 1 shofer)
 - Njësia Ekonomike (1 drejtues, 2 shefa sektorësh, 5 specialist, 1 shofer)
 - Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse(1 drejtues, 4 shefa sektorësh, 14 specialist, 1 shofer)
 - Njësia e Biznesit të Udhëtarëve 160 (1 drejtues, 1 zv/drejtues, 4 shefa sektorësh, 18 specialist, 1 shofer, 135 fuqi punëtore)
 - Njësia e Biznesit të Mallrave 109 (1 drejtues, 1 zv/drejtues, 1 kryetar dege, 3 shefa sektorësh, 12 specialist, 1 shofer, 90 fuqi punëtore)
 - Njësia e Biznesit të Menaxhim Infrastrukturës Hekurudhore (1 drejtues njësie, 2 zv/drejtues, 9 shefa sektorësh, 20 specialist, 6 shofer, 557 fuqi punëtore)
 - Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse (1 drejtues, 1 zv/drejtues, 1 krye/inxhinier, 5 shefa sektorësh, 2 përgjegjës, 9 specialist, 1 shofer, 64 fuqi punëtore)
 - Sektori Auditimit të Brendshëm (1 shef sektori, 2 auditues)
 - Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) (1 drejtues, 5 specialist)
- Kjo strukturë është ndryshuar në 2019 sipas vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës nr.5 datë 27.03.2019 dhe Administratorit sipas rastit trajtuar më poshtë.
- Në total struktura organizative e miratuar për periudhën e vitit 2018 dhe 5-mujori 2019 ka 992 punonjës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se struktura organizative e “H.Sh.” ShA. Durrës, ka nevojë për përmirësim. Sektorët nuk janë të organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Në opinionin e grupit të auditimit ka struktura të tepërta, të cilat duhet të suprimohen, (psh: në Njësinë e Biznesit të Mallit, Dega e Marketingut dhe Kontrollit të Veprimtarisë ka në strukturë kryetar dege dhe 2 shefa sektorësh, sektori teknik dhe sektori i marketingut. Në Sektorin e Marketingu bëjnë pjesë 2 specialiste, ku njëri ndjek harxhimin e karburantit për lokomotiva, punë me natyrë krejtësisht teknike, po ashtu edhe kontrolluesi i veprimtarisë, zbërthim grafiku është me natyrë krejtësisht teknike). Detyrat e Kryetarit të Degës, shefit të sektorit të marketingut dhe specialistit të marketingut janë pothuajse të njëjta. Organizimi i kësaj strukturë do të ishte mirë të bëhej në nivel sektori. Pra, struktura e kësaj njësie mund të jetë më e reduktuar.

Në Njësinë Ekonomike ekziston Sektori i Programimit, i cili ka për detyrë të merret me hartimin e programeve ekonomike përfshirë dhe fondin e pagave. Nivelin e pagave për çdo punonjës e llogarit Sektori i Burimeve Njerëzore në varësi të Njësisë së Shërbimeve të Mbështetëse, kur mund të llogaritet nga Sektori i Programimit, i cili ka në përbërje dy ekonomistë me arsim të lartë. Në rregullore të brendshme duhet të suprimohen dublimi i detyrave në nivelet e menaxhimit.

Niveli i pagave për vitin 2018 është miratuar me vendimin i Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2018, ku niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri në dhjetë vjet dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet por, **ky nivel nuk është miratuar** nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit të vetëm), veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.

Me shkresën nr.129 prot, datë 05.02.2018 dhe nr.129/1 prot., datë 07.03.2018 të Administratorit të Përgjithshëm drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është përcjellë për miratim niveli i pagave të punonjësve të shoqërisë, por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka patur përgjigje. E njëjta situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 08.05.2019, janë miratuar tabelat e pagave për punonjësit e Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, duke filluar nga data 01.05.2019. Me shkresën nr.360/1 prot., datë 10.05.2019 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është kërkuar miratimi i nivelit të pagave të miratuara nga shoqëria me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk është kthyer përgjigje.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë ngarkon me përgjegjësi P.Sh. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 01.01.2018-01.03.2018 përfituar për 01.01.2018-01.03.2018, vlerën 28,760 lekë, B.A. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët në detyrën e këshilltarit të Ministrit në këtë Ministri, edhe pse nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., ka përfituar për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, vlerën 64,710 lekë, me pagë bazë 21,570 lekë në muaj. Theksojmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm (Pronari) i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” ShA., Durrës.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkon me përgjegjësi T.B. në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

periudhën 21.03.2018-31.05.2019, si përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në këtë Ministri, edhe pse nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. ka përfituar për periudhën 21.03.2018-31.05.2019 vlerën 618,340 lekë, me pagë bazë mujore 43,140 lekë. Thëksojmë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Shoqërinë “H.Sh.”, është Ministria e Linjës që monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë shoqëri.

Në opinionin e grupit të auditimit, mos miratimi i programit ekonomik për vitin 2019 nga këto Ministri, mos miratimi i nivelit të pagave, si dhe përdorimin e subvencionit, si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh. ShA. Durrës (trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr.15, datë 23.07.2019), nuk justifikon qenien e këtyre tre përfaqësuesve të lart të këtyre Ministrive në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë “H.Sh.” ShA.. Nga vlerësimi i tabelës së pagave konstatohet se nuk është ruajtur raporti i tyre ndërmjet shkallëve të vjetërsisë dhe kategorive të punës, për punonjësit që paguhet me kategori, kryesisht ato të riparimit të mjeteve hekurudhore është barazuar paga e kategorisë I-rë me atë të kategorisë IV dhe në disa raste me atë të kategorisë V. Për punonjësit e sektorit të lëvizjes dhe mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, është barazuar paga për vjetërsi në punë 1-5 vjet me atë mbi 25 vjet. Paga minimale është përafëruar dhe në disa raste është barazuar dhe me pagën e punonjësve në përbërje të personelit administrativ. Situata e cila krijon demotivimin e punonjësve për punë dhe mund të bëhet shkak për largimin e specialistëve të kualifikuar.

Në opinionin e grupit të auditimit, motivimi në punë duhet të bëhet sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës. Psh. një ekonomist marketingu nuk ka pse të paguhet më shumë se një ekonomist finance për vetë faktin se natyra e punës është e njëjtë.

Nga auditimi konstatohet se rreth 890 punonjës nga rreth 999 që ka mesatarisht aktualisht shoqëria ose 89 % e tyre, trajtohen me pagë minimale.

Të punësuar mesatarisht	Numri i të punësuarve Viti 2018	Numri i të punësuarve Viti 2019
Me pagë deri në 22.000 lekë	-	-
Me pagë nga 22.001 deri në 30.000 lekë	897	886
Me pagë nga 30.001 deri në 66.500 lekë	82	75
Me pagë nga 66.501 deri në 97.030 lekë	13	13
Me pagë më të lartë se 97.030 lekë	7	8
Totali	999	982

Tabela 2 Numri i punonjësve sipas niveleve të pagave

Burimi: H.Sh. SHA

Në 27 raste, shefat e sektorëve kanë paga të ndryshme edhe pse kanë emërtim të njëjtë. Konkretisht: Një rast shef i sektorit me pagë 56,000 lekë, 20 raste shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë, 6 raste me pagë 45,000 lekë. Në 2 raste, specialist të thjeshtë kanë pagën 48,900 lekë sa 6 shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë (Specialistët e Sigurimit teknik).Pesë specialist PIU edhe pse është strukturë e Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, kanë pagë 75,000 lekë, edhe drejtuesi i kësaj njësie paguhet më shumë se drejtuesit e tjerë, pra me paga preferenciale ndryshe nga specialistët e tjerë të të njëjtit nivel.

-Sektori i Auditit të Brendshëm auditon punën e Drejtuesve të Njësive, shefave të sektorëve etj, por pagesa e tyre është shumë më e ulët se paga e personave që auditojnë. Konkretisht paga e shefes sektorit të Auditimit është 48,900 lekë, sa një specialist i sigurimit teknik të Infrastrukturës. Në përcaktimin e pagës për shefin e sektorit të auditimit nuk është marrë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

parasysh fakti që paga e Shefit të Sektorit të Auditimit në periudhën e më përparshme ka qenë e llogaritur dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në bazë të pagës së grupit 9,000 lekë + shtesë për pozicion 55,000 lekë + shtesë vjetore për vjetërsi. Në opinionin e grupit të auditimit, ky sektor duhet të konsiderohet si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bën.

Për vitin 2018, numri i punonjësve, dhe fondi i pagave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia e Matjes	Viti 2018			
			Plan	Fakt 2018	Fakti nga Realizimi i Programit Ekonomik	Realizimi në %
1	Numri mesatar i punonjësve	Numri mesatar/muaj	1019	999	-20	98%
2	Fondi i pagave	Lekë	362.540.000	341.390.000	-21.150.000	94%
3	Sigurime Shoqërore	Lekë	54.380.000	51.700.000	-2.680.000	95%
4	Sigurime Shëndetësore	Lekë	6.160.000	5.900.000	-260.000	96%
5	TAP-i	Lekë	6.000.000	4.000.000	-2.000.000	67%
6	Paga mesatare	Lekë	29.883	28.477		
7	Punonjës në Asistencë	Nr.	89	38		42%
8	Fondi i pagave për Asistencën	Lekë	4.000.000	5.000.000	1.000.000	125%
9	Shpërblimet	Lekë	-	-	-	-

*Tabela 3 Të dhënat plan-fakt për numrin e punonjësve
Burimi: H.Sh. SHA*

Siç, shihet në tabelë, për vitin 2018, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë brenda kufirit të parashikuar, ndërsa numri mesatar i punonjësve në asistencë të parashikuar është realizuar në masën 42%, por fondi i parashikuar për këtë zë është tejkaluar në masën 125 %. Ç’ka do të thotë që planifikimi i fondit të asistencës nga ana e “H.Sh.” ShA., Durrës nuk është bërë konformë nevojës reale që ka kjo shoqëri për fond asistence, ç’ka ngarkon me përgjegjësi sektorin e programimit dhe njësinë ekonomike.

Janë kontrolluar listë pagesat e vitit 2018 dhe ka tejkallim në strukturë sipas tabelës më poshtë:

Nr	Muaj	Nr faktik	Nr strukturës	Diferenca
1	Janar	1038	1100	-62
2	Shkurt	1031	1100	-69
3	Mars	1029	1100	-71
4	Prill	1024	992	32
5	Maj	1010	992	18
6	Qershor	997	992	5
7	Korrik	992	992	0
8	Gusht	979	992	-13
9	Shtator	972	992	-20
10	Tetor	967	992	-25
11	Nëntor	967	992	-25
12	Dhjetor	975	992	-25

*Tabela 4 Listë pagesat e vitit 2018
Burimi i të dhënave: H.Sh. SHA*

Për 5 mujorin e vitit 2019, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shëndetësore janë brenda kufirit të parashikuar, si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Nr	Emërtimi	Njësia e Matjes	Viti 2019			
			Plan	5 MUJORI	Fakti nga Realizimi i Programit Ekonomik	Realizimi në %
1	Numri mesatar i punonjësve	Numri mesatar/muaj	992	982		
2	Fondi i pagave	Lekë	151.600.000	147.900.000	-3.700.000	97%
3	Sigurime Shoqërore	Lekë	22.727.500	22.400.000	-337.500	98%
4	Sigurime Shëndetësore	Lekë	2.580.000	2.500.000	-80.000	97%
5	TAP-i	Lekë	2.792.000	1.800.000	-992.000	65%
6	Paga mesatare	Lekë	30.565	30.122		
7	Punonjës në Asistencë	Nr	-	-		
8	Fondi i pagave për Asistencën	Lekë	2.083.000	-	-2.083.000	0%
9	Shpërblimet	Lekë	-	-		

*Tabela 5 Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shëndetësorë
Burimi i të dhënave: H.Sh. ShA.*

U audituan listë pagesat e vitit 2019 dhe nuk u konstatuan tejkalim në strukturë:

Muaji	Nr.real	Struktura e miratuar	
Janar	978	992	-14
Shkurt	980	992	-12
Mars	977	992	-15
Prill	987	992	-5
Maj	988	992	-4

*Tabela 6 Listë pagesat e vitit 2019
Burimi i të dhënave: H.Sh. ShA.*

Për të verifikuar llogaritjen kontributit të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat, u krye auditim me zgjedhje. Konkretisht u audituan listëpagesat e muajve Prill, Qershor, Shtator, Dhjetor 2018.

Është përllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas akteve ligjore për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Afatet e deklaramit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës.

Nga verifikimi i sistemit tatimor, nuk kanë gjoba dhe kamatëvonesa të aplikuar.

Nga auditimi u konstatua se gjatë të gjithë periudhës objekt auditimi nga strukturat drejtuese të shoqërisë struktura organizative dhe organiG. e shoqërisë, ka pësuar ndryshime duke i kaluar fuqia punëtore nga një njësi në tjetrën, si dhe duke shtuar kritere të tjera arsimore nga ato të miratuara në fillim të vitit 2018, fakt i cili tregon se nga ana e organeve drejtuese të Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, nuk janë parashikuar saktë nevojat e fuqisë punëtore për çdo njësi si dhe nuk janë analizuar dhe argumentuar nevojat e fuqisë punëtore, duke e lidhur me nivelin dhe llojin e shërbimeve që kryen çdo njësi në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës. Kështu me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr.6 datë, 30.04.2018 për miratimin e strukturës organizative të Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.17 datë 13.11.2018, për miratimin e draft rregullore së organizimit dhe funksionimit të shoqërisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.19 datë 13.11.2018 për miratimin e ndryshimit në kriterin arsimor për postin zv/ drejtues nën/njësine e shërbimeve duke i shtuar kriterin arsimor shkenca juridike dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

postin zv/drejtues i nën/njesisë së Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore, duke i shtuar kriterin arsimor inxhinieri mekanike, në njësinë e biznesit, menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.5, datë 27.03.2019, janë miratuar ndryshime në strukturat organizative të shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj. Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.8, datë 08.05.2019, është miratuar në parim një shtesë në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë, duke shtuar në atë ekzistuesen funksionet e K/inxhinierit të shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës.

Ndryshimet e strukturës me vendime të administratorit janë mbështetur në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.8 datë 23.07.2014 pika 3, konkretisht:

Me shkresën nr.465/1 datë 03.05.2018 e Administratorit të Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, drejtuar NJBMI, NJBU, NJBM, është kaluar personeli i rojeve të objektit pranë Njesisë së Biznesit Udhëtar 12 roje dhe 4 roje njësisë së biznesit të mallit nga NJMBI. Me shkresën nr.929/1 datë 17.09.2018 është transferuar stacioni Sukth, i cili ka kaluar në administrim të stacionit Shkozet nga stacioni Vorë ku 20 punonjës kanë kaluar në administrim nga stacioni Shkozet. Me shkresën 980/1 datë 01.10.2018 në zonën e Kasharit është shkurtuar një punëtor linje dhe nga tre vëzhgues është bërë me 4 vëzhgues linje. Me shkresën nr.1027 datë 02.10.2018 urdhër i brendshëm i administratorit të shoqërisë, është bërë ndryshimi i strukturës organizative për pozicionin e Kryeinxhinjerit, i cili është transferuar po me të njëjtën detyrë në njësinë qendrore nga NJBMI, me arsyetimin e informacionin në kohë për çdo incident lidhur me Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, si person i autorizuar nga Administrator i Shoqërisë për të komunikuar me shtabin e emergjencave civile pranë MIE.

Me shkresën nr.1035/1 datë 05.10.2018 zona Vorë –Budëll nga 3 vëzhgues bëhet me katër vëzhgues linje. Me shkresën 977/1 datë 18.10.2018 e Administratorit të HSH stacioni Golem-Kavaj-Lekaj-Rrogzhinë, ndahet në dy stacione Golem – Kavaj dhe Lekaj-Rrogzhinë, duke i shtuar inspektorit të shërbimit në stacionin Lekaj –Rrogzhinë detyrën e shefit të stacionit.

Me shkresën nr.920/1 datë 31.10.2018, ndryshuar me shkresën 920/3 prot., datë 13.11.2018 të Administratorit të Shoqërisë në Zonën e Bajzës janë shtuar dy roje objekti në NJBM, të cilët janë shkurtuar si poste pune në njësinë e BMI, duke mbetur brenda numrit 992 të fuqisë punëtore.

Me shkresën 38/1 prot., datë 18.01.2019 në NJBM dy pozicione pune mashinist/nd.mashinist hiqen nga nën/njësia rajonale Durrës Tiranë dhe i shtohen për efekt ngarkese n/njesisë rajonale të veriut.

Për sa më sipër, në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, janë konstatuar lëvizje të shumta të punonjësve në pozicione të ndryshme pune brenda strukturës së saj, si dhe në largime nga puna ashtu dhe në marrjen në punë. Konkretisht për periudhën objekt auditimi, janë punësuar gjithsej 193 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 254 punonjësve, sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	2018	2019
Punësime	140	53
Largime	202	52

Tabela 7 Punësime dhe largime nga puna 2018-2019
Burimi i të dhënave: H.Sh. ShA.

Këto lëvizje të shumta nuk janë reflektuar gjithmonë në procese gjyqësore, pasi një pjesë e largimeve vijnë si rezultat i daljeve në pension, një pjesë nga mos paraqitja në punë, dalja në KEMP, dorëheqje, suprimim i vendit të punës si pasojë e ristrukturimit, etj. Kjo shoqëri e ndodhur prej një periudhe të gjatë në kushtet e vështirësisë financiare, ka synuar uljen e fuqisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

punëtore me qëllim uljen e shpenzimeve për paga dhe sigurime, për këtë arsye numri i pranimeve në punë ka qenë gjithmonë më i vogël në krahasim me punësimet.

Për vitin 2018, mbas miratimit në Këshillin Mbikëqyrës, me urdhër të Administratorit të Shoqërisë, është filluar procedura për pushimin kolektiv nga puna ku janë larguar 38 punonjës. Procedura që është zbatuar për largimet nga puna ka përfshirë informimin, konsultimin e sindikatës së punëmarrësve, dhe nënshkrimin e një akt marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësve.

Nga auditimi konstatohet se rreth 28 punonjës të larguar dhe të trajtuar me asistencë, si dhe disa të larguar me leje pa të drejtë page, janë parë me prioritet nga ana e organeve drejtuese të shoqërisë dhe janë rimarrë në punë në Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës.

Faktikisht reduktimi i punëtorëve nuk ka qenë zgjidhje ekonomike për uljen e shpenzimeve pasi për periudhën objekt auditimi, punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna kanë hapur procese gjyqësore për të cilat një pjesë kanë përfunduar dhe një pjesë janë në shqyrtim. Për largimet nga puna të pajustificuara, nga punonjësit e larguar janë ngritur 31 padi ndaj shoqërisë “H.Sh.” ShA., gjatë viteve 2017 (të cilat janë paguar në vitin 2018), 2018 dhe 5-mujorin 2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, nga Sektori Juridik në Njësinë e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore nuk provohet përfaqësimi në 5 raste në gjykatë, si palë e paditur nga ish-punonjësit e larguar. Konkretisht për çështjen me palë paditëse ish-punonjësit M.A., A.K., A.K., D.D..

Por, nga verifikimi rezultoi se për këto çështje janë protokolluar shkresat e ankimimit në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, brenda afateve ligjore të ankimimit por, nuk është marr protokoll i Gjykatës së Apelit.

Në opinionin e grupit të auditimit, Shoqëria “H.Sh.” ShA. duhet të jetë shumë e kujdesshme në marrëdhëniet me Gjykatat, për arsye se nga mos paraqitja në gjykatë dhe mos parashtrimi i fakteve mbrojtëse për HSH ShA. (*prapësimeve ndaj padisë*), përbën shkak për humbjen e çështjeve gjyqësore, humbje të cilat ndikojnë negativisht në situatën financiare të shoqërisë.

-11 punonjës të larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore për të cilat janë marrë vendime të formës së prerë në vitet 2018-5-mujorin 2019 me vlerë **10,953,875** lekë e cila përbën efekt financiar negativ (*shuma e vendimeve të gjykatës në vlerën 9.914.255 lekë + shpenzime përmbarrimore në shumën 1.039.620 lekë*) likuiduar nga sektori i financës (Tabela. 7), ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjykimit, fakt i cili rrisht rëndësinë akoma më shumë situatën financiare në këtë shoqëri.

1	B.M.(Njbmi)	457,687
2	N.P.(Qender)	596,176
3	L.S.(Njbu)	392,700
4	Rr.P.(Njbmi)	862,400
5	N.Sh. (Njbm)	367,000
6	Q.T.(Njbminf)	862,400
7	G.Gj.(Njbminf)	2,311,540
8	B.Gj.(Njbm)	1,153,300
9	A.N.(Njbminf)	1,691,120
10	A.Sh.(Njbminf)	480,208
11	S.Sh.(Njbm)	1,779,344
TOTALI		10.953.875



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURREË

*Tabela 8 Likuiduar nga financa vendim gjykate plus shpenzime gjyqësore.
Burimi i të dhënave: H.Sh. ShA.*

Theksojmë se këto janë procese gjyqësore të mbartura nga viti 2017 dhe efekti financiar i likuiduar nga shoqëria është bërë gjatë periudhës objekt auditimi.

Në dy raste për vlerën 3,068,020 lekë u konstatua se Shoqëria “H.Sh.” ShA. është penalizuar nga mos ndjekja e shkallëve të gjykimit të Gjykatës së Apelit. Konkretisht:

-Me urdhër transfertën datë 6 shkurt 2017 të Raiffeissen Bank në shumën 957.360 me përfitues L.G. sipas vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016 të lidhur ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe ish-administratorit I.D. Ky transaksion është nënshkruar nga ish-administratori I.D. dhe nën/zbatues A.H.

Me urdhër transfertën datë 09.12.2016 në Raiffeissen Bank ndaj L.G., është likuiduar kësti në shumën 957.360 lekë sipas vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pagesë ndaj L.G..

Shuma totale e likuidimit është në vlerën **1,914,720 lekë**.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit gjyqësorë Durrës me nr.(11-2019-2703) 730 datë 15.05.2019, nuk është bërë apelim, veprim në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile|, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues dhe si pasojë e mos apelimit Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit i është krijuar një dëm ekonomik në vlerën 1,914,720 lekë. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik.

Me mos kryerjen e ankimimit në Gjykatën e Apelit nga SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit Juridik në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile|, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues, provon se me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 1,914,720 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në vendimin nr.(11-2018-3332) 1106 me datë 02.07.2018 H.Sh. ka humbur në procesin gjyqësorë me palë paditëse B.Gj., vendim i cili ka marrë formë të prerë në datë 07.08.2018 dhe i është përcjellë përmbarimit shtetërorë dhe privat për ekzekutim pasi të ketë marrë formë të prerë. Në këtë proces Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, ka qenë e përfaqësuar nga juriste L.A. me autorizimin me datë 23.04.2018. Lidhur me këtë praktikë ankimimi i vendimit në gjykatën e Apelit është bërë jashtë afateve ligjore në datë 09.08.2019, duke i shkaktuar dëm ekonomik Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës, në vlerën 1,153,300 lekë.

Në bazë të praktikës së ndjekur nga H.Sh. vendimet gjyqësore të cilat vinë në Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës kalojnë nga administratori tek NJSHBM dhe kjo njësi duhet t’i kalojë për ndjekje tek sektorët sipas rastit (praktikë kjo e konfirmuar nga sekretarja e administratorit M.A.). Në rastin e B.Gj., administratori i HSH ka qenë me leje dhe për pasojë administratori referuar kodit të procedurës dhe statutit të shoqërisë i ka deleguar kompetencat e tij zv/administratorit të shoqërisë z. S.P. me autorizimin nr.799/1 prot., datë 19.07.2018.

Vendimi nuk është protokolluar në Hekurudhën Shqiptare SHA, Durrës në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat shtetërore”, i ndryshuar, por nga dokumentacioni i marrë në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës, nga sekretarja M.A. provohet se ky vendim ka ardhur në Shoqërinë “H.Sh.” SHA, Durrës, më datë 23.07.2018 dhe ky vendim i është përcjellë dorazi më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH A DURRËS

datë 25.07.2018 SH.Xh.t me detyrë shef i sektorit juridik Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, (sipas deklaratës së sekretar-protokollistes M.A. datë 31.07.2019), i cili sipas (sipas deklaratës të juristes L.A. datë 30.07.2019) ja ka kaluar për kompetencë kësaj juristeje në datë 08.08.2019 këtë procedurë, po dorazi.

Po më datën 08.08.2019 juristja L.A. me detyrë shefe e sektorit juridik në NJBMI ka përpiluar ankimimin për në Gjykatën e Apelit i cili është protokolluar me dt 08.08.2019 në Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës dhe sipas citimeve të saj është depozituar në Gjykatë në datë 09.08.2019. Pra në datën 09.08.2018 ka mbaruar afati i ankimimit, afat i cili është 15 ditë, referuar Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, 442 e në vijim.

Referuar sa më sipër nga data 25.07.2018 deri më datën 08.08.2018 datë në të cilën përfundon afati i ankimimit, është mbajtur nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik , pastaj i është dhënë dorazi juristes L.A..

Për këtë praktik në datë 12.11.2018 është mbajtur një procesverbal ndërmjet përmbaruesit gjyqësorë privat Luan Hoti dhe shefit të sektorit juridik SH.Xh.. Në këtë procesverbal SH.Xh. në tejkallim të kompetencave të tij ka firmosur një procesverbal të veprimeve përmbarimore gjatë ekzekutimit i cili deklaron në emër të Hekurudhës se: *Jemi në dijeni të detyrimit dhe procedurës përmbarimore nuk kemi kundërshtim me dhe se HSH do të shlyejë detyrimin me këste. Gjithashtu në rast se HSH do të krijojë likuiditet të mjaftueshëm mund ta shlyejmë si detyrim total para kohe. Ky procesverbal i ka kaluar sektorit të financës për ndjekje dhe veprim nga drejtuesi i njësisë ekonomike A.H. në datë 12.11.2018 (brenda të njëjtës ditë).* Këta dy punonjës jemi në kushtet e tejkallimit të kompetencave në kundërshtim me nenet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Administrative.

Për këtë subjekt është likuiduar vlera prej **1,153,300** lekë me 6 urdhër transferta bankare, vlerë konkretisht:

- urdhër transferta datë 20.11.2018 në shumën 200.000 lekë
- urdhër transferta datë 27.12.2018 në shumën 200.000 lekë
- urdhër transferta datë 25.01.2019 në shumën 200.000 lekë
- urdhër transferta datë 18.02.2019 në shumën 200.000 lekë
- urdhër transferta datë 12.03.2019 në shumën 200.000 lekë
- urdhër transferta datë 03.04.2019 në shumën 153.300 lekë

Me mos kryerjen e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit nga SH.Xh. me detyrë shef i sektorit juridik në kundërshtim Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues, i cili provon se me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 1,153,300 lekë, vlerë që përbën dëm ekonomik për Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës dhe Buxhetit të Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Koment

Referuar praktikës së procedurave të ndjekura ndërmjet NJBMI dhe NJSHBM-së procedura behet me shkresë përcjellëse konkretisht në lidhje me vendim nr.(11-2018-2486) 844 datë 18.05.2018 të rrethit gjyqësor Durrës me palë paditëse S.Sh. dhe palë të paditur Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk janë kaluar me shkresë përcjellëse



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA Durrës

Ndërsa pas kësaj praktike përcjellja e vendimeve gjyqësore është bërë me shkresa përcjellëse konkretisht me shkresën nr.568/1 datë 10.05.2019 të administratorit të shoqërisë është dërguar tej NJBMI vendimi i gjykatës së Apelit Durrës i cili i përket palës paditëse z. S.Sh..

-Fatmir Nehani dhe Muhamet Parroi kanë hapur proces gjyqësor ndaj H.Sh. SHA, Durrës. Përfaqësues i H.Sh. për këto procese është autorizuar SH.Xh. sipas autorizimit të datës 19.02.2018.

Gjykata e rrethit gjyqësorë Durrës në vendimin me nr.(11-2019-2703) 730 datë 15.05.2019 është shprehur në favor të palës paditëse duke pranuar pjesërisht padinë e paditësve dhe duke vendosur të detyrojë palën e paditur Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, që t’u paguajë paditësve dy muaj pagë secilit për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe tre muaj pagë secilit që i përket afatit të njoftimit. Konkretisht (2* 24.000 lekë) + (3*24.000 lekë) = 120.000 lekë për Fatmir Nehani dhe ((2* 24.000 lekë) + (3*24.000 lekë) = 120.000 lekë) Muhamet Parroj në total 240.000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohej të bëhej ankim në gjykatën e apelit Durrës, brenda 15 ditësh nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është protokolluar nga H.Sh. me nr.700 prot, datë 10.06.2019 dhe kundër këtij vendimi është bërë ankimim në Gjykatën e Apelit Durrës me datën 16.06.2019.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Struktura organizative e Shoqërisë ka nevojë për rishikim dhe përmirësim.

-Në rregullore të brendshme duhet të suprimohen dublimi i detyrave në nivelet e menaxhimit.

-Niveli i pagave për vitin 2018 dhe vitin 2019 është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës por, nuk është miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionarit të vetëm).

-Nuk është ruajtur raporti i pagave ndërmjet shkallëve të vjetërsisë dhe kategorive të punës.

-Planifikimi i fondit të asistencës nuk është bërë konformë nevojës reale që ka pasur kjo Shoqëri për fond asistence

-Si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës, është penalizuar nga vendimet e gjykatave në 11 raste në vlerën 10.593.875 lekë, si dhe ka risk të penalizohet në 20 raste të tjera.

-Në dy raste për vlerën 3,068,020 lekë u konstatua se Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës është penalizuar nga mos ndjekja e shkallëve të gjykimit të Gjykatës së Apelit.

Në opinionin e grupi të auditimit: Shoqërisë “H.Sh.” SHA, Durrës duhet të marr masa për ndjekur me përgjegjësi procedurat gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

Titulli: Shpenzimet e shoqërisë janë rënduar nga vendimet gjyqësore, si pasojë e mos likuidimeve në kohë të faturave ndaj kreditorëve në 1 raste për vlerën 1,655,413 lekë, si dhe për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi në vlerën 3,988,638 lekë në vitin 2012, i marr në zbatim të KPP.

Situata: Shoqëria ka paguar penaltete për mos likuidim në kohë të faturës (detyrimeve), ndaj operatorit ekonomik “S.ShPK.”, i cili e ka fituar këtë të drejtë me vendim Gjykate të Rrethit Gjyqësor Durrës nr.111, datë 29.01.2018 ku shuma e interesave ligjorë është 1,655,413 lekë. Po me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.946, datë 26.05.2015, shoqëria



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

është penalizuar në vlerën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi të kryer në vitin 2012, me fond limit 35,000,000 lekë, në të cilën Operatori ekonomik S. ShPK., është shpallur fitues në fazën e parë të vlerësimit të ofertave. Më pas është bërë ankesë nga operatori “Z. ShPK. në KPP, i cili e ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “S.” duke shpallur fitues “Z. ShPK.”. Ky vendim i KPP-së, është ankimuar nga operatori “S. ShPK.” më pas në shkallët e tjera të Gjykimit, i cili ka fituar një dëmshpërblim në shumën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë.

Kriteri: Kodi i procedurës civile, ligji i prokurimit publik

Ndikimi: Janë rënduar padrejtësisht shpenzimet e shoqërisë.

Shkaku: Mos pasja e mjeteve financiare disponibël për likuidimin e kreditorëve, si dhe nga vendimet e padrejta KPP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë dhe njësia ekonomike, të merren masat që faturat e kreditorëve të likuidohen mbi bazën e kriterit të maturimit kronologjik, duke i trajtuar të gjithë kreditorët në mënyrë të drejtë, duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Titulli: Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, nuk kanë të bashkëlidhura listëpagesat, ato mbahen në njësitë respektive.

Situata: Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, në të gjitha rastet nuk kanë të bashkëlidhur listëpagesat përkatëse si dokumentacion justifikues. Theksojmë se listëpagesat mbahen në secilën njësi, pavarësisht se ku bëhet likuidimi, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësit zbatues të cilët kanë hartuar dhe nënshkruar Urdhër Transfertat përkatëse.

Kriteri: Ligji nr.9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, neni 6, ligjin nr.25/2018, miratuar me datë 10.05.2018, hyrë në fuqi me datë 01.01.2019 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Ndikimi: Nuk ka ndikim financiar

Shkaku: Mos njohja e legjislacionit

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: Nga Njësia ekonomike, të marrin masat që dokumentacioni vërtetues për kryerjen e shpenzimeve për paga dhe shpërblime të bashkëlidhet dhe dokumentacioni justifikues i shpenzimit.

Titulli i gjetjes: Procedura prokurimi të blerjeve me vlera të vogla, të kryera jo në përputhje me Legjislacionin e Prokurimit Publik.

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për periudhën objekt auditimi konstatohet se:

-Autoriteti Kontraktor H.Sh. SHA., i kryen këto procedura pa patur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion, pra janë lidhur kontrata apo janë pranuar fatura tatimore për blerje mallrash apo shërbimesh në nivel të konsiderueshëm në 54% për të gjithë vitin 2018 dhe në 83% për 5-mujorin e parë të vitit 2019. Konkretisht për vitin 2018 janë realizuar 85 procedura prokurimi me vlerë totale oferte në shumën 8,935,077 lekë nga të cilat nuk janë likuiduar 28 procedura me vlerë kontrate në shumën 4,821,733 lekë. Për vitin 2019 për 5-mujorin e parë janë realizuar 32 procedura me vlerë totale oferte në shumën 3,108,130 lekë nga të cilat nuk janë likuiduar 19 procedura me vlerë kontrate në shumën 2,583,969 lekë. Këto veprime nuk i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

përmbahen VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 70, i cili përcakton se “*Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor*”.

-Në të gjitha rastet e verifikuara rezultojnë se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë, kjo pasi urdhri i prokurimit i shoqëruar me ftesën për ofertë, i cili u drejtohet operatorëve ekonomikë, nuk ka të përcaktuar të dhënat e nevojshme të operatorëve të përzgjedhur, që lidhen me objektin e prokurimit.

-Në 18 raste fatura tatimore e pranuar nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, por nënshkruhet vetëm nga njëri prej anëtarëve apo magazinieri i njësisë, ndërkohë që fatura tatimore duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

-Në të gjitha rastet e audituara, llogaritja e fondit limit të procedurës, nuk është e dokumentuar, pavarësisht se në disa raste komisioni i cili ka llogarit fondin limit, shprehet se është bazuar në kontrata të mëparshme, apo në testime tregu, në dosje nuk evidentohet asnjë referencë në të cilën është bazuar komisioni për nxjerrjen e fondit limit përkatës.

Kriteri: Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, pika 2, Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pikat 5, 7 dhe 19.

Ndikimi: Nuk ka ndikim financiar por procedurat paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mosnjohjes të plotë të legjislacionit, nga komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, si dhe mospasja e mjeteve të nevojshme financiare për kryerjen e shpenzimeve.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë, njësia ekonomike dhe komisioni i blerjeve të vogla të marrin masat e duhura për:

-Shpenzimet për blerjet me vlera të vogla, përpara lidhjes së kontratave, të sigurojnë mjetet e nevojshme financiare.

Rekomandimi:-Komisioni i blerjeve të vogla, në çdo rast, të dokumentojnë mënyrën e llogaritjes së fondit limit duke specifikuar referencat përkatëse, të argumentojnë dhe dokumentojnë operatorët e përzgjedhur si dhe të nënshkruajnë si komisioni i blerjeve të vogla faturat tatimore të pranuar.

Titulli i gjetjes: Pagesa nëpërmjet arkës jashtë limitit ditor të pagesave.

Situata: Në 25 raste janë kryer pagesa nëpërmjet arkës me para në dorë duke tejkaluar limitin ditor të veprimeve në arkë, kryesisht për likuidim faturash telekom, shërbime postare, fatura uji dhe likuidime për shpenzime blerje me vlera të vogla.

Kriteri: Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 64.

Ndikimi: Nuk ka ndikim financiar.

Shkaku: Mosnjohja dhe zbatimi i legjislacionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë, të nxjerr aktin përkatës (vendimi/ose urdhëri) për vendosjen e limitit ditor të veprimeve që do të kryhen për pagesat nëpërmjet arkës, gjithashtu ky akt t’u vihet në dispozicion të gjitha Njësive të H.Sh. SHA, për zbatim.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

5 /a. Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me bankë në lekë dhe valutë:

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me bankën, u konstatua se dokumentacioni i bankës është i plotë dhe i sistemuar. Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues (argumentues).

Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike. Veprimet financiare janë kontabilizuar në ditarët e hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare, sipas kërkesave të kontabilitetit. Çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të bankës dhe urdhërpagesat janë pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konformë me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/ “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Shoqëria “H.Sh.” ShA., për veprimet e saj ka të hapura llogari bankare të ndryshme (në lekë dhe valuta të tjera), në 11 banka në lekë dhe në 9 banka në valutë të huaj.

Për veprimet në bankë operohet me dy firma, ajo e nëpunësit autorizues që është Administratori i Shoqërisë dhe ajo e nëpunësit zbatues. Për Administratën Qendrore nëpunësi Autorizues është A.D. dhe nëpunës zbatues A.Sh.. Për Njësinë e Biznesit të Udhëtarëve nëpunës autorizues është P.T. dhe nëpunës zbatues M.T.. Për Njësinë e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse nëpunës autorizues është Nderim Kasa dhe nëpunës zbatues është M.K.. Për Njësinë e Biznesit të Mallit nëpunës autorizues është K.Sh. dhe nëpunës zbatues A.H.. Për Njësinë e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës nëpunës autorizues është D.M. dhe nëpunës zbatues M.S.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Në të gjitha rastet e audituara për urdhër transfertat e kryera për pagat, nuk kanë të bashkëlidhur listëpagesat përkatëse si dokumentacion justifikues, veprime në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, neni 6, ligjin nr.25/2018, miratuar me datë 10.05.2018, hyrë në fuqi me datë 01.01.2019 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësit zbatues të cilët kanë hartuar dhe nënshkruar Urdhër Transfertat përkatëse. Theksojmë se listëpagesat mbahen në secilën njësi, pavarësisht se ku bëhet likuidimi.

-Në 3 raste për vlerën 660,420 lekë, Shoqëria është penalizuar nga shpenzimet përmbare, që kanë ardhur si pasojë mos likuidimeve në kohë e subjekteve privatë të cilët kanë hapur procese gjyqësore për detyrimet që ka Shoqëria “H.Sh.” SHA, ndaj tyre.

Theksojmë se këto detyrime janë krijuar në vitet e mëparëshme dhe janë likuiduar gjatë periudhës objekt auditimi.

-Në një rast është kryer transaksion sipas vendimit të Gjykatës nr.11-2018-159,111 datë 29.01.2018, për Operatorin Ekonomik “Sulo” ShPK., i cili është likuiduar gjatë periudhës së auditimit për interesa ligjorë nga mos likuidimi i detyrimeve në kohë në shumën 1,655,413 lekë, kjo vlerë i përket viteve para objekt auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

-Gjithashtu në një rast ka paguar dëmshpërblim sipas vendimit të gjykatës për një procedurë prokurimi të kryer në vitin 2012 me objekt “ Blerje tranversa druri normale dhe speciale”, për vitin 2012, me fond limit 35,000,000 lekë, në të cilën Operatori ekonomik S. ShPK., është shpallur fitues në fazën e parë të vlerësimit të ofertave. Më pas është bërë ankesë nga një operator ekonomik në KPP i cili e ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “S.” duke shpallur fitues “Z. ShPK.”. Ky vendim i KPP-së, është ankimuar nga operatori “S. ShPK.” më pas në shkallët e tjera të Gjyqimit, i cili ka fituar një dëmshpërblim në shumën 3,988,638 lekë. Gjatë periudhës së auditimit janë kryer 3 likuidime ndaj subjektit në shumën totale prej 1,200,000 lekë për këtë dëmshpërblim.

Nr	Kreditori	Nr vendimi Gjykates Apelit	Shuma sipas vendimi të gjykatës	Interesa ligjorë nga moslikujdimi i detyrimeve në kohë	Shpërblim për skualifikim të padrejtë	Shpenzime permbarimore	Shuma e likuajduar
1	S.ShPK. (Roje private)	111 dt 29/1/2018		1.655.413		349.163	2.004.576
2	B.A.(Kont rapititor)	10-2017-1439(607) dt 7/6/2017	1.890.000			196.183	2.086.183
3	D.S. (roje private)	115074nr 4787 dt 29/07/2016				115.074	115.074
4	S. ShPK.	946 dt 26/05/2015		Fotokopje likujdimet	1.200.000		1.200.000
Shuma totale			1.890.000	1.655.413	1.200.000	660.420	5.405.833

Tabela 9 Shuma e detyrimit sipas vendimeve të gjykatës jepet sipas tabelës më poshtë.

Burimi i të dhënave: Shoqëria H.Sh.. ShA..

Referuar të dhënave të tabelës më sipër rezulton se interesat ligjorë në shumën 1,655,413 lekë, shpërblimi për s’kualifikim të padrejtë në shumën 1,200,000 lekë dhe shpenzimet permbarimore në shumën 660,420 lekë, të cilat në total janë në shumën 3,515,833 lekë përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi A.H. në cilësinë e Drejtuesit të Njesisë Ekonomike i cili ndjek dhe përgjigjet për Aktivitetin e Njesisë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi referuar Rregullores së Brendshme të Shoqërisë.

5 /b. Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me arkë në lekë dhe valutë:

Shoqëria H.Sh. SHA., për veprime me para në dorë përdor arkën në lekë, euro dhe usd. Arka e shoqërisë përdoret kryesisht për pagesa paradhënie, dieta/shërbime, komisione gjyqësore, pagesë taksa automjetesh, pagesa shërbimesh postare, likuidime fatura për ujë dhe energji etj. Dokumentacioni i arkës është i plotë dhe i sistemuar. Bashkëngjitur hyrjeve dhe daljeve të arkës janë dokumentacioni vërtetues dhe justifikues (argumentues).

Panvarësisht nga sa u citua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Në 25 raste janë kryer pagesa nëpërmjet arkës me pra në dorë duke tejkalluar limitin ditor të veprimeve në arkë, likuidim faturash telekom, shërbime postare, fatura uji, **likuidime për shpenzime blerje me vlera të vogla**, etj., në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 62-64.

Konkretisht po përmendim disa prej tyre si më poshtë:

-Me mandat pagesën nr.32, datë 24.03.2018, është likuiduar fatura nr.283, datë 22.05.2018 me përfitues subjektin “A.G.” ShPK., në shumën 111,360 lekë për riparimin e automjetit me targë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH A DURRËS

TR7645. Ky likuidim është kryer me procesverbal emergjence model 4, mbajtur me datë 23.05.2018, sipas formatit të APP-së, dhe është paguar nëpërmjet arkës.

-Me mandat pagesën nr.12, datë 12.04.2018 është likuiduar fatura nr.01, datë 10.04.2018 me përfitues subjektin “A.H.”, në shumën 60,000 lekë për riparimin e automjetit me targë AA052AS. Ky likuidim është kryer me procesverbal emergjence model 4, mbajtur me datë 10.04.2018, sipas formatit të APP-së, dhe është likuiduar nëpërmjet arkës së shoqërisë.

-Me mandat pagesën nr.60, datë 06.07.2018 në shumën 150,000 lekë është likuiduar Vojsava Lala punonjëse e Njesisë së Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës për të kryer pagesat e detyrimeve për likuidim faturash bazuar në shkresën nr.934, datë 05.07.2018 me lëndë “kërkesë për likuidim faturash”, e cila është paguar nga arka e shoqërisë.

-Me mandat pagesën nr.31, datë 21.05.2018, është kryer likuidim për blerje bileta avioni në shumën 35,400 lekë, bashkëlidhur faturës tatimore të thjeshtë (model 4) me nr.16, datë 14.05.2018. Kjo pagesë është kryer me procedurë prokurimi sipas Urdhër Prokurimit të AK-së nr.37/28, datë 10.05.2018, mbështetur në shkresën nr.376/4, datë 04.05.2018, të Administratorit të Shoqërisë, për pjesëmarrje në seminarin e grupit të punës së sipërmarrjes Hekurudhore, zhvilluar në Bruksel. Kjo pagesë është kryer nëpërmjet arkës.

-Me mandat pagesën nr.28, datë 11.05.2018 është likuiduar në shumën 150,400 lekë janë likuiduar detyrimet për OSHEE dhe Ujësjellës. Gjithashtu me MP nr.13, datë 12.04.2018 është likuiduar në shumën 138,200 lekë detyrim për sindikatën e pavarur të punonjësve të HSH SHA.

Pagesat e mësipërme janë kryer duke tejkaluar limitin e pagesave nëpërmjet arkës e cila referuar Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 64 duhet të ishte jo më tepër se 1,000 lekë.

-Me mandat pagesën nr.29, datë 14.05.2018, është kryer likuidim për blerje jelekë fosforeshentë në shumën 37,350 lekë, ndaj M.H. e cila ka paguar nëpërmjet faturës përkatëse, dhe është kryer nëpërmjet arkës.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 64, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi A.H. dhe A.Sh..

5/c. Nga auditimi në lidhje me procedurën e prokurimit me vlera të vogla.

Për vitin 2018 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) A.D. me urdhrin nr.37, dt. 05.01.2018 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: L.D., E.K. dhe L.A., dhe më pas është ndërruar me urdhrin nr.37/48 prot, datë 26.06.2018 L.A. me L.K. i cili ka funksionuar deri në fund të vitit 2018.

Për vitin 2019 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) A.D. me urdhrin nr.45/1, dt. 15.01.2019 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga L.D., L.K. dhe E.K. i cili do të funksionojë deri në fund të vitit 2019.

Për vitin 2018 janë zhvilluar gjithsej 85 procedura me blerje të vogla me vlerë totale 10,850,390 dhe me vlerë oferte 8,935,077 lekë pa TVSH, nga të cilat u audituan me zgjedhje 25 procedura. Për periudhën 01.01.2019-31.05.2019 janë zhvilluar gjithsej 32 procedura me vlerë fondi limit 4,567,690 dhe me vlerë oferte 3,108,130 lekë pa TVSH nga të cilat u audituan me zgjedhje 11 procedura. Në përgjithësi, duke përjashtuar shkeljet e trajtuara më poshtë, procedurat e prokurimit me blerje të vogla rezultojnë të jenë kryer në përputhje me Udhëzimin Ministrisë së Financave nr.3 datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH.A DURRËS

Pavarësisht nga sa u citua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Në të gjitha rastet e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, Urdhri i prokurimit është i fraksionuar dhe për procedura të ndryshme vazhdon në kronologji me fraksion, pra edhe pse një procedurë nuk ka lidhje me procedurën tjetër, numri vazhdon i njëjtë dhe me fraksion, në mospërputhje me Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 6.

-Në të gjitha rastet e verifikuara rezulton se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë, pasi nuk është në mospërputhje me Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7.

-Nga kryerja e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se, HSH SHA, i kryen këto procedura pa patur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion, pra janë lidhur kontrata apo janë pranuar fatura tatimore për blerje mallrash apo shërbimesh, siç jepet edhe nga tabela më poshtë:

Nr	Procedura prokurimi të realizuara	Procedura prokurimi të pa paguara	Fondi limit total i llogaritur	Vlera totale e Ofertave /kontratave	Shuma totale e likuajduar	Diferenca në lekë e Pa likuajduar	Diferenca në %
	a		b	c	d	e=c-d	f=e/c
1	Viti 2018		10,850,390	8,935,077	4,113,334	4,821,733	54%
	85	28					
2	Viti 2019		4,567,690	3,108,130	524.161	2.583.969	83%
	32	19					

*Tabela 10 Procedura të realizuara dhe kontrata të likuiduara
Burimi i të dhënave Shoqëria HSH. SHA.*

Pra, sikurse vihet re dhe nga tabela e mësipërme diferenca e pamjaftueshmërisë financiare është në nivel të konsiderueshëm konkretisht në 54% për të gjithë vitin 2018 dhe në 83% për 5-mujorin e parë të vitit 2019. Këto veprime janë jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 70, i cili përcakton se “Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor”.

-Në 18 raste fatura tatimore e pranuar nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, por nënshkruhet vetëm nga njëri prej anëtarëve apo magazinieri i njësisë, veprim ky në mospërputhje me Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 19.

-Në të gjitha rastet e audituara, llogaritja e fondit limit të procedurës, nuk është e dokumentuar, pavarësisht se në disa raste komisioni i cili ka llogarit fondin limit, shprehet se është bazuar në kontrata të mëparshme, apo në testime tregu, në dosje nuk evidentohet asnjë referencë në të cilën bazohen, veprim ky në mospërputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, pika 2, Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 5.

-Gjithashtu nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se H.Sh. SHA, ka detyrime të papaguara ndaj 57 subjekteve për kontrata të lidhura në shumën 73.525.690 lekë. Kjo si pasojë e paaftësisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

paguese që ka kjo shoqëri duke lidhur kontrata për punë, mallra e shërbime, pa patur mjetet e nevojshme financiare për likuidimin e tyre.

Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5 dhe 12, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se “Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor”.

Bashkëlidhur këtij akti evidentohen dhe disa nga procedurat e blerjeve me vlera të vogla në aneksin përkatës sipas verifikimeve të kryera.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

5/d. Shpenzime karburanti për automjetet.

Shpenzimet e karburantit për automjetet janë të vendosura mbi bazën e përcaktimit të normativave të vendosura nga H.Sh. SHA. Mbi këtë bazë, bëhet dhe furnizimi i karburantit për mjetet motorike të cilat tërheqin për çdo muaj sasinë nëpërmjet dokumentacionit përkatës si urdhër furnizimi, dalja nga magazina me fletë-dalje, dhe regjistrimet në kartelat përkatëse. Por për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për ndjekjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

Sa më sipër sipas konstatimeve përkatëse arrihet në konkluzionin që veprimet e kryera bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- 2) VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- 3) Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- 4) Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- 5) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,
- 6) Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1.A.H. me detyrë Drejtues i Njësisë Ekonomike në HSH SHA.,
- 2.L.D. anëtar i komisionit të prokurimit për blerjet e vogla,
- 3.E.K. anëtar i komisionit të prokurimit për blerjet e vogla,
- 4.L.A. anëtar i komisionit të prokurimit për blerjet e vogla,
- 5.E.K. anëtar i komisionit të prokurimit për blerjet e vogla.

6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Titulli i gjetjes: Mungesa e politikave për provizionimin e borxheve të këqija

Situata: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, huat afatgjata dhe huat e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,258,197 mijë lekë. Në këtë shumë Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Siç përmendet në shënimin nr.11, Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Për më tepër, në lidhje me detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, bazuar në shkresën me numër protokoll 505 të paraqitur nga shoqëria, pretendimet aktuale nga hekurudhat e huaja përveç shumës së principalit, janë 1,140,580 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare.

Kriteri: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr.37, në fuqi.

Ndikimi: Shoqëria është e riskuar për të gjeneruar efekte financiare

Shkaku: Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

Titulli i gjetjes: Gjendja debitore dhe kreditorëve në shifra shqetësuese.

Situata: Gjendja debitore dhe kreditorë është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “H.Sh.” SHA. Durrës. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2018 është në vlerën 382,798,300 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 34% për vitin 2018, e zënë Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 47,823,005 lekë dhe Tvsh me saldo debitore në vlerën 53,242,511 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2018, kjo gjendje paraqitet në vlerën 47,823,005 lekë. Ndërsa gjendja kreditorë është në vlerën 1,148,514,060 lekë. Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 18 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 18% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditorë zë 32% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 55% për vitin 2018.

Kriteri: Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Ndikimi: Kjo situatë sjell ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.

Shkaku: Mos marrja e hapave të duhur për shqyrtimin dhe reduktimin e debitorëve dhe kreditorëve të Shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë “H.Sh.” SHA. Durrës., (Administratori, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SHA DURRËS

Titulli i gjetjes: Në kontabilitet dhe pasqyrat financiare nuk është pasqyruar penaliteti që ka shoqëria ndaj hekurudhave të huaja për mos likuidimin në kohë të detyrimeve.

Situata: Në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare nuk është pasqyruar penaliteti që ka Shoqëria “H.Sh.” Sha që vjen si pasojë e mos likuidimit të detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja lidhur me transportin e mallrave për orë qëndrimet e vagonave në territorin e HSh-së. Pasqyrimi në kontabilitet dhe pasqyrat financiare bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit) pa u llogaritur kamatëvonesat. Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” Sha ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” SHA, ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro.

Kriteri: Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i rezultatit financiar të shoqërisë

Shkaku: Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga Administratori i Përgjithshëm, Njësia Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatë vonesave për orë qëndrimet e vagonëve të Hekurudhave të Huaja, konformë udhëzimeve të kodeve UIC 304 dhe 311, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Titulli i gjetjes: Mos kryerja rregullisht e rivlerësimeve të AAM-ve.

Situata: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, Aktivët afatgjatë materiale paraqiten në vlerën 84,156,200 mijë lekë (2017: 84,941,444 mijë lekë), Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve të veta. Aktivët afatgjatë materiale, sipas politikave kontabël mbeten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. SKK 5 “Aktive Afatgjatë Materiale dhe jo materiale” kërkon që nëse një kompani zgjedh modelin e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-ve do të kryhej në datën e raportimit. Rivlerësimi më i fundit i aktiveve të shoqërisë daton në vitin 2013; 5 vjet më parë dhe normat e amortizimit të aplikuara nga shoqëria gjatë 2018 janë ato të miratuara me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 24, datë 18.12.2006 të 11 viteve më parë. SKK 5 kërkon kryerjen e një testi zhvlerësimi në datën e mbylljes së bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies së vlerës, e cila nuk është kryer nga shoqëria, Grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë efektet që ky vlerësim do të kishte në pasqyrat financiare.

Aktualisht Shoqëria është në proces rivlerësimi të aseteve, kjo sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarit me nr.120 datë 11.10.2018. Sipas kontratës së lidhur me grupin e eksperteve të miratuar për këtë qëllim, procedura e rivlerësimit pritet të përfundojë brenda vitit 2019.

Kriteri: Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr.5 “Aktive Afatgjatë Materiale dhe Jomateriale”, ligjin nr.33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar.

Ndikimi: Mos pasqyrimi i saktë i vlerës së AAM-ve në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos kryerja në kohë e procesit të vlerësimit të AAM-ve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Shoqëria të merren masa që pasuritë e patundshme troje dhe ndërtesa të mbështeten plotësisht në dokumente pronësie ,duke sjellë në këtë mënyrë, paraqitje të plotë dhe të saktë të vlerës së trullit në pasqyrat financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Titulli i gjetjes: Mungesa e një sistemi kontabël të informatizuar.

Situata: H.Sh. SHA, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë.

Ndikimi: Mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Titulli i gjetjes: Mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë Kontabilitetit.

Situata: Në llogaritë jashtë bilancit në shumën 3,274,893 mijë lekë paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale të cilat priten ti transferohen Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet.

Kriteri: Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi.

Ndikimi: Të dhënat e kontabilitetit nuk përputhen me Pasqyrat Financiare.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë e mbajtjes së llogarive të aktiveve jashtë Kontabilitetit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitetet të vlerës 3,274,893 mijë lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale të cilat janë në proces transferimi ndaj Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Titulli i gjetjes 3: Mos regjistrim i asetëve në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, aktivet nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, veprim në kundërshtim me ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Ndikimi: Keq menaxhim të aktiveve të Shoqërisë.

Shkaku: Mos zbatim plotësisht të procedurave ligjore për regjistrimin e pasurisë dhe mos monitorim me rigorozitet të kontratave të dhëna me qira.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Me vendim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22818/3, datë 27.12.2018, protokolluar në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, të cilët janë I.H.,T. Gj.,A.A., A.M., N.C., E. Rr.

Ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës, dhe ekspertëve kontabël, E.R., N.C., A.M., I.H., T.Gj. dhe A.A. është lidhur kontrata e shërbimit me nr.22817/3 prot., datë 27.12.2018 (protokoll HSH nr.7, datë 04.01.2018, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 60 ditë kalendarike për të përmbushur dhe dorëzuar shërbimin, sipas objektit të kontratës, me vlerë 7,500,000 lekë.

Auditimi ka pasur për qëllim vlerësimin teknik profesional mbi kredibilitetin e akteve financiare në mbyllje të vitit financiar të shoqërisë dhe nuk ka mundur të dhënien e një vlerësimi profesional mbi zgjedhjet strategjike që ka ndërmarrë shoqëria.

Auditimi është fokusuar vetëm në aspektet që kanë të bëjnë me *auditimin financiar*. Duke kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të koordinimit të të dhënave origjinale të Shoqërisë nëpërmjet kontrollit të dokumenteve të mbajtura nga administratorët; krahasimin e besueshmërisë së të dhënave të kontabilitetit dhe analizimin kritik të tyre me aftësinë e tyre për të dhënë informacion, nëpërmjet rishikimit sistematik të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare; krahasimin e të dhënave të bilancit, shqyrtimin kritik të tij dhe krahasimin me parametra ligjor të përcaktuar.

Objekt i auditimit kanë qenë pasqyrat financiare të cilat përfshijnë bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit të Shoqërisë.

Organizimi i kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, është bërë përgjithësisht sipas Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr.10926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr.65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe”.

Ato janë përgatitur në përputhje me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.2, veprimet e kryera dokumentohen dhe regjistrohen në librat e kontabilitetit në përputhje me parimet e SKK-ve. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësinë monetare Shqiptare në lekë. Veprimet në valutë janë konvertuar në lekë sipas standartit kontabël përkatës.

Pasqyrat financiare (bilanci) janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimi i të drejtave të konstatuara. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. U konstatua se regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e llogarisë kontabël, bëhet duke u bazuar në dokumentacionin përkatës kontabël.

Pavarësisht nga sa u citua mësipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Nga ekspertët kontabël të kontraktuar:

a.Nuk ka një zbatim të standartit 250 për auditim ligjshmërie dhe përputhshmërie nga ekspertët kontabël, gjë që faktohet me problematikat e trajtuara në të gjitha aktkonstatimet e mbajtura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

b. Dokumentacioni përkatës që vërteton punën e kryer të ekspertëve, p.sh, krahasimi i programit me faktin e realizuar dhe kush e ka konfirmuar situacionin e punës së kryer prej tyre.

-Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me ligjin me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

-Në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare është përfshirë:

d. Aktive afatgjata materiale është në vlerën 84,156,200 mijë lekë, nga të cilat në vlerën 15,831,923 mijë lekë i janë dorëzuar Konçesionarit A. ShPK. për dhënie me konçesion të Hekurudhës Fier-Vlorë dhe Fier Ballsh dhe që vazhdojnë të jenë të regjistruara në kontabilitet. Kontrata e konçesionit është lidhur më 04/02/2016 ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Shoqërisë Konçesionare A. ShPK., dhe protokolluar me numër 703.prot datë 05/02/2016. Në këtë kontratë Autoritet Kontraktues është MTI, e cila është përgjegjëse për zbatimin e kontratës deri në përfundim të saj.

Shoqëria “H.Sh.” Sha, nuk është e përfshirë në asnjë marrëdhënie juridiko-civile që vjen nga zbatimi i kësaj kontrate.

Dorëzimi i asetëve është bërë sipas shtojcës së përcaktuar në kontratë, dërgimi në MTI i proces verbaleve të dorëzimit ka filluar me shkresën nr.879/48 datë 26/09/2016 dhe për llogaritë 201 e 212 ka përfunduar me shkresën nr.879/179 datë 23/12/2016. Që nga ky moment Shoqëria “H.Sh.” SHA, nuk ka asnjë marrëdhënie juridiko-civile që lind prej saj.

Në bazë të kësaj kontrate konçesionare, Shoqëria nuk do të marrë ndonjë përfitim gjatë periudhës 25 vjeçare të konçesionit, në fund të së cilës pritet të marrë përsëri në dorëzim AAM-të.

Pas dorëzimit të AAM-ve shoqërisë konçension marrëse, këto aktive vazhdojnë të amortizohen në përputhje me politikat kontabël të amortizimit të shoqërisë pavarësisht faktit që këto AAM nuk do të sjellin asnjë përfitim të ardhshëm. Për më tepër shoqëria nuk ka kryer asnjë test vlere për këto AAM në përputhje me kërkesat e SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe jo materiale” dhe nuk ka shpalosur në shënimet shpjeguese informacion për aktivet e dhëna me konçension. Asetet e dorëzuara vazhdojnë të jenë në inventarët e NjBMIH dhe për to vazhdon të llogaritet amortizim.

Nga Financa e NjBMIH është kërkuar herë pas here të bëhet kalimi i tyre në përdorim por, ende nuk është autorizuar asnjë veprim për to.

Grupi i auditimit nu ka qenë në gjendje të vlerësojë efektet e ndonjë korigjimi të mundshëm.

e. Në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare nuk është pasqyruar penalteti që ka Shoqëria “H.Sh.” ShA., që vjen si pasojë e mos likuidimit të detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja lidhur me transportin e mallrave për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e HSh-së. Pasqyrimi në kontabilitet dhe pasqyrat financiare bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit) pa u llogaritur kamatëvonesat. Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penaltetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” SHA, ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penaltetet 211,431 euro.

f. Mungesa e politikave për provizionimin e borxheve të këqija.

Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara. Shoqëria nuk ka pasur një politikë koherente të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka regjistruar dhe prezantuar si shpenzime të borxheve të këqija në 31 dhjetor 2018, vlerën prej 27,778 mijë lekë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH A DURRËS

pa pasur ndonjë analizë të vjetërisë dhe pa pasur rregullore për provizionet e borxheve të këqija. Kjo ka ndodhur pasi Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ndërmarrë hapa konkret për hartimin e një Rregulloreje të tillë.

Konkretisht:

-Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, në grupin e kërkesave të tjera për arkëtim përfshihen kërkesa për vlerën 27,778 mijë lekë (2017: 108,572 mijë lekë) që përfshijnë të drejta që paraqesin vështirësi arkëtimi për shkak të kohës së hershme të krijimit të tyre dhe vështirësive financiare të debitoreve. Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë zhvlerësim për këto kërkesa. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korigjim i mundshëm nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do ulte vlerën e aktiveve dhe të kapitaleve të veta në të njëjtën masë.

-Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, huat afatgjata dhe huat e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,258,197 mijë lekë. Në këtë shumë Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Siç përmendet në shënimin nr.11, Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Për më tepër, në lidhje me detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, bazuar në shkresën me numër protokolli 505 të paraqitur nga shoqëria, pretendimet aktuale nga hekurudhat e huaja përveç shumës së principalit, janë 1,140,580 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare.

Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

Në opinionin e grupit të auditimit Këshilli Mbikëqyrës duhet të merrte veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

-Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, grantet dhe të ardhurat e shtyra afatshkurtra janë në vlerën 457,385 mijë lekë (2017: 490,053 mijë lekë) dhe lidhen me grante të marra për aktive afatgjata materiale. Shoqëria nuk disponon kontratat dhe listën analitike të aseteve të cilat janë financuar me këto grante dhe kontabilizon rimarrjen e granteve në të ardhura me norma të ndryshme nga ato të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, grupi i auditimit nuk është në gjendje të përcaktojë efektin që zbatimi i SKK 10 do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, Aktivet afatgjata materiale paraqiten në vlerën 84,156,200 mijë lekë (2017: 84,941,444 mijë lekë), Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve të veta. Aktivet afatgjata materiale, sipas politikave kontabël mbeten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. SKK 5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale” kërkon që nëse një kompani zgjedh modelin e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-ve do të kryhej në datën e raportimit. Rivlerësimi më i fundit i aktiveve të shoqërisë daton në vitin 2013; 5 vjet më parë dhe normat e amortizimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

aplikuara nga shoqëria gjatë 2018 janë ato të miratuara me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr, 24, datë 18.12.2006 të 11 viteve më parë. SKK 5 kërkon kryerjen e një testi zhvlerësimi në datën e mbylljes së bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies së vlerës, e cila nuk është kryer nga shoqëria, Grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë efektet që ky vlerësim do të kishte në pasqyrat financiare.

Aktualisht Shoqëria është në proces rivlerësimi të aseteve, kjo sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarit me nr.120 datë 11.10.2018. Sipas kontratës së lidhur me grupin e eksperteve të miratuar për këtë qëllim, procedura e rivlerësimit pritet të përfundojë brenda vitit 2019.

Pasuria e patundshme troje dhe ndërtesa nuk janë të mbështetura plotësisht në dokumente pronësie e cila mund të sjellë paraqitje jo të plotë dhe të saktë të vlerës së trualit të paraqitur në pasqyrat financiare.

Në pasqyrat financiare të shoqërisë, rezerva e rivlerësimit është 33,696,569 mijë lekë. Nga mungesa e të dhënave të rivlerësimeve paraardhëse, rezervat e rivlerësimit janë shpërndarë në regjistrat analitik të AAM-ve jo mbi bazën e raporteve të vlerësimit por në përpjesëtim me vlerat e AAM-ve. Nga rakordimi i shpërndarjes së kësaj shume nëpër regjistra analitik me rezervën e rivlerësimit në pasqyrat financiare rezultoi se janë shpërndarë 1,637,339 mijë lekë më pak. Për më tepër, në vitet paraardhëse rezerva e rivlerësimit nuk është transferuar në fitimet e pashpërndara gjatë çregjistrimit të aktiveve të shitura apo të nxjerra jashtë përdorimit. Për sa më lartë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektet që korrigjimet e mundshme do të kishin në shumën e rezervës së rivlerësimit dhe fitimeve të mbartura apo ato të periudhës.

-Në tabelën e AAM-ve, shoqëria ka bërë dalje nga përdorimi për shumën 292,477 mijë lekë, duke regjistruar në shpenzime të daljes nga përdorimi vetëm vlerën e mbetur fiskale të shoqërisë për 44,244 mijë lekë dhe diferencat e rivlerësimit janë pakësuar për vlerën 248,233 mijë lekë. SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe jo materiale” kërkon që fitimi ose humbja që vjen nga çregjistrimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale të përfshihet në fitim ose humbje të vitit dhe diferencat e rivlerësimit të lidhura me këto AAM të realizohen në fitime të pashpërndara. Për rrjedhojë, rezultati i vitit është mbivlerësuar për vlerën 248,233 mijë lekë dhe fitimet e mbartura janë nënvlerësuar për këtë vlerë.

-Në llogaritë jashtë bilancit në shumën 3,274,893 mijë lekë paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale të cilat priten ti transferohen Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet.

-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “H.Sh.” SHA. Durrës. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2018 është në vlerën 382,798,300 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 34% për vitin 2018, e zënë Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 47,823,005 lekë dhe Tvsh me saldo debitore në vlerën 53,242,511 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2018, kjo gjendje paraqitet në vlerën 47,823,005 lekë.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 1,148,514,060 lekë .

Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 18 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 18% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 32% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 55% për vitin 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë Ekonomike.

7.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

1. Titulli i gjetjes: Procedura prokurimi, të kryera jo plotësisht konform dispozitave ligjore.

Situata: Në 2 procedura prokurimi për vlerën 22,330 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 7 procedura prokurimi për vlerën 63,946 mijë lekë, në urdhrat e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, por është cilësuar, ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”.

-Për 4 procedura prokurimi për vlerën 46,713 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 3 procedura prokurimi për vlerën 40,047 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 3 raste për vlerën 34,169 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në tre raste për vlerën 1,723,160 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave për punë publike dhe i mallrave, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURREË

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën 1,723,160 lekë.

Shkaku: Keq interpretime të akteve ligjore dhe nënligjore të procedurave të prokurimit publik, si dhe projektimit zbatimit të kontratave të punëve publike.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:

- Përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të till që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ose zyrtari i deleguar prej Tij, për çdo procedurë urdhrat e prokurimit të përcaktojnë specifikisht emrat e njesisë së prokurimit.

-Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Auditimi i procedurave të prokurimit është kryer me zgjedhje. Rezultat e auditimit për secilin procedurë të audituar paraqiten si më poshtë vijonë.

1.Procedura e prokurimit me objekt “Blerje vaj për lokomotiva” viti 2018.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje vaj për lokomotiva” viti 2018.		
1.Urdhër Prokurimi Nr 867/1 Datë 16.10.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.867/2 dt. 16.10.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “procedure e hapur”	Urdhër Nr.867/1 dt.16.10.2017 -Eduart Buzi me detyrë Shef i Zyres Juridike. -Eriselda Prifti me detyrë Specialiste Prokurimesh -Eldi Ruci me detyrë Ing...	-Flamur Zaimi me detyrë Drejtor Tregetar. -Laert Tanku me detyrë Ing. Hidro -Erta Haxhiraj me detyrë specialiste e sektorit debisë
5.Fondi Limit (pa tvsh) 15.880.000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) _____11.935.300_____lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3.944.700 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

8. Data e hapjes së tenderit 13.11.2017	9. Burimi Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>7</u> OE b) S'kualifikuar <u>0</u> OE, c) Kualifikuar <u>7</u> OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP-s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 897 prot. Datë 28.12.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 14.322.360 lekë	16. Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17. Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 28.12.2017 deri më datë 11.02.2018 , pra 45 ditë Zbatuarditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë -S'ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesit në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë tender i hapur

Me shkresën nr.176 prot., datë 12.04.2018 është bërë kërkesa nga P.T. me detyrë Drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së shërbimeve mbështetëse, për blerje vaj lubrifikant për lokomotiva në sasinë 30 ton, vaj SAE 40 dh 5 ton, vaj SAE 20 për njësisë e biznesit të mallit dhe Njësinë e biznesit të udhëtarëve.

Specifikimet teknike dhe afati i lëvrimit të vajit SAE 40, janë hartuar nga V.P. me profesion ing. mekanik, I.L. me profesion ing. Mekanik dhe N.S. me profesion ing. Transporti.

Me urdhër të Administratorit nr.394/1 prot., datë 20.04.2018 është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit ku është urdhëruar Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik.

Me urdhër të K.I. me detyrë Drejtuese e Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse pa numër protokoll datë 26.04.2018 është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit ku është urdhëruar Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse për ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik i përbërë nga N.K. me profesioni ng. ndërtimi, B.D. me profesion ing. ndërtimi dh A.G. me profesion ekonomiste.

Me shkresën nr.149 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar Dhomës së Tregtisë me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.150 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar Institutit të Statistikave me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.151 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar Drejtorisë së Tatimeve me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.152 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.153 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

drejtuar Drejtorisë Doganës Durrës me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.154 prot., datë 28.03.2018 të P.T. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Udhëtar drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar Drejtorisë Tatimeve Durrës me kërkesë për informacion zyrtar për çmimet e vajit lubrifikant për lokomotiva, duke i kërkuar çmimin e vajrave për caktimin e fondit limit.

Me shkresën nr.4679/1 prot., datë 05.04.2018, Drejtoria e Dogës Durrës i ka kthyer përgjigje Njesisë së Biznesit Udhëtar, duke specifikuar se vajrat e kërkuara përfshihen në kreun tarifor 2710, konkretisht: Vaj i ambalazhuar SAE 20VV 50 (multigrade) 1.4-1.5 euro/litër kushtet e lëvrimit FOB, çdo origjinë, ndërsa vaj i ambalazhuar SAE 40 (multigrade) 1.4-1.5 euro/litër kushtet e lëvrimit FOB, çdo origjinë.

Me shkresën nr.488/1 prot., datë 06.04.2018, Drejtoria e Statistikave i ka kthyer përgjigje Njesisë së Biznesit Udhëtar, duke specifikuar se INSTAT nuk disponon çmime për artikuj e kërkuar nga ana e juaj.

Me shkresën nr.7924/1 prot., datë 16.04.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i ka kthyer përgjigje Njesisë së Biznesit Udhëtar, duke specifikuar se vajrat e kërkuara përfshihen në kreun tarifor 2710, konkretisht: vaj i ambalazhuar SAE 20Ë 50 (multigrade) 1.4-1.5 euro/litër kushtet e lëvrimit FOB, çdo origjinë, ndërsa vaj i ambalazhuar SAE 40 (multigrade) 1.4-1.5 euro/litër kushtet e lëvrimit FOB, çdo origjinë.

Me shkresën pa numër prot., datë 17.05.2018, komisioni i përbërë nga N.K., B.D., A.G. dhe K.I. i ka dërguar materialin teknik Administratorit të Shoqërisë.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 02.05.2018 K.I. në cilësinë e Drejtueses së Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “K.O.” ShPK., Durrës me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Vaj SAE 40 dhe 20”.

Me shkresën pa protokoll datë 03.05.2018 Agron Bejta në cilësinë e General Manager të shoqërisë “K.O.” ShPK., i është drejtuar shoqërisë “H.Sh. me ofertë”, në vlerën 320 lekë/ litër për vajin SAE 40 dhe 350 lekë/ litër.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 04.05.2018 K.I. në cilësinë e Drejtueses së Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “E.P.” ShPK., Durrës me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Vaj SAE 40 dhe 20”.

Me shkresën nr.112 protokoll datë 08.05.2018 F.K. përfaqësues për shoqërinë “Eida” ShPK., i është drejtuar shoqërisë “H.Sh. me ofertë”, në vlerën 460 lekë/ litër për vajin SAE 40 dhe 440 lekë/ litër për vajin SAE 20.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 02.05.2018 K.I. në cilësinë e Drejtueses së Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “K.” ShPK., Durrës me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Vaj SAE 40 dhe 20”.

Me shkresën pa protokoll datë 03.05.2018 Elton Laho përfaqësues i shoqërisë “K.” ShPK., i është drejtuar Shoqërisë “H.Sh. me ofertë”, në vlerën 340 lekë/ litër për vajin SAE 40 dhe 370 lekë/ litër për vajin SAE 20.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer nga N.K., B.D. dhe A.G. në vlerën 12,611,480 lekë.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 12,611,480 lekë, pas ofertës të ofruar për vlerë 13,389,280 lekë nga shoqëria “K.”, për vlerën 12,611,480 lekë nga shoqëria “K.” për vlerën 14,813,751 lekë nga Shoqëria “E.”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Vlera 12,611,480 lekë, është marrë si oferta më e ulët e paraqitur.

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, *nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.*

Veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nei 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi N.K., B.D. dhe A.G. .

Me urdhër të Administratorit A.D. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor me nr.591 prot., datë 04.06.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 12,611.480 lekë, me procedurë “Procedur e hapur”, me objekt “Blerje vaj lubrifikant për lokomotiva”. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet Njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit“, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;

- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;

- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);

- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Me urdhër të administratorit nr.591/1 prot., datë 04.06.2018 është ngritur njësia komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga S.P. me profesion ing mekanik, K.C. me profesion ekonomist dhe L.K. me profesion_____.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 16.10.2017 të firmosura nga Njësia e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim. Për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe të dokumentuar në procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nei 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit”.

Në pikën 2.2 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin Vërtetim nga Zyra e tatim taksave, deklaratën e xhiros vjetore ku vlera e saj mesatare për tre vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kontratës që prokurohet. Veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose

b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”

Në opinionin e grupit të auditimit, kriteri mbi paraqitjen e xhiros mesatare vjetore kërkohet në mënyrë që të vërtetohet se operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës.

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit (2015,2016,2017), veprim në kundërshtim me; VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”.

-Shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), pasi nuk duhesh “kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit (2015,2016,2017)”, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

I njëjti argument vlen edhe për xhiron mesatare.

Shkelja e dispozitave të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.A.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 02.07.2018, për hapjen e procedurës për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

B&A-02 me ofertë në vlerën 9,861,390 lekë, E.O.2015 me ofertë në vlerën 11,667,000 lekë, E. me ofertë në vlerën 11,000,320 lekë, D. me ofertë në vlerën 10,161,396 lekë, K.O. me ofertë në vlerën 10,161,396 lekë dhe T.O. me ofertë në vlerën 10,500,300 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 02.07.2018 për vlerësimin e procedurës së tenderimit duke kualifikuar të gjithë operatorët si më sipër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar 18.07.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga S.P., K.C. dhe L.K., raport i cili është miratuar dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, duke shpallur fitues operatorin ekonomik B&A-02 me ofertë në vlerën 9,861,390 lekë

Njoftimi i fituesit është publikuar në buletin nr.30, datë 30 korrik 2018 të agjencisë së prokurimit publik.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 30.07.2018 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori fitues “B&A-02” Sh.p.k.

Kontrata është lidhur ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” sha dhe shoqërisë “B&A-02” Sh.p.k në vlerën 11,833,668 lekë, e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga S.P. në cilësinë e zv/administratorit me autorizim të Administratorit të Shoqërisë nr.799/1 datë 19.07.2018 dhe për shoqërinë “B&A-02” Sh.p.k nga administratori A.G.

Zbatimi i procedurës së prokurimit.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

- operatori ekonomik “E.O.2015” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3.2 të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e analizave/testimeve yzrtare të kryera nga laborator të autorizuar. Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur raportin e analizës SAE 20.

- operatori ekonomik “E.”, konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.2.2 të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë “Vërtetim nga Zyra e Tatim taksave të deklaratave të xhiros vjetore ku vlera e saj mesatare për tre vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kontratës që prokurohet. Nga ky operator në përmbushje të kësaj kërkesë është paraqitur vërtetimi nr.T00361432, datë 18.06.2018 ku sipas të cilit xhiroja paraqitet përkatësisht viti 2015 në vlerën 0, viti 2016 në vlerën 1,236,368 lekë dhe viti 2017 në vlerën 19,236,368 lekë. Pra nga ky operator nuk është përmbushur kjo kërkesë për kualifikim e përcaktuar nga autoritetit kontraktor, për kualifikim, për këtë arsye duhej s’kualifikuar.

Në pikën 2.3 të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë “për sa i përket përvojës së mëparshme, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më vogël se 30 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë (2015,2016,2017).

-Kur kontrata e ngjashme është realizuar nga institucioni shtetëror, operatori ekonomik do ta vërtetoj duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetim të lëshuar nga institucioni shtetëror për realizim të suksesshëm të kësaj kontrate.

-Kur kontrata e ngjashme është realizuar me subjekte privat, operatori ekonomik do të paraqesë kontratën e lidhur me subjektet privat të shoqëruar me faturën përkatëse tatimore të shitjes të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin nga subjekti për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate. Ky operator nuk ka vërtetim nga subjekti për realizimin e suksesshëm të kontratës, në kundërshtim nga sa është përcaktuar në kërkesat për kualifikim, për këtë arsye duhej s’kualifikuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55, pika 2,3, 5/a dhe neni 58, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga S.P., K.C. dhe L.K..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

2. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Traversa Druri Normale dhe Speciale të reja” Viti 2018.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje vaj për lokomotiva” viti 2018		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 632 Datë 12.06.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”	Urdhër Nr.37 dt.05.01.2018 -E.L. shef i sektorit të prokurimeve. -L.D. me detyrë Specialiste Prokurimesh -A.G. me detyrë Specialiste Prokurimesh	Urdhër Nr.632/1 dt. 12.06.2018 -K.Sh. me detyrë Drejtues NJ.B.M. -Y.M. me detyrë kryetar dege marketingu NJ.B.M -L.K. me detyrë specialiste e sektorit juridik
5.Fondi Limit (pa tvsh) 18.333.333 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) _____17,323,500_____lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1.009.833 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 06.07.2018	9.Burimi Financimit Të ardhurat e shoqërisë	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>6</u> OE b)S’kualifikuar <u>2</u> OE, c) Kualifikuar <u>4</u> OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s’ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s’ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.862 prot. Datë 06.08.2018	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 17,323,500 lekë	16.Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 06.08.2018 deri më datë 06.11.2018 , pra 90 ditë Zbatuarditë	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -S’ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë tender i hapur.

Me shkresën nr.401 prot., datë 08.03.2018 është bërë dërgimi i materialit teknik D.M. me detyrë Drejtuesi i Njesisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, për blerje traversash hekurudhore normale dhe speciale të reja për Njesisë e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore .

Me urdhër nr.326/1prot. të D.M. me detyrë Drejtuesi i Njesisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore ka ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik i përbërë nga M.K. me profesion ing. ndërtimi, M.B. ing.ndërtimi dhe Xh.B. teknik ndërtimi.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer nga M.K., M.B. dhe Xh.B. e cila është në vlerën 18,329,500 lekë.

Për llogaritjen e fondit limit komisioni i është referuar përvojave të mëparshme të realizuara nga vetë autoriteti Kontraktkor.

Me urdhër të Administratorit A.D. në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktkor me nr.632 prot., datë 12.06.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 18,392,500 lekë, me procedurë “E hapur”, me objekt blerje traversa hekurudhore normale dhe speciale të reja. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njesisë së prokurimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Me urdhër të administratorit nr.632/1 prot., datë 12.06.2018 është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.Sh. me profesion jurist, Y.M. me profesion ekonomist dhe L.K. profesion juriste.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 12.06.2018 të firmosura nga Njësia e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim. Për kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe të dokumentuar në procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit”.

Shkelja e dispozitave të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomik si më poshtë

- Shoqëria “Sh.” me vlerë 17,791,000 lekë
- Shoqëria “2A.G.” me vlerë 18,148,000 lekë
- Shoqëria “A.L.I.” me vlerë 17,323,500 lekë
- Shoqëria “H.L.” me vlerë 20,140,643 lekë
- Shoqëria “R.C.” me vlerën 24,363,894 lekë
- Shoqëria “Z.” me vlerë 18,250,000 lekë

Nga KVO janë skualifikuar operatorët ekonomik, si më poshtë:

- Shoqëria “H.” L.&co” me vlerë 20,140,643 lekë
- Shoqëria “R.C.” me vlerën 24,363,894 lekë

Nga KVO është shpallur fitues Shoqëria “A.L.I.” me vlerë 17,323,500 lekë. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.07.2018.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar 02.08.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

K.Sh., Y.M., L.K. duke shpallur fitues operatorin ekonomik Shoqëria “A.L.I.” me ofertë në vlerën 17,323,500 lekë

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 23.07.2018 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori fitues Shoqëria “A.L.I.” Sh.p.k.

Kontrata është lidhur ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” SHA dhe Shoqëria “A.L.I.” ShPK., në vlerën 17,323,500 lekë, e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga A.D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe për shoqërinë “A.L.I.” Sh.p.k nga Sherif Dumani me autorizim.

Zbatimi i procedurës së prokurimit.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga Shoqëria “A.L.I.”; konstatohet se

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.1 **Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë License /leje për prodhimin e traversave, Çertifikatë cilësie për prodhimin e traversave ose akt marrëveshje mes ofertuesit dhe furnizuesit e cila garanton lëvrimin e mallit objekt i kësaj kontrate në sasi dhe kohë, sipas kushteve në shtojcën 10 të DST.

Akt marrëveshja duhet të shoqërohet me vërtetimin e regjistrimit të furnizuesit ose prodhuesit që furnizon operatorin ofertues me mall objekt i kësaj kontrate në regjistrin tregtar të vendit.

Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument i lëshuar nga institucioni përkatës që vërteton se prodhimi i traversave të drurit është në pajtueshmëri me standartet evropiane të prodhimit të traversave të drurit dhe specifikimeve teknike për tu përdorur në linjat hekurudhore. Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie nga furnizuesi/prodhuesi me anë të së cilës ai siguron për përmbushjen e specifikimeve teknike për prodhimin e traversave të drurit sipas standartit të vendit i cili është analog me standartin evropian. Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Dokument i lëshuar nga institucioni përkatës për testimin e traversave të drurit. Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë garanci për mallrat e ofruar, sipas kushteve të shtojcës 10 të DST. Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik:** të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një mostër për traversat e ofruara, në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit (Pranë H.Sh. sha, Durrës). Mostra duhet të shoqërohet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

me dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar origjinën dhe testimet kryera nga prodhuesi i saj (dokumentacioni duhet të jetë i përkthyer në shqip, konformë kërkesave ligjore). Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

- Operatori ekonomik “A.L.I.” konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 **Kapaciteti teknik**: të kërkesave për kualifikim është përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument nga Firma prodhuese e traversave e cila duhet të ketë në dispozicion fabrikën e impenjimit e cila duhet të jetë sipas standarteve europiane. Në lidhje me këtë pikë OE duhet të paraqesë një deklaratë konformiteti CE e cila vërteton që fabrika e impenjimit është e certifikuar.

Në përmbushje të këtij kriteri ky operator nuk ka paraqitur asgjë nga sa është kërkuar.

Referuar sa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e A.L.I.” si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga K.Sh., Y.M., L.K.

Zbatimi i kontratës

Dokumentacioni teknik që shoqëron mallin është konformë për sa përshkruhet në kontratë.

Konkretisht:

Fatura nr.09.112018 e lëshuar nga Shoqëria “A.L.I.” për 133,73 traversa druri normale dhe 24,23 traversa druri speciale me vlerë totale 11,773,194 lekë. Procesverbali i dorëzimit i firmosur datë 21.09.2018 për 19.44 m³ traversa normale, nga L.I., C.M. dhe P.D.. Në këtë procesverbal cilësohet se “Ato rezultojnë në përputhje me specifikimet teknike, nuk ka çarje dhe plasje, janë të drejta dhe të rregullta dhe kanë thellësinë e duhur të impenjimit dhe janë në përputhje me përmasat si më poshtë: 2,6x0,26x0.16 m³. Me fletë hyrje nr.195, datë 09.11.2018 është bërë hyrje në magazinë traversa normale 13379 m³ për vlerën 8,090,665 lekë.

Traversat janë të shoqëruara me:

Deklaratë doganore nr.97984 datë 21.09.2018	Eur.1 nr.0014130
Deklaratë doganore nr.99224 datë 24.09.2018	Eur.1 nr.0221744
Deklaratë doganore nr.100829 datë 27.09.2018	Eur.1 nr.0040021
Deklaratë doganore nr.102834 datë 04.10.2018	Eur.1 nr.0040022
Deklaratë doganore nr.104450 datë 09.10.2018	Eur.1 nr.0040023
Deklaratë doganore nr.106767 datë 12.10.2018	Eur.1 nr.0040024
Deklaratë doganore nr.106804 datë 14.10.2018	Eur.1 nr.0040025
Deklaratë doganore nr.113284 datë 31.10.2018	Eur.1 nr.0040026
Deklaratë doganore nr.115074 datë 05.11.2018	Eur.1 nr.0040027
Deklaratë doganore nr.117613 datë 12.11.2018	Eur.1 nr.0040028
Deklaratë doganore nr.19444 datë 16.11.2018	Eur.1 nr.0040029
Deklaratë doganore nr.122259 datë 22.11.2018	Eur.1 nr.0040030
Deklaratë doganore nr.123446 datë 24.11.2018	Eur.1 nr.0040031
Deklaratë doganore nr.126909 datë 30.11.2018	Eur.1 nr.0040032

3. Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi në Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas”, viti 2018.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi në Segmentin e ri Hekurudhor Domje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Aeroporti Nënë Tereza Rinas” viti 2018.		
1.Urdhër Prokurimi Nr 541 Datë 23.05.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.541/1 dt. 23.05.2018 -K.I Drejtuese e Nj.SH.B.M. -O.J. me detyrë shef. Sek. Llogaritare, arkëtare dhe magazinierë pranë Karburantit NJ.SH.B.M -L.K. me detyrë specialiste e sektorit juridik
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.37 dt.05.01.2018 -E.L. shef i sektorit të prokurimeve. -L.D. me detyrë Specialiste Prokurimesh -A.G. me detyrë Specialiste Prokurimesh	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,450,000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) _____5,700,000_____lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 750.000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 04.06.2018	9.Burimi Financimit Të ardhurat e shoqërisë	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _10_ OE b)S’kualifikuar _3_ OE, c) Kualifikuar _7_ OE
11.Ankimime AK-ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -përgjigje nr 654/1 datë 18.06.2018	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s’ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.772 prot. Datë 11.07.2018	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 5,700,000 lekë	16.Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 11.07.2018 deri më datë 11.10.2018 , pra 90 ditë Zbatuarditë	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -S’ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë tender i hapur.

Me shkresën pa nr.prot., datë 19.04.2018, protokollur HSH nr.419 pro, datë 19.04.2018 është bërë kërkesa nga Bashkim Kasoruhë me detyrë Drejtues i Njësisë së Zbatimit të projektit drejtuar administratorit të shoqërisë dhe njësisë së shërbimeve të brendshme mbështetëse, për realizimin e procedurës me objekt Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi ne Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas .

Specifikimet teknike dhe afati i realizimit, janë hartuar nga N.K. me profesion ing. Ndërtimi, B.D. me profesion Menaxhim ndërtimi dhe A.G. profesion ekonomiste.

Me urdhër të administratorit nr.419/1 prot., datë 20.04.2018 është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit ku është urdhëruar Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik.

Me urdhër të K.I. me detyrë Drejtuese e Njësisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse pa numër protokoll datë 26.04.2018 është krijuar komisioni për llogaritjen e fondit limit i përbërë nga N.K. me profesion ing. ndërtimi, B.D. me profesion menaxhim ndërtimi dhe A.G. me profesion ekonomiste.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 14.05.2018 K.I. në cilësinë e drejtueses së Njësisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “Geopovver” ShPK., Tiranë me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi ne Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SHë DURREË

Me shkresën datë 15.05.2018 Ethem Bejko në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “G. ” ShPK.”, i është drejtuar shoqërisë “H.Sh. me ofertë , në vlerën 6,450,000 lekë.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 14.05.2018 K.I. në cilësinë e Drejtueses së Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “G. 2010” ShPK., Tirane me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi ne Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas .

Me shkresën datë 15.05.2018 Eduard Shaqollari në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “G. 2010” ShPK.”, i është drejtuar shoqërisë “H.Sh. me ofertë , në vlerën 6.595.000 lekë.

Me shkresën nr.ekstra prot., datë 14.05.2018 K.I. në cilësinë e drejtueses së Njesisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse i është drejtuar shoqërisë “Gj.” ShPK., Tiranë me kërkesë për testim tregu, duke i kërkuar të dërgoni ofertën për testim tregu për “Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi ne Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas .

Me shkresën datë 19.05.2018 P.L. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Gj.” ShPK.”, i është drejtuar shoqërisë “H.Sh. me ofertë, në vlerën 6.878.474 lekë.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer nga N.K., B.D. dhe A.G. në vlerën 6,450,000 lekë.

Vlera 6,450,000 lekë, është marrë si oferta më e ulët e paraqitur.

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativa vetë renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi N.K., B.D. dhe A.G. .

Me urdhër të Administratorit A.D. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor me nr.541 prot., datë 23.05.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 6,450,000 lekë, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me objekt Shërbim Konsulencë për Punimet Topogjeodezike të Piketimit të Gjurmës së Hekurudhës dhe të Përcaktimit të Pronave për Efekt Shpronësimi në Segmentin e ri Hekurudhor Domje Aeroporti Nënë Tereza Rinas. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit“, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

- fondin e përlogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Në urdhrin e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 60 i ndryshuar VKM nr.914 datë 29.12.2014

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 24.10.2017 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim.

Shkelja e dispozitës së përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G.

Me urdhër të administratorit nr.591/1 prot., datë 23.05.2018 është ngritur njësia komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.I me profesion shkenca politike, O.J. me profesion ekonomiste, L.K. me profesion juriste.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 04.06.2018 për hapjen e procedurës për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

A. me ofertë në vlerën 6,000,000 lekë, Gj. me ofertë në vlerën 6,150,000 lekë, Gj. me ofertë në vlerën 5,300,000 lekë, Gr.Albania me ofertë në vlerën 5,555,555 lekë, HE-sk me ofertë në vlerën 4,192,500 lekë, I. me ofertë në vlerën 5,700,000, ITM me ofertë në vlerën 4,800,000 leke, J., Lorenc me ofertë në vlerën 6,250,000 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 08.06.2018 për vlerësimin e procedurës së tenderimit duke kualifikuar operatorët A., Gj., I. dhe të s’kualifikojë operatorët Gj., G., He-sk, Itm, J., L.Co, L..

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar 29.06.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.I, O.J.,L.K., raport i cili është miratuar dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, duke shpallur fitues operatorin ekonomik I. me ofertë në vlerën 5,700,000 lekë

Njoftimi i fituesit është në buletin nr.27, datë 09.07.2018 të agjencisë së prokurimit publik.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 05.07.2018 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori fitues “I.” Sh.p.k.

Kontrata është lidhur ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” sha dhe Shoqërisë “I. ” Sh.p.k në vlerën 5,700,000 lekë, e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga A.D. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë nr.772 prot datë 11.07.2018 dhe për shoqërinë “I.” Sh.p.k nga administratori Ethem Bejko.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje aksesore hekurudhorë”, viti 2019.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje aksesore hekurudhorë” viti 2019		
1.Urdhër Prokurimi Nr 401 Datë 01.04.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.401/1 dt. 01.04.2019 -K.Sh. me detyrë Drejtor i Njësisë së Biznesit të Mallit. -E.J. me detyrë zv.Drejtes i Nj. Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës -D.B. me detyrë Shef Sektori i IT
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.45 dt. 15.01.2019 -E.L. me detyrë Shef sektori i Prokurimeve. -L.D. me detyrë Specialiste e Prokurimeve. -A.G. me detyrë specialiste e Prokurimeve.	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,666,666 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 5,900,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 766,666 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.04.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit për vitin 2019	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>2</u> OE b)S'kualifikuar 1 OE, “Sh.”
11.Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP-s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s'ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s'ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.401/2 prot. datë 31.05.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 7,080,000 lekë	16.Likuiduar deri dt, Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17-Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi Në proces furnizimi	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 31.05.2019 deri më datë 30.09.2019, pra 4 muaj. Zbatuarditë	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -S'ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për propozim”.

Me shkresën nr.323 prot, datë 20.03.2019, nga Drejtuesi i Njesisë së Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, D.M., drejtuar Administratorit të Shoqërisë H.Sh. SHA., në të cilën është kërkuar miratim për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Aksesorë Hekurudhorë”, së bashku me preventivin përkatës, llogaritjen e fondit limit, specifikimet teknike, arsyetimin përkatës për domosdoshmërinë e investimit, grafikun e punimeve dhe skicat përkatëse për secilin tip aksesor. Preventivi i punimeve së bashku me elementët e mësipër është hartuar nga M.K. me profesion inxhinier ndërtimi, M.B. me profesion inxhinier ndërtimi dhe Xh.B. me profesion teknik ndërtimi, për 8 aksesorë në shumën e fondit limit 6,669,000 lekë pa TVSH. Përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë bazuar në eksperiencat e kontratave të mëparshme për llogaritjen e këtij fondi, konkretisht në kontratën me nr.6, datë 24.11.2016.

Me shkresën nr.235, datë 21.02.2019, titullari i AK-së autorizon Njësinë e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës për përgatitjen e dokumentacionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, afatet e lëvrimit të mallrave ose shërbimeve si dhe argumentimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Me urdhër të Administratorit A.D. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor me nr.401 prot., datë 01.04.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 6,666,666 lekë, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me objekt “Blerje aksesorë hekurudhorë. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet Njësia e Prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Me urdhër të administratorit nr.401/1 prot., datë 01.04.2019 është ngritur njësi komisioni i vlerësimit të ofertave të përbërë nga K.Sh. me detyrë Drejtor i Njesisë së Biznesit të Mallit, E.J. me detyrë zv.Drejtes i Nj. Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës dhe D.B. me detyrë Shef Sektori i IT.

Me shkresën pa nr.prot, dhe pa datë, është dërguar njoftimi i kontratës për publikim në Buletinin publik, i cili përmban, emrin dhe adresën e AK-së, llojin e procedurës “Kërkesë për propozim”, Objektivin e kontratës, Numrin e referencës së procedurës, Fondin limit të vlerën 6,666,666 lekë pa TVSH, kohëzgjatjen e kontratës për ekzekutim 4-muaj, afatin e fundit të dorëzimit të ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje i cili është 15.04.2019. Njoftimi i kontratës është publikuar në Buletinin nr.14, datë 08.04.2019.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 01.04.2019 të firmosura nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim. Për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe të dokumentuar në procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nei 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njesisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësi e prokurimit”.

Në pikën 2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin Vërtetim nga Zyra e tatim taksave, deklaratën e xhiros vjetore ku vlera e saj mesatare për tre vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kontratës që prokurohet. Veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, autoriteti kontraktor kërkon:

Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”

Në opinionin e grupit të auditimit, kriteri mbi paraqitjen e xhiros mesatare vjetore kërkohet në mënyrë që të vërtetohet se operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar kriterëve të veçanta të hartuara nga Njësia e Prokurimit, në lidhje me këtë procedurë prokurimi, është asistuar nga APP, nëpërmjet e-mailit të koordinimit për të kryer ndryshimet përkatëse në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2017, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Nga ana e NJP janë marrë në konsideratë rekomandimet e APP-së por përsëri konstatohet se në lidhje me kriterin e kërkuar në rubrikën 3.3 Për kapacitetet teknike dhe profesionale ku është kërkuar që:

Shoqëria që furnizon ofertuesin duhet të ketë këto çertifikata:

- a) Çertifikatë ISO 9001:2015 e Menaxhimit të Cilësisë
- b) Çertifikatë ISO 14001:2015 e Manaxhimit të Ambientit

Të dyja këto çertifikata nuk argumentohet se për çfarë janë kërkuar nga Njësia e Prokurimit, por edhe me insistimin e APP-së për të ndryshuar këto kërkesa rezulton se nuk janë marrë në konsideratë duke kryer vetëm ndryshimin e citimit Nga “Shoqëria që furnizon ofertuesin duhet të ketë këto çertifikata”, në “Shoqëria prodhuese duhet të ketë këto çertifikata”, ku në këndvështrimin e grupit të auditimit, nuk ka kryer asnjë ndryshim thelbësor, vetëm ka ndryshuar fjalët pa humbur kuptimin e mëparshëm. Vendosja e këtyre kriterëve nuk është në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 30, në të cilin parashikohet se “AK, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.

Pra sikurse është kërkuar në pikën 3.7 të kërkesave për kapacitetet teknike dhe profesionale, Garanci për mallin e ofruar sipas kushteve të Shtojcës 9 të DST-ve, kjo gje mund të plotësohet me një vet deklarim nga Operatorët Ekonomik ofertues që në këtë rast furnizuesi të jetë konformë standardeve të kërkuara, dhe të rezervojnë të drejtën për verifikimin e vet deklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur Operatori Ekonomik shpallet fitues, AK të kërkojë më pas paraqitjen e çertifikatave të kërkuara.

Shkelja e dispozitave të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.A.

Nga Njësia e Prokurimit u është dërguar ftesë për ofertë nëpërmjet sistemit të APP-së, 5 operatorëve dhe konkretisht:

1. SH.
2. Z.
3. A.B.C.D
4. B.
5. GJ.

Nga grupi i auditimit konstatohet se për operatorët e përzgjedhur të cilëve u është dërguar ftesë, nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e tyre.

Vepim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 4, paragrafi II-të i cili në mënyrë eksplicite citon se: “Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.”

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 23.04.2019, për hapjen e procedurës për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

1. Sh. me Nipt K68121808VV, me ofertë në vlerën 5,180,000 lekë pa TVSH, dhe

2. Z. me Nipt J67902827A, me ofertë në vlerën 5,900,000 lekë pa TVSH

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës me datë 08.05.2019 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.Sh., E.J. dhe D.B., raport i cili është miratuar dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, duke shpallur fitues operatorin ekonomik Z. me Nipt J67902827A, me ofertë në vlerën 5,900,000 lekë pa TVSH.

Njoftimi i fituesit është dërguar dhe është publikuar në buletin nr.19, datë 13 Maj 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kontrata është lidhur ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” SHA dhe shoqërisë “Z.” Sh.p.k në vlerën 5,900,000 lekë pa TVSH dhe në vlerën 7,080,000 lekë me TVSH, e nënshkruar për Hekurudhën Shqiptare nga A.D. në cilësinë të Administratorit të Shoqërisë 401/2 datë 31.05.2019 dhe për shoqërinë “Z.” Sh.p.k nga administratori Pajtim Z..

Për veprimet dhe konstatimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1) Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2) VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

3) Ligji nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”

4) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z.E.L. me detyrë shef sektori në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

2) Zj. L.D. me detyrë kryeinxhinierë, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

3) Zj. A.G. me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

Zbatimi i kontratës së procedurës së prokurimit.

Në lidhje me zbatimin e procedurës së prokurimit “Blerje aksesore hekurudhorë”, viti 2019, rezultoi se kjo kontratë është brenda afatit të përcaktuar për furnizimin me mallrat e kërkuar dhe nuk është kryer asnjë likuidim.

Nga Njësia e prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenin 3 dhe 29 të “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, për sa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Mbrojtja e Urës së Drojës”, viti 2018.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbrojtja e Urës së Drojës” viti 2018		
1.Urdhër Prokurimi Nr 684 Datë 25.06.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.684/1 dt. 25.06.2018 -D.M. me detyrë Drejtues NJ.B.M.I -E.J. me detyrë zv.Drejtues NJ.B.M.I -L.A. me detyrë specialiste e sektorit juridik
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.37 dt.05.01.2018 -E.L. shef i sektorit të prokurimeve. -L.D. me detyrë Specialiste Prokurimesh -A.G. me detyrë Specialiste Prokurimesh	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,833,333 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) _____ 4,013,083 _____lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1.820.250 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 16.07.2018	9.Burimi Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

		12 OE b) S'kualifikuar <u>0</u> OE, c) Kualifikuar <u>12</u> OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP-s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.906 prot. Datë 06.09.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,013,083 lekë	16. Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 06.09.2018 deri më datë 06.11.2018 , pra 60 ditë Zbatuarditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë -S'ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë kërkesë për propozim:

Me shkresën nr.670 prot., datë 11.05.2018 është bërë dërgimi i materialit teknik nga D.M. me detyrë Drejtuesi i Njesisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore drejtuar Administratorit të Shoqërisë dhe Njesisë së Shërbimeve Mbështetëse, për Mbrojtje e urës së Drojës për Njesisë e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore .

Me urdhër nr.326/1prot., të D.M. me detyrë drejtuesi i Njesisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik i përbërë nga M.K. me profesion ing. ndërtimi, M.B. ing. ndërtimi dhe Xh.B. teknik ndërtimi.

-Projekti nuk është sipas kushteve teknike të projektimit, mungojnë volumet dhe llogaritjet konstruktive, në kundërshtim me KTP të miratuar me vendim nr.68 datë 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Projekti është hartuar nga ing. M.K., pa liçencë për kategoritë përkatëse të zërave sipas preventivit, veprim në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar neni 5, VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU III “Kategorizimi dhe klasifikimi i liçencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, pika 1 “Kategorizimi dhe klasifikimi i liçencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, pika a, ku në mënyrë eksplicite është shprehur se “*Liçenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar , konformë Klasifikimit të kategorive të përfituara, Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në, profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë*”.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer nga M.K., M.B. dhe Xh.B. 5,833,333 lekë.

Për përlllogaritjen e fondit limit komisioni i është referuar V.K.M nr 629 datë 15.07.2015.

Me urdhër të Administratorit A.D. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor me nr.684 prot., datë 25.06.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 5,833,333 lekë, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me objekt mbrojtja e Urës së Drojës. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Me urdhër të Administratorit nr.684/1 prot., datë 12.06.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga D.M. me profesion Ekonomist, E.J. me profesion jurist dhe L.K. profesion juriste.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 25.06.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim. Për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe të dokumentuar në procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshme bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Ne çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjerisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/te cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit”.

Në pikën 1.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”. Është kërkuar se për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave
2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit.

Veprim në kundërshtim me Shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit) me objekt “Rekomandim për hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet tenderit të procedurave të prokurimit publik, pasi duhesh kërkuar

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2015, 2016, 2017), të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave
2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit.

Shkelja e dispozitave të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomik si më poshtë:

- Shoqëria “B.” ShPK. me ofertë në vlerën 5,303,600 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “B.” ShPK. me ofertë në vlerën me ofertë 5,050,350 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “E.” ShPK. me ofertë në vlerën 4,962,750 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “G.” ShPK. me ofertë në vlerën 5,358,300 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “A.A.” ShPK. me ofertë në vlerën 5,781,900 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “Sh. 07” ShPK. me ofertë në vlerën 5,424,100 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “Sh.” ShPK. me ofertë në vlerën 4,842,516 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “R.G.” me ofertë në vlerën 4,310,700 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “S&AG” ShPK. me me ofertë në vlerën 4,579,000 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “A.” ShPK. me ofertë në vlerën 4,442,600 lekë pa tvsh.
- Bashkimi i operatorëve “M.”ShPK. &K.-D. ShPK. dhe E.A. ShPK. me ofertë në vlerën 4,013,083 lekë pa tvsh.
- Shoqëria “B.” ShPK. me ofertë në vlerën 4,089,000 lekë pa tvsh.

Nga KVO janë kualifikuar të gjithë operatorët ekonomik.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar 01.08.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga Dashamir.Mehmeti, E.J.,L.A., duke shpallur fitues Bashkimi i operatorëve “M.”ShPK. &K.-D. ShPK. dhe E.A. ShPK. me ofertë në vlerën 4,013,083 lekë

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 01.08.2018 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Bashkimi i operatorëve “M.”ShPK. &K.-D. ShPK. dhe E.A. ShPK. .

Kontrata është lidhur datë 06.09.2018 ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” sha dhe shoqërisë “M. sh.p.k në vlerën 4,013,083, e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga A.D. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë dhe për shoqërinë “M. ” Sh.p.k nga Imer M. Administrator i shoqërisë, afati 60 dite, garancia 2 vjet, 5 %, data e fillimit 06.09.2018-17.10.2018. Kontrata është nënshkruar nga Imer M. Administrator i shoqërisë, në cilësinë e shoqërisë “M. ” Sh.p.k, por jo nga secilili antar i bashkimit të operatorëve konkretisht edhe nga K.-D. ShPK. DHE E.A. ShPK., veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomik”, neni 74,pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “.....Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”.

Zbatimi i kontratës

Kontrata Nr.906, datë 06.09.2018 “Mbrojtja e urës së Drojës”, me vlerë të kontratës 4,815,700 lekë me TVSH, të lidhur ndërmjet palëve “H.SH.” Sha Durrës dhe bashkimit të shoqërive “M.” ShPK. Dibër, K.- D. ShPK. Kruje, dhe E.A. ShPK. Dibër.

Respektivisht marrëdhëniet e palëve për kryerjen e punimeve janë si më poshtë:

- Shoqëria M. ShPK. zotëron kuotën 51.4 % dhe do të kryej punimet Struktura monolite betoni C12/15 me 20% gur për murin e kapërderdhësit
- Shoqëria K.-DRURI ShPK. zotëron kuotën 33.1% dhe do të kryej punimet sipas zërave Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi >2m, prani uji, kategoria III me shk në tokë dhe Themele me gabiona me rrjete teli të zinkuar e gurë kave 1x1x1m.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SHa DURRËS

- Shoqëria E.A. ShPK. zotëron 15.5% do të kryej punimet sipas zërave struktura monolite betoni C16/20, mbushje me zhavorr pas kapërderdhësit.

Kontrata e mbikqyrjes së punimeve me vlerën 140,000 lekë pa TVSH, është lidhur më 06.09.2018 ndërmjet Studios Projektuese “N.S.” përfaqësuar nga Znj. A.B. me Licencë nr.MK 1846/3 datë 03.09.2012 lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Tiranë dhe Investitorit H.Sh. SHA përfaqësuar nga administratori Z. A.D..

Kontrata e kolaudimit të punimeve me vlerën 21,000 lekë me TVSH, është lidhur me datë 10.09.2018 ndërmjet Z. H.D. i emëruar kolaudator punimesh i pajisur me licencë nr.MK 0960/1 datë 30.11.2017 i lëshuar nga MIE Vlorë, dhe H.Sh. sha e përfaqësuar nga A.D..

Më datë 26.09.2018 është mbajtur procesverbal mbi ndryshime të volumeve. Janë shtuar punime gërmimi dhe gabionë dhe janë zbritur punime me struktura betoni me arsyen si rezultat i matjeve faktike dhe azhurnimit të projektit, këto ndryshime nuk janë pasqyruar në projektin e zbatimit dhe vizatimet përkatëse.

Në dosjen e zbatimit mungon Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit dhe pasqyra e realizimit të punimeve sipas udhëzimit nr.1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të këshillit të ministrave “për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Në preventivin përfundimtare të punimeve ndodhet zëri “mbushje me zhavorr pas kapërderdhësit” në sasinë 540 m³ me çmim 726 lekë dhe vlerë totale 392,040 lekë. Ky zë punimesh nuk figuron fare në vizatimet e projektit pra preventivi nuk përputhet me projektin, në kundërshtim me kushtet teknike të projektimit dhe Vendimi nr.68 datë 15.2.2001 për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu procesverbali i punimeve të maskuara i mbajtur me datë 05.10.2018 për këtë proces pune nuk është i shoqëruar me dokumentacion justifikues të punimeve të maskuara në kundërshtim me udhëzim nr.1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të këshillit të ministrave “për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar

Në specifikime teknike të projektit cilësohet së pas murit përforcues do të bëhet mbushja me zhavorr lumi deri në kuotën e vendosjes së gabioneve. Mbi gabionet do të hidhet një shtresë betoni C16/20. Në ditarin e punimeve procesi i punës së mbushjes me zhavorr zgjat nga data 1.10.2018 deri në ditën e përfundimit të kontratës. Pra pas mbushjes duhet të ndërtohej pjesa pas kapërderdhësit i murit me gabiona dhe në fund shtresa e betonit C16/20. Rend pune që nuk përputhet me ditarin e punimeve.

Në librezën e masave zëri mbushja me zhavorr pas kapërderdhësit është dhënë në planimetri për çdo sipërfaqe të murit të gabionave në trashësinë 2.2 m pas hedhjes së betonit C16/20.

Mospërputhja e rendit të punës mes librezës së masave, ditarit të punimeve dhe specifikimeve teknike, paqartësia e vendodhjes së mbushjes me zhavorr dhe mungesa e evidencës mbi vendosjen e këtij zëri punimesh cojnë në konkluzionin se mbushja me zhavorr pas kapërderdhësit është një punim i pakryer në vlerën 392,040 lekë pa tvsh ose 470 812 lekë me tvsh.

Nga sa mësipër vlera 470 812 lekë përbën dëm ekonomik për Hekurudhën Shqiptare dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga bashkimi i operatoreve “M.” ShPK. Dibër, K.- D. ShPK. Kruje, dhe E.A. ShPK. Dibër.

Situacioni pjesor nr.1 është i pa firmosur nga investitori H.Sh. sha nuk mban asnjë datë. Gjithashtu situacioni është firmosur vetëm nga operatori M. ShPK. dhe jo nga operatorët e tjerë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

K.-D. ShPK. Krujë, dhe E.A. ShPK. Dibër respektivisht sipas përqindjeve përkatëse të punimeve. Pa datë është dhe situacioni përfundimtar i cili përsëri është firmosur vetëm nga operatori M. ShPK. dhe jo nga operatorët K.-D. ShPK. Krujë, dhe E.A. ShPK. Dibër respektivisht sipas përqindjeve përkatëse. E njëjta situatë është edhe për kontratën edhe për librezën e masave ku i vetmi që ka firmosur është M. ShPK. Veprime në kundërshtim me vendimin nr.1, datë 10.1.2007 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, pika 3.e dhe vendimi Nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.

6.Procedura e prokurimit “Blerje Cakulli për Ballast Hekurudhor”, viti 2019.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Cakulli për Ballast Hekurudhor” viti 2019		
1.Urdhër Prokurimi Nr 438 Datë 05.04.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.282/2 dt.01.03.2019 -M.K. -M.B. -Xh.B. Njësia e prokurimit me urdhrin nr.45 datë 15.01.2019 është ngritur për gjithë vitin kalendarik 2019 L.D. A.G. E.L.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.438/1 dt. 04.04.2019 -K.Sh. -L.K. -D.B. Zëvendësuar me shkresën nr438/2 pa datë me z. B.D.j .
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,833,334 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 5,651,300 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 182.034 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 09.05.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE b)S’kualifikuar <u>0</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s’ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s’ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.438/2 prot. Datë 31.05.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 6,781,560 lekë	16.Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 31.05.2019 deri më datë 3 muaj nga data e lidhjes se kontratës.	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -S’ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me shkresën nr.235 datë 21.02.2019 të administratorit të shoqërisë drejtuar Njësisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2019 -2021 ku është kërkuar përgatitja e dokumenteve për përgatitjen e dokumenteve përkatëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Me shkresën nr.376/2 prot., datë 04.04.2019, të D.M. me detyrë Drejtues i Njësisë së biznesit, menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore janë dërguar materialet teknike për hapjen e procedurës së prokurimit me objektin blerje çakull për ballast hekurudhor, drejtuar dhe protokolluar ne H.Sh. me nr 429, datë 04.04.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Bashkëlidhur kësaj shkresë gjenden urdhri i brendshëm për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit, preventivi, llogaritja e fondit limit të objektit, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit, arsyetimi për nevojën e prokurimit. Me shkresën nr.282/2 prot datë 01.03.2019 të drejtuesit të NJBMIH D.M. është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik me përbërje M.K., z. M.B., Xh.B.,

Komisioni i sipërpërmendur ka hartuar shkresën mbi nevojën e prokurimit për objektin çakull për ballast hekurudhor bazuar në kërkesat e vazhdueshme nga të katër n/njësitë e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore por, këto kërkesa nuk janë dokumentuar në dosje, gjithashtu nuk është evidentuar edhe sasia e saktë e çakullit që kërkohet të prokurohet.

Në përlllogaritjen e fondit limit komisioni është bazuar në eksperencën e realizuar më parë nga vetë autoriteti kontraktor konkretisht në kontratën me nr.2, datë 02.0.8.2016.

Vlera e fondit limit për objektin çakull për ballast hekurudhor është vendosur 5,833,334 lekë pa tvsh dhe 7,000,000 lekë me tvsh por, edhe në këtë rast pa llogaritur sasinë e çakullit që kërkohet të blehet. Specifikimet teknike dhe afati i lëvrimit për tre muaj, janë hartuar po nga ky komision.

Me shkresën me nr.438 prot., datë 05.04.2019 të Administratorit të HSH ShA. A.D., në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 5,833,334 lekë, me procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje çakull për ballast hekurudhor”. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Nga njësia e prokurimit z. E.L., z.L.D., A.G. në zbatim të nenit 39 pika 4 e VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, janë përzgjedhur dhe ftuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit edhe 5 operatore të tjerë (C., I., Sh.B.I., S., B., B. coo). Këta operatorë janë përzgjedhur me arsyetimin e realizimit me sukses të kontratave të mëparshme me ShA., dhe nga verifikimi i historikut të QKB rezultoi se e kanë në objekt të aktivitetit të tyre objektin e prokurimit.

Me shkresën nr.438/1 datë 05.04.2019 të administratorit të HSH në cilësinë e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.Sh., L.K., D.B.. Me shkresën nr.438/2 datë s’ka është zëvendësuar anëtari i KVO z D.B. me z. B.D.j.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbal datë 05.04.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.G. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët si dhe janë përcaktuar kriteret e veçanta për kualifikim për të cilat nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre i dokumentuar në procesverbal, veprim në kundërshtim me me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit”.

Në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, nga AK është kërkuar që operatorët duhet të kenë xhiro vjetore për secilin nga tre vitet e fundit në një vlerë sa 80% e vlerës së fondit limit që prokurohet

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nen 27, pika 5b, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë balanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose

b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”

Në pikën 2.3 a, të kriterëve të kapacitetit teknik është kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të kenë në dispozicion tre kamion për dorëzimin e mallit por, pa përcaktuar përmasat e mjeteve të cilat vlerësohet se janë të nevojshme për realizimin e kontratës duke lënë shkas për konfuzion gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO

Në pikën 2.3 c, të kriterëve të kapacitetit teknik, AK ka përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin, çertifikatë ISO : sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe ISO: sistemi i menaxhimit të mjedisit, pa specifikuar organet e vlerësimit dhe akreditimit nga të cilat duhen lëshuar këto çertifikata veprime në mospërputhje me kërkesat e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nen 30, ku përcaktohet se “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.

-Me e-mailin e Agjencisë së Prokurimit Publik drejtuar HSH ShA., janë vënë në dukje problematikat e trajtuara më lartë të konstatuara edhe nga APP lidhur me hartimin e kriterëve të pranimit si dhe mbajtjen në konsideratë të parashikimeve të nenit 46 të LPP dhe nenit 27 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Njësia e prokurimit nisur nga e-mail i APP ka bërë modifikimet përkatëse në DST duke shtyrë dhe datën e hapjes së tenderit me 5 ditë, në 09.05.2019 ora 10:00.

Shkelja e dispozitave të përmendura mësipërm ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L., L.D. dhe A.A.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 09.05.2019, për hapjen e procedurës për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht për këtë procedurë ka paraqitur ofertën e tij vetëm një OE:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Sh. me nipt K68121808Ë me ofertë në vlerën 5,651,300 Lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 14.05.2019 për vlerësimin e procedurës së tenderimit duke kualifikuar operatorin si më sipër.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës në datë 21.05.2019 pa nr.prot për titullarin e AK, për këtë procedurë prokurimi i firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga K.Sh., L.K. dhe B.D.j, raport i cili është miratuar dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, duke shpallur fitues operatorin ekonomik Sh. me ofertë në vlerën 5,651,300 Lekë.

Njoftimi i fituesit është botuar në buletin nr.21, datë 27 maj 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik vlerë neto 5,180,000 lekë ndërkohë që oferta e operatorit ekonomik dhe vlera e kontratës së lidhur janë në vlerën 5,651,300 lekë (por nuk krijon ndikin pasi oferta fituese është në vlerën 5,651,300 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin datë 29.05.2019 ka bërë verifikimin e dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori fitues “Sh.” ku ka konstatuar se janë të njëjta me dokumentet e ngarkuara on line.

Kontrata është lidhur me nr.438/2 datë 31.05.2019 me afat kohor 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” sha dhe shoqërisë “Sh.” Sh.p.k në vlerën 5,651,300 lekë pa tvsh dhe e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga administratori A.D. në cilësinë e titullarit të AK dhe për shoqërinë “Sh.” Sh.p.k nga G.M., personi i autorizuar nga administratori i shoqërisë, Sh.K..

Me shkresën nr.438/2 datë 31.05.2019 të administratorit të HSH i është dërguar për ndjekje kontrata nr.432/2 prot datë 31.05.2019, njësisë biznesit, menaxhimit të infrastrukturë.

Grupi i auditimit konstaton se gjatë kësaj procedure ka shume pasaktësi në mbajtjen e numrave të protokollit pasi në dosje janë tre shkresa me nr.438/2 datë 31.05.2019 duke krijuar konfuzion ne evidentimin dhe përcaktimin e saktë të tyre.

Konkretisht shkresa nr.438/2 datë 31.05.2019 kontratë furnizimi me mallra “Blerje Çakull për ballast hekurudhor”, shkresa nr.438/2 datë s’ka urdhër i brendshëm për zëvendësimin e antarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe shkresa nr.438/2 datë 31.05.2019 dërgim kontratë për ndjekje e cila bashkëlidhur ka kontratën me objekt “Blerje Çakull për ballast hekurudhor” për vitin 2019, por të protokolluar me nr.432/2 datë 31.05.2019.

Nga verifikimi i librit të protokollit rezulton se me nr.438/2 datë 31.05.2019 është regjistruar kontrata e lidhur ndërmjet subjektit Sh. dhe HSH me objekt blerje cakull për ballast hekurudhor, ndërsa shkresa nr.438/2 datë s’ ka me objekt ndryshimi i antarit të KVO dhe shkresa nr.438/2 datë 31.05.2019 dërgim kopje të kontratës nuk janë të regjistruar në librin e protokollit.

Përsa më sipër për mos mbajtje të saktë të librit të protokollit në shkelje të ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 për Arkivat, mban përgjegjësi M.A. me detyrë sekretare në zyrën e asistencës në cilësinë e personit që ka protokolluar shkresat e dosjes së prokurimit

Zbatimi i kontratës

Në bazë të kontratës së lidhur me nr.438/2 datë 31.05.2019 me afat kohor 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” sha dhe shoqërisë “Sh.” Sh.p.k në vlerën 5,651,300 lekë pa tvsh dhe e firmosur për Hekurudhën Shqiptare nga administratori A.D. në cilësinë e titullarit të AK dhe për shoqërinë “Sh.” Sh.p.k nga G.M., personi i autorizuar nga administratori i shoqërisë, Sh.K.. Kontrata është brenda afateve për zbatimin e saj dhe deri në fazën e hartimit të këtij akt konstatimi nga HSH nuk është marr asnjë sasi malli, nuk rezulton asnjë faturë nga magazina dhe nuk është likuiduar asnjë faturë nga financa.

Nga ana e Njësisë së Prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit në të cilin përcaktohet që:

Neni 3

Pranë çdo subjekti shtetëror e jo shtetëror funksionon sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të tij. Në mungesë të një strukturë të veçantë, me urdhër me shkrim të titullarit të institucionit, ngarkohet një punonjës për punën me dokumentet.

Neni 29

Mbi kapakun e dosjes (Mod. 6) shkruhet me bojë apo shtypet pastër dhe sipas rregullave të drejtshkrimit: emërtimi i plotë zyrtar i organit shtetëror apo jo shtetëror, sektori apo dega e veprimtarisë, shkalla e klasifikimit sekret (nëse dokumenti është i tillë), numri i dosjes, viti, titulli i plotë i dosjes, afati i ruajtjes, datat ekstreme, sasia e dokumenteve që ka dosja, numri i inventarit të dosjes dhe afati i shfrytëzimit. Titulli i dosjes pasqyron drejt e në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dokumenteve që përfshihen në të, është i qartë dhe i plotë dhe përmban llojin e dokumenteve që përfshihen në dosje, emërtimin e autorit të dokumenteve, emërtimin e korrespondentit, çështjen (objektin) së cilës i referohet përmbajtja e dokumenteve dhe, sipas rastit, vendin dhe datën që përmbajnë dokumentet. Në rast se dosja përbëhet nga disa vëllime (fraksione) me përmbajtje të njëlojtë, të gjitha vëllimeve u vihet një titull i përbashkët, duke shtuar në vëllimin e fundit shënimin: “vëllimi i fundit”. Në përshkrimin e dosjeve me dokumente që kanë vlerë të veçantë, theksohet dhe qenia e tyre në origjinal apo kopje dhe mënyra e riprodhimit (dorëshkrim, daktilografim, fotokopje etj.). Kur në një dosje, krahas dokumenteve të tjera, ka dokumente shumë të rëndësishme, përmbajtja

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- 1) Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumente për përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
- 2) Urdhri i prokurimit nuk përmban emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit
- 3) Njoftimi i fituesit është bërë me vlerë tjetër nga ajo e ofruar nga OE dhe me të cilën është lidhur edhe kontrata.
- 4) Pasaktësi në mbajtjen e numrave të protokollit pasi në dosje janë tre shkresa me nr.438/2 datë 31.05.2019
- 5) Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- 2) VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- 3) Ligji nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”
- 4) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z.E.L. me detyrë shëf sektori në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
- 2) Zj. L.D. me detyrë kryeinxhinierë, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
- 3) Zj. A.G. me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
- 4) zj. M.A. me detyrë sekretare në zyrën e asistencës në cilësinë e personit që ka protokolluar shkresat e dosjes së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

7. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Bajzë Kufi” viti 2019.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Bajzë Kufi” viti 2019		
1.Urdhër Prokurimi Nr.500 datë 16.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhërin e Brendshëm Nr.282/2 Prot. datë 01.03.2019 M.K. M.B. Xh.B.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave UrdhërNr.500/1/ dt.16.04.2019 -K.Sh. Kryetar -E.J. Anëtar -B.D. Anëtar UrdhërNr.500/2/ dt.10.05.2019 për zevendësimin e anetareve të KVO -D.M. Kryetar -L.S. Anëtar -A.D. Anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4.949.773 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 4.060.208 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 889.565 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.05.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -s’ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP -s’ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.500/3 prot. Datë 07.06.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 4.872.250 lekë	16.Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt..... -Vlera me tvsh..... lekë -Vlera pa tvsh.....lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar nga data e lidhjes së kontratës 07.06.2019 deri më datë 21.08.2019 , pra 75 ditë kalendarike	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -S’ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Prokurim elektronik me procedure kërkesë për propozim

Materiali teknik për procedurë prokurimi i është dërguar H.Sh. SHA, nga D.M. me detyrë Drejtuesi i Njësisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore me shkresën nr.481 datë 10.04.2019.

Mbështetur në shkresën nr.235 prot datë 21.02.2019 të Administratorit të HSH, si dhe Urdhërin e Brendshëm nr.282/2 Prot. datë 01.03.2019 të Drejtuesit të NJBMIH për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik të objekteve të Investimeve Buxhetore për vitin 2019, komisioni i përbërë nga M.K. me profesion inxhinier ndërtimi, M.B. me profesion inxhinier ndërtimi dhe Xh.B. me profesion teknik ndërtimi, kanë llogaritur fondit limit të objektit, kanë hartuar preventivin, specifikimet teknike, arsyetimin teknik, grafikun e punimeve dhe skicat përkatëse.

Fondi limit i përlllogaritur është në vlerën 4,949,773 pa TVSH ose 5,939,728 lekë me TVSH dhe grupi i është referuar manualeve shtetërore për punimet e ndërtimit të vitit 2015 në fuqi, manualit shtetëror nr.3, për punimet e ndërtimit të rrugëve të hekurudhës në fuqi si dhe librit të normave hekurudhore.

Më datë 16.04.2019 anëtarët e njësisë së prokurimit E.L., L.D. dhe A.G., kanë mbajtur një proces verbal mbi shqyrtimin e dokumentacionit standart për procedurën kërkesë për propozim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Bajzë Kufi“, ku njësia ka vendosur të bëjë plotësimin dhe miratimin e DST. Në këtë procesverbal është përcaktuar kriteri i vlerësimit: Oferta me çmim më të ulët dhe kriteret për kualifikim.

Me urdhër të administratorit nr.500 prot., datë 16.04.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Bajzë Kufi“ me fond limit 4,949,773 lekë pa TVSH. Në këtë urdhër është përcaktuar ndër të tjera se “Ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. SHA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri”. Pra në këtë urdhër nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit“, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Me urdhër të brendshëm të administratorit nr 500/1 prot., datë 16.04.2019, është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga K.Sh. kryetar me profesion jurist, E.J. Anëtar me profesion Jurist dhe B.D., anëtar me profesion menaxher/ndërtimi.

Me urdhër të brendshëm të Administratorit Nr 500/2 prot., datë 10.05.2019 është zëvendësuar komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga K.Sh. kryetar, E.J. Anëtar dhe B.D. anëtar me anëtarët D.M. kryetar, L.S. anëtar dhe A.D. anëtar.

Me shkresën ekstra, prot., datë 10.05.2019 K.I. me detyrë Drejtuese e Njësisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse njofton anëtarët e KVO se procedura e sipërpërmendur e prokurimit hapet me datë 13.05.2019 ora 10.00.

Anëtarët e KVO më datë 13.05.2019 kanë hartuar proces-verbalin e paraqitjes së operatorëve pjesëmarrës në tender të cilët janë:

1. SH. 07 Me vlerë neto 4,060,208 Lekë pa TVSH
2. ZK me vlerë neto 4,609,165 Lekë pa TVSH
3. B. me vlerë neto 4,755,765 Lekë pa TVSH
4. C. me vlerë neto 3,658,688 Lekë pa TVSH
5. N. me vlerë neto 4,185,420 Lekë pa TVSH

Anëtarët e KVO më datë 20.05.2019 kanë hartuar proces-verbalin e shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet dhe kanë vendosur se operatorët që plotësojnë të gjithë kriteret e kërkuara janë:

1. SH. 07 Me vlerë neto 4060208 Lekë pa TVSH
2. ZK me vlerë neto 4609165 Lekë pa TVSH
3. B. me vlerë neto 4755765 Lekë pa TVSH
4. N. me vlerë neto 4185420 Lekë pa TVSH

Operatori C. kualifikohet nga ana e dokumentacionit ligjor dhe teknik por s’kualifikohet për ofertën ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA DURRËS

KVO ka hartuar raportin përmbledhës 27.05.2019 për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga D.M. Kryetar, L.S. anëtar dhe A.D. anëtar, raport i cili është miratuar dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, duke shpallur fitues operatorin ekonomik Sh. me ofertë në vlerën 4,060,208 lekë Pa TVSH.

Njoftimi i fituesit është publikuar në buletin e Njoftimeve Publike nr.18, datë 06 Maj 2019 të agjencisë së prokurimit publik fq 48.

Kontrata është lidhur më datë 07.06.2019 ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” SHA dhe shoqërisë “Sh.” ShPK. në vlerën 4,060,208 lekë pa TVSH me afat 75 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës. 5% e vlerës së saj do të mbahet si garanci për një periudhë 2 vjeçare. Kontratat e mbikëqyrjes së punimeve nr 500/4 është lidhur më 18.06.2019 ndërmjet Shoqërisë “H.Sh.” SHA dhe shoqërisë A. Studio ShPK.

8. Zbatimi i kontratës “Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në KM 138+200 deri në KM 138+800, perigonmi Bajzë-Hani i Hotit”.

Kontrata Nr.3, datë 05.10.2017 “Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në KM 138+200 deri në KM 138+800, perigonmi Bajzë-Hani i Hotit”, me vlerë të kontratës 660, 000 lekë pa TVSH, të lidhur ndërmjet palëve Shoqëria “H.Sh.” Sha Durrës dhe shoqërisë “G. K. M” ShPK. Ballsh.

Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve me vlerën 17,757 lekë pa TVSH, është lidhur më 07.10.2017 ndërmjet M.K. e pajisur me licensë me nr. MK1200/1 lëshuar më datë 18.04.2011 nga M.P.P.T, dhe H.Sh. sha përfaqësuar nga I.D.

Kontrata e kolaudit të punimeve me vlerën 2,399 lekë me TVSH , është lidhur me datë 23.10.2017 ndërmjet Zj. L.V. e emëruar kolaudatore punimesh e pajisur me liçencë nr.MK 0431/7 datë 24.07.2017 i lëshuar nga MZHU, dhe Hekurudha Shqiptare sha përfaqësuar nga Z. I.D.

Punimet do të realizoheshin në segmentin hekurudhor 138+200-km deri në 138+400 Hani i Hotit dhe konsistojnë në mbushje të trasesë me materiale shkëmbore për shkak të rrëshqitjes së trupit të trasese. Fillimisht do të realizoheshin punime gërmimi përgjatë trasesë në volumn 250m³ ku duhet të hiqej materiali i dobët sipas skicës së projektit dhe më pas duhet të realizohet sipas specifikimeve teknike mbushja me material në volumn 400m³ në të gjithë gjatësinë sipas kilometrave të përcaktuar në projekt. Pas realizimit të mbushjes do bëhet ngjeshja dhe nivelimi i skarpatës sipas kushteve teknike në sipërfaqen 1400 m².

Në preventive specifikohet se materiali mbushës është material shkëmbor cakull ndërsa në specifikime teknike flitet për material mbushës zhavorr lumi. Nga konstatimi në terren u verifikua se materiali i hedhur në vend është zhavorr lumi i papastër i përzier me rërë, material i cili nuk i përmbush kërkesat për qëndrueshmëri të skarpatës dhe të filtrimit ujit. çmimi i ofertës fituese për këtë zë punimesh është 600 lekë ndërkohë që zhavorri i lumit sipas manualit të cmimeve në VKM 629 datë 15.07.2015 është 316 lekë.

Gjatë verifikimit të punimeve në terren u konstatua se materiali mbushës nuk është hedhur gjatë gjithë gjatësisë sipas kilometrave të përcaktuar në projekt por vetëm në një zonë 15m të gjatë në një skarpatë rreth 10m të lartë. Nga verifikimet është konstatuar se materiali që është hedhur përbën volumn prej 180 m³ dhe vlerën 108,000 lekë pa tvsh ndërhyrës që sasia 220m³ në vlerën 132,000 lekë pa tvsh ose 158 400 lekë me tvsh është zë punimesh i pakryer.

Transporti i materialit mbushës për shkak të topografisë së terrenit në këtë pikë është kryer me tren me vagona V.S të cilët kanë një vëllim prej 30 m³.

Nga përlllogaritjet rezulton së janë hedhur vetëm 6 vagone me material mbushës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Materiali që është hedhur në terren që përbën vëllimin 180 m³ është zhavorr lumi dhe jo çakull dhe duhet konsiderohet me çmimin 316 lekë pra duhet të përbente vlerën 56,880 lekë ndërkohë që kontraktori është paguar me vlerën 600 lekë (180*600 =108000 lekë) diferenca 51,120 lekë pa tvsh ose 61 344 leke me tvsh përbën dëm ekonomik.

Gjithashtu është konstatuar se nuk janë kryer gërmime për heqjen e materialit të dobët sipas projektit por materiali mbushës është hedhur direkt mbi skarpatë. 250m³ gërmime në vlerën 150,000 lekë pa tvsh ose 180 000 lekë me tvsh janë punime të pakryera për të cilat kontraktori është paguar. Gjithashtu në zonën e punimeve janë transportuar vetëm 180m³ material dhe jo 400m³ pra vlera e transportimit të materialit është 90,000 lekë dhe diferenca 110,000 lekë pa tvsh ose 132 000 leke me tvsh është zë punimi i pakryer.

Detajet jepen në tabelen më poshtë.

Përshkrimi i punimeve	Preventivi fitues				Preventivi i saktë			Punime të kryera		Punime të pakryera	
	njësia	sasia	cmimi	vlera	cmimi i zhavorrit	cmimi	vlera tot	sasia	realizuar	sasia	vlera
Gërmim Kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion deri 0.75m ²	m3	250	600	150000			150000	0	0	250	150000
Mbushje traseje me material shkëmbor	m3	400	600	240000	316	126400	126400	180	56880	220	183120
Nivelim skarpate sipas pjerrësisë së skarpatëes	m2	1400	50	70000			70000	50	70000	0	0
Transport materiali	m3	400	500	200000			200000	180	90000	220	110000
TOTATLI lekë				660000			546400		126880		443120
TVSH											88624
TOTALI Me TVSH											531744

Tabela 11 Punimet e pakryera

Nga sa më sipër vlera 531 744 lekë me tvsh përbën dëm ekonomik për shoqërinë H.Sh. dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “G. K. M” ShPK. Ballsh.

9. Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje aksesor dhe pajisje hekurudhore”, viti 2017:

Me urdhër transfertën datë 27.12.2016 nëpërmjet Raiffeizen Bank është likuiduar Shoqëria “Gj.” ShPK. për vlerën 888,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr.375, datë 06.11.2016 në vlerën 888,000lekë, Për blerje pjesë hekurudhore dhe materiale. Situacion i pa datuar, për vlerën 880,000 lekë, i detajuar për: Pllaka lidhëse për shina S-49 + 2bulona + 2 dado +2 rondele për vlerën 78 vlera 273,000 lekë; Pllaka shtruese copë për shina S-49 copë 152 për vlerën 288,800, Zhabica koplet për pllaka shtruese S-49 copë 200 për vlerën 110,000 lekë. Trifona linje hekurudhore copë 400 për vlerën 68,200 lekë. Situacioni është i firmosur nga L.I., C.M., M.K.. Materialet janë bërë hyrje me fletë hyrje datë 05.01.2018, të cilët me urdhërin nr.1439/1 prot, datë 26.10.2017 të drejtuesit të njësisë së infrastrukturës E.D., janë ngarkuar për marrjen në dorëzim. Me fletë hyrjen nr.1, datë 06.11.2017 materialet janë marr në ruajtje. Me procersverbal datë 06.11.2017 materialet janë marr në ruajtje, të firmosur nga ky grup. Me procersverbal datë 17.11.2017 materialet janë marr në doërzim të firmosur nga L.I., C.M., M.K.. Ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Mallrat e mësipërme pasi u kontrolluan dhe u numëruan rezultuan si më poshtë:

Pllaka lidhëse për shina S-49 + 2bulona + 2 dado +2 rondele copë 78; Pllaka shtruese copë për shina S-49 copë 152, Zhabica koplet për pllaka shtruese S-49 copë 200, Trifona linje hekurudhore copë 400.

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me çertifikatë cilësie (test raport fabrike), çertifikat sigurie, çertifikatë origjine, çertifikatë euro 1, list paketim, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e çertifikatë cilësie (test raport fabrike), që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

teknike), dhe për të cilën Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Veprim në kundërshtim me ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë, grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të japë opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Pra në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të jap opinion e Tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmoj që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.

Deri në paraqitjen nga “Gj.” ShPK. të çertifikatë cilësie (test raport fabrike), çertifikat sigurie, çertifikatë origjine, çertifikatë euro 1, list paketim, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “Gj.” ShPK. ShPK. ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar, vlera 888,000 lekë për Shoqërinë “H.Sh.” dhe Buxhetin e Shtetit, *përbën dëm ekonomik*, dhe nqs nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga “Gj.” ShPK.

Për sa mësipër mban përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë L.I., C.M., M.K..

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

1. Titulli i gjetjes: Mangësi në vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë Shoqërinë.

Situata: *Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin*

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të ardhurat në përgjithësi janë korrekte dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Dobësitë e identifikuara në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit dhe kontabilitetin, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë, si psh harxhimin e karburantit për shkak të makinerive të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, dëmshpërblimet nga zgjidhjet e pa arsyeshme të kontratave të punësimit, transportit të mallrave dhe mungesën e një rregulloreje për provizione etj.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nuk ka ndërmarr *aktivitete shitesë* për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut, pasi.

- Gjurmët e auditimit nuk janë hartuar, miratuar dhe arkivuar nga çdo njësi biznesi.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, funksionon në nivel Drejtorie, por jo për çdo njësi biznesi, si dhe regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi biznesi.

-Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Sektorët nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Ka struktura të tepërta që duhet të suprimohen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës.

-Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe janar-maj 2019 me vendimin nr.7 datë 08/05/2019 i cili përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 gërma a.

-Kontabiliteti i njësisë mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve nuk janë hartuar nga çdo njësi.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten *aktivitete shitesë* për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

Shkaku: Mos njohje sa dhe si duhet e dispozitatve ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Për forcimin e performancës së shoqërisë, duke siguruar se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit, që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të marr masa për:

- Funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik si në nivel të Drejtorie, ashtu edhe për çdo njësi biznesi.

-Të hartuar, regjistrin e riskut nga çdo njësi biznesi, si dhe miratuar dhe arshivuar gjurmët e auditimit nga çdo njësi biznesi.

- Përmirësim e strukturës organizative, ku sektorët të organizohen në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj, të suprimohen strukturat e tepërta, si dhe klasifikimi i punonjësve, përveçse të lidhet ngushtësisht me detyrat që i ngarkohen secilit të emëruar sipas pozicionit përkatës, por dhe me masën e shpërblimit, pasi ky është dhe qëllimi i klasifikimit, pasi pozicioni i punës përbën një shërbim ose punë që kryhet kundrejt pagës së merituar.

- Shpenzimet e karburantit të mos administrohen nga NjBU, por të krijohet një strukturë e veçantë nën varësinë e Njësisë Ekonomike, e cila të merret me llogaritjen e nevojave për karburant, ndjekjen e kontratës, magazinimin, shpërndarjen, zberthimin e grafikut të lëvizjes dhe dokumentimin e tij, kontrollin e konsumit sipas normativave etj.

- Të rishikohet niveli i pagës së sektorit të Auditit të Brendshëm, duke e konsideruar si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bën. Ky sektor auditon punën e Drejtuesve të Njësisë, shefave të sektorëve etj, por pagesa e tyre është shumë më e ulët se paga e personave që auditojnë.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve duhet të hartohen nga çdo njësi, si dhe të merren masa për për marrjen në dorëzim, inventarizimin dhe daljen nga përdorimi të aktiveve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Auditimi jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të ardhurave dhe shpenzimeve në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të ardhurave, shpenzimeve, pasurive, subvecioneve, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të ardhurat në përgjithësi janë korrekte dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Dobësitë e identifikuara në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit dhe kontabilitetin, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë, si psh harxhimin e karburantit për shkak të makinerive të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, dëmshëprilimet nga zgjidhjet e pa arsyeshme të kontratave të punësimit, transportit të mallrave dhe mungesën e një rregulloreje për provizione etj.

Menaxhimi i mirë

Fusha të veçanta të auditimit lidhur me menaxhimin ka qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët specifik janë trajtuar në aktkonstimet e mbajtur në zbatim të pikave të programit të auditimit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi Menaxhimin

Menaxhimi, vështuar në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe planifikimit strategjik, pasqyron një situatë pozitive. Shoqëria ka shënuar progres të vazhdueshëm në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga vitet paraprake, përfshirë raportimin menaxherial dhe llogaridhënien. Përkundër progresit të arritur për një administrim edhe më të mirë, menaxhmenti duhet t’i kushtoj kujdes të duhur funksionalizimit të NJAB, dhe kontrollit lidhur me çështjet e ngritura në këtë raport.

Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka qenë funksionale gjatë tërë vitit 2018 dhe janar-maj 2019. Konkretisht:

Plani i auditimit të brendshëm për vitin 2018 dhe plani strategjik, është paraqitur për miratim me shkresën nr.799 datë 13/10/2017. Realizimi i tij është raportuar në Këshillin Mbikqyrës me shkresën nr.184 prot., datë 12/02/2019 dhe është Miratuar nga Këshilli Mbikqyrës me vendimin nr.2, datë 27/03/2019. Plani i vitit 2018 është realizuar. Konkretisht nga 6 njësitë e planifikuara janë realizuar 6. Programet e auditimit janë hartuar pas përcaktimit të fushave me risk të lartë në bazë të auditimeve të mëparëshme. Është marrë në konsideratë gjatë hartimit të programeve edhe reagimi i subjektit të audituar në raportimin e zbatimit të rekomandimeve. Në hartimin e programeve në të gjitha rastet është konsultuar paraprakisht me menaxhimin e çdo njësie, por nga ana e tyre nuk ka patur ndonjë propozim për ndryshime në projektin e programit të paraqitur. Në misionet e auditimeve të realizuara është marrë në konsideratë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH A DURRËS

- Njohjen me subjektin që do të auditohet, dhe është marrë kontakt me subjektet e audituara.
- Përcaktimin e problemeve dhe drejtimeve kryesore që do të mbulojë grupi auditues.
- Vlerësimi i riskut.
- Është kryer kontakti dhe ballafaqimi me personat përgjegjës për rastet e shkeljeve, parregullsive apo dobësive të konstatuara në proceset e auditimit.
- Është përgatitur dokumentacioni i auditimeve dhe masat e rekomanduara.

Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ndërmarrjen.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten *aktivitete shtesë* për të forcuar kontrollin në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

Konkretisht në opinionin e grupit të auditimit Menaxhmenti, duhet:

-Të marr masa për të hartuar, miratuar dhe arshivuar gjurmët e auditimit nga çdo njësi biznesi.
-Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të fillojë të funksionojë si në nivel të Drejtorie, ashtu edhe për çdo njësi biznesi.

-Regjistri i riskut duhet hartuar nga çdo njësi biznesi.

-Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Sektorët të organizohen në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Strukturat e tepërta duhet të suprimohen. (psh në Njësinë e Biznesit të Mallit orgaN. Dega e Marketingut dhe Kontrollit të Veprimtarisë ka në strukturë kryetar dege dhe 2 shefa sektorësh, sektori teknik dhe sektori i marketingut. Në Sektorin e Marketingu bëjnë pjesë 2 specialiste, ku njëra ndjek harxhimin e karburantit për lokomotiva, punë me natyrë krejtësisht teknike, po ashtu edhe kontrolluesi i veprimtarisë + zberthim grafiku është me natyrë krejtësisht teknike.) Kryetari i kësaj dege në strukturë duhet të ketë arsim të lartë ekonomik ndërkohë që dega teknike drejtohet nga një inxhinier. Detyrat e Kryetarit të Degës, shefit të sektorit të marketingut dhe specialistit të marketingut janë pothuajse të njëjta. Organizimi i kësaj strukturë do të ishte mirë të bëhej në nivel sektori. Pra struktura e kësaj njësie mund të jetë më e reduktuar.

-Karburanti nuk ka pse të administrohet nga NjBU, por të krijohet një strukturë e veçantë për administrimin e karburantit nën varësinë e Njësisë Ekonomike e cila të merret me llogaritjen e nevojave për karburant, ndjekjen e kontratës, magazinimin, shpërndarjen, zberthimin e grafikut të lëvizjes dhe dokumentimin e tij, kontrollin e konsumit sipas normativave etj.

Në Njësinë Ekonomike ekziston Sektori i Programimit. Ndërkohë që ky merret me hartimin e programeve ekonomike përfshirë dhe fondin e pagave. Nivelin e pagave për çdo punonjës e llogarit Sektori i Burimeve Njerëzore në varësi të Njësisë së Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse, kur mund të llogaritet nga Sektori i Programimit i cili ka në përbërje dy ekonomistë me arsim të lartë. Në rregulloren e brendshme duhet të suprimohen dublimi i detyrave në niveleve të menaxhimit.

Motivimi në punë duhet të bëhet sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës. Psh. një ekonomist marketingu nuk ka pse të paguhet më shumë se një ekonomist finance edhe pse natyra e punës është e njëjtë.

Në 27 raste, shefat e sektorëve kanë paga të ndryshme edhe pse kanë emërtim të njëjtë. Konkretisht: Një rast shef i sektorit me pagë 56,000 lekë, 20 raste shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë, 6 raste me pagë 45,000 lekë. Në 2 raste, specialist të thjeshtë ka pagën 48,900 lekë sa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH A DURRËS

6 shefat e sektorëve me pagë 48,900 lekë (Specialistët e Sigurimit teknik). Gjashtë specialist PIU edhe pse është strukturë e HSH ka pagë 75,000 lekë, pra me paga preferenciale ndryshe nga specialistët e tjerë të të njëjtit nivel.

-Në opinionin e grupit të auditimit, Sektori i Auditit të Brendshëm duhet të konsiderohet si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bën. Ky sektor auditon punën e Drejtuesve të Njësive, shefave të sektorëve etj, por pagesa e tyre është shumë më e ulët se paga e personave që auditojnë. Konkretisht paga e shefes sektorit se Auditimit është 48,900 lekë, sa një specialist i sigurimit teknik të Infrastrukturës. Në përcaktimin e pagës për shefin e sektorit të auditimit nuk është marrë parasysh fakti që me vendimin nr.15 datë 23/06/2006 të Këshillit Mbikëqyrës të paga e Shefit të Sektorit të Auditimit ka qenë e miratuar kështu :Paga e grupit 9,000 lekë + shtesë për pozicion 55,000 lekë + shtesë vjetore për vjetërsi. për vitin 2018 pagat janë miratuar me vendimin nr.1 datë 02/02/2018. Theksojmë se me vendimin nr.1 datë 02/02/2018 niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri pesëmbëdhjetë dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet.

Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe për periudhën janar-maj 2019, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.7 datë 08/05/2019, përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 germa a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.

Kontabiliteti i njësive mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike.

Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

Nga Menaxhmenti, duhet të merren masa për mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike.

Regjistrat themeltarë të aktiveve duhet të hartohen nga çdo njësi.

Nga Menaxhmenti, duhet të merren masa për marrjen në dorëzim, inventarizimin dhe daljen nga përdorimi të aktiveve. (Rastet e diferencave të analizohen deri në përcaktimin e përgjegjësisë individuale të çdo personi përgjegjës material. Diferencat që rrjedhin nga shitja e skrapit duhen analizuar një nga një e jo të kalojnë në rezultat pa përcaktuar arsyet e mungesave).

Spektori i Auditimit të Brendshëm

Plani i auditimit të brendshëm për vitin 2018 dhe plani strategjik, është paraqitur për miratim me shkresën nr.799 datë 13/10/2017. Realizimi i tij është raportuar në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr.184.prot datë 12/02/2019 dhe është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr.2 datë 27/03/2019. Plani i vitit 2018 është realizuar. Nga 6 njësi të planifikuara janë realizuar 6. Programet e auditimit janë hartuar pas përcaktimit të fushave me risk të lartë në bazë të auditimeve të mëparshme. Janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të programeve edhe reagimi i subjektit të audituar në raportimin e zbatimit të rekomandimeve. Në hartimin e programeve në të gjitha rastet janë konsultuar paraprakisht me menaxhimin e çdo njësie, por nga ana e tyre nuk ka patur ndonjë propozim për ndryshime në projektin e programit të paraqitur.

Misionet e auditimeve të realizuara kanë ndjekur këto procedura:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

- Njohjen me subjektin që do të auditohet, duke marrë kontakt për çdo rast me subjektet e audituara.
 - Përcaktimin e problemeve dhe drejtimeve kryesore që do të mbulojë grupi auditues.
 - Vlerësimin e riskut.
 - Kontakti dhe ballafaqimi me personat përgjegjës për rastet e shkeljeve, parregullsive apo dobësive të konstatuara në proceset e auditimit.
 - Janë përgatitur dokumentacionet e auditimeve dhe masat e rekomanduara.
- Disa nga objektivat kryesore ku është fokusuar puna e Sektorit të Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2018 kanë qenë:

- Funksionimi i Kontrollit të Brendshëm në të 5 komponentët e tij, në çdo Njësi Biznesi të Shoqërisë.
- Përdorimi me dobi, frytëshmëri dhe kursim i fondeve publike që përdoren në veprimtarinë e shoqërisë, si dhe në njësitë përbërëse të saj.
- Rregullariteti dhe mirëadministrimi financiar për të vlerësuar saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve dhe gjendjet e llogarive.
- Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në fusha të ndryshme të veprimtarisë së subjektit.
- Realizimi i investimeve.
- Objektet e dhëna me qira.
- Mirëmenaxhimi i aktiveve. Marrja në dorëzim, ruajtja, inventarizimi. Dokumentimi i i daljeve nga përdorimi të aktiveve në përputhje me ligjin.
- Detyrimet e prapambetura, etj.

9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Titulli i Gjetjes 1: Mungesë e plotësimin të dokumentacionit të kontratave të objekteve të H.Sh. të dhëna me qira.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave u konstatuan rastet e kontratave të cilat nuk i kanë plotësuar dokumentet sipas kërkesave ligjore konkretisht:

Për kontratën e qirasë nr.5 datë 04.04.2018 protokolluar me nr 337/1 datë 04.04.2019 lidhur ndërmjet E.K. me vendodhje në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe Administratorit të HSH SHA, në dosje mungojnë fotot e objektit.

Për kontratën e qirasë nr.12 datë 12.11.2018 midis NJBMI dhe z.A.D. me vendodhje në Stacionin Hekurudhor Dushk-Lushnje me afat 1 vjeçar mungojnë fotot e objektit. Gjithashtu konstatohet se në asnjë dosje nuk u gjenden procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit.

Mungojnë gent planet e objekteve të kërkuara dhe nga sektori i menaxhimit të kontratave nuk janë ushtruar kontrole periodike për asnjë kontratë në ambientet e dhëna me qira mbi zbatimin e kushteve të kontratës dhe nuk janë verifikuar informacionet e shefave të nën njësive rajonale në terren.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, paragrafi I, pika 3 dhe pika 6, dhe paragrafi II, pika 1, gërma a), Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Hekurudhës SHA, neni 103-109.

Ndikimi/Efekti: Nuk ka ndikim financiar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Shkaku: Kjo ka ardhur si pasojë e mos ushtrimit të kontrolleve dhe verifikimit të informacioneve të dërguara nga njësitë përkatëse, si dhe nga moszbatimi i detyrave funksionale të tyre ndaj operatorëve të cilët kanë marrë me qira asete të Shoqërisë H.Sh. SHA.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Nga Drejtuesi i NJBMIH, Sektori Juridik dhe Sektori i kontratave, të merren masat e duhura për ushtrimin e kontrolleve përkatëse ndaj operatorëve të cilët kanë marrë ambiente me qira pronë e H.Sh. ShA., duke verifikuar dhe plotësuar të gjithë dokumentacionin ligjor të dosjeve të kontratave të qirave. Gjithashtu të hartohet një program i detajuar vjetor mbi ushtrimin e kontrolleve periodike dhe të merren masat përkatëse për këto subjekte.

Titulli i Gjetjes 2: Kontrata qiraje të lidhura në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi.

Situata: Kontratë qiraje pa nr.prot, e lidhur në datë 28.12.2017 ndërmjet M.D. me vendndodhje në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe NJMBI me objekt marrje me qira ambienti për magazinë me sip 200 m² dhe me sip funksionale 5m². Kjo kontratë është përpiluar në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, në të cilin është përcaktuar se: *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur.*

Kontrata është lidhur ndërmjet Drejtuesit të Njesisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore dhe M.D. me një afat kohor 1 vjeçar, duke e përjashtuar nga procesi i konkurrimit, në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, **“Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kritere të tjera shtesë”** dhe pika 6, *“Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”*: b) **“organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”, dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”**.

Kontratë nr.20 datë 03.12.2018 lidhur midis NJMBI dhe A.T. sipërfaqja në bazë të gent planit përkatës për objektin e marrë me qira por, mungojnë fotot, planbiznesi, dhe procesverbali i dorëzimit të objektit. Sipas Gentplanit rezulton se objekti është 592.2 m², i ndarë në 4 seksione me sipërfaqe S1=222.3 m², S2=200 m², S3=83.5 m² dhe S4=86.4m². Ndërkohë që në kontratë nuk specifikohet se cili seksion është dhënë me qira.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Për sa më sipër kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, “Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kriteret të tjera shtesë” dhe pika 6, “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”: b) “organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”, dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.

Kriteri: “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, “Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kriteret të tjera shtesë” dhe pika 6, “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”: b) “organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”, dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.

Ndikimi/Efekti: Lidhje kontratash nga organet të cilat nuk e kanë këtë të drejtë duke shmangur organet kompetente dhe procedurat e kërkuara.

Shkaku: Shmangie e procedurës së konkurrimit dhe përshpejtim i procesit të miratimit të kontratës së qirasë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë, të merren masa për trajtim të barabartë të gjithë të interesuarve për të lidhur kontratat e qirasë me “H.Sh.” ShA. duke shmangur, diskriminim dhe krijuar kushtet për konkurrencë të barabartë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të pikës 9 të programit të auditimit “Nr.415/1 datë 07.06.2019”, u shqyrtua me zgjedhje dokumentacioni si më poshtë:

- 7) Kontratat e qirasë për periudhën objekt auditimi
- 8) Pagesat e likuiduara për objektet e dhëna me qira,
- 9) Korrespondenca zyrtare e Sektorit të Menaxhimit të Kapaciteteve dhe Kontratave/Njësisë së Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se:

H.Sh. ShA. është një Shoqëri tregtare me kapital 100% shtetërore, nga evidentimi i pasurive që disponon rezultoi se zotëron një numër të madh aktivesh me vendndodhje në të gjithë territorin shqiptar ku një pjesë e të cilave janë dhënë me qira.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH.A DURRËS

Në bazë të vendimit nr.120 datë 11.10.2018 të asamblesë së Aksionarit të vetëm, Shoqëria është në proces të rivlerësimit të aktiveve, e cila referuar kontratës së lidhur me ekspertët e miratuar pritet të përfundojë brenda vitit 2019.

Regjistrimi i aktiveve pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme sipas V.K.M nr.120 datë 04.03.2004 nga ana e Drejtorisë së Hekurudhave Shqiptare ShA., nuk është përfunduar, problem ky i evidentuar edhe në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga ana e “H.Sh.” SHA ka pas korrespondenca të vazhdueshme me institucionet përkatëse, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si dhe Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës për regjistrimin e aktiveve, por nuk është bërë e mundur të përfundohej asnjë proces. Është përfunduar regjistrimi vetëm i godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të “H.Sh.” SHA dhe ky regjistrim ka qenë i pjesshëm pasi ka përfunduar vetëm për objektin, ndërkohë për trullin është në proces.

-Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave SHA Durrës, për miratimin dhe dhënien me qira të pasurive Shtetërore që administrojnë, u konstatua se për vitin 2018 miratimi i dhënies me qira të aktiveve është bërë me vendimin nr.8, datë 30.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës i cili ka vendosur në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 Kreu II pika 1/d të Këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në Njësinë e Infrastrukturës sipas listës së paraqitur, me vendimin nr.9, datë 30.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, i cili ka vendosur në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 kreu II pika 1/d të Këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të një ambienti në godinën e “Hekurudhave Shqiptare”SHA, në interes të Bashkisë Durrës.

Për vitin 2018 kontratat e qirasë janë lidhur nga drejtuesi i Njësisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore, referuar autorizimit me nr.263/2 datë 16.07.2018 të Administratorit të Shoqërisë.

Për vitin 2019 miratimi i dhënies së ambienteve me qira është bërë me vendimin nr.4 datë 27.03.2019 për miratimin e dhënies me qira të ambienteve apo objekteve në Njësinë e Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori i menaxhimit të kapaciteteve dhe kontratave në NJBMI rezultoi se për vitin 2018 nga “Hekurudhave Shqiptare”SHA janë lidhur 26 kontrata qiraje ndërsa për vitin 2019 janë lidhur 22 kontrata qiraje. Aktivet e dhëna me qira kanë vendndodhje pranë stacioneve hekurudhore në Librazhd, Lushnje, Lezhë, Rrëshen, Elbasan, Durrës.

Kontratat e qirave të lidhura për periudhën objekt auditimi në “H.Sh.”SHA., janë përgjithsisht me të njëjtat subjekte private, duke ju përmbajtur të njëjtit objekt kontrate si në vitet e mëparshme ndërmjet tyre dhe Hekurudhës.

Për vitin 2018-2019 (5 mujori) janë lidhur dy kontrata të reja.

Kontrata me nr.02, datë 17.09.2018 e lidhur ndërmjet policisë bashkiake Durrës përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë V.D. dhe Drejtuesit të Njësisë së Biznesit D.M. me objekt dhënie me qira e zyrove ish-rajonale hekurudhore Durrës me afat 1 vjeçar nga lidhja e kontratës dhe kontrata nr.5 datë 04.04.2019 ndërmjet E.K. me administratorin e shoqërisë A.D. me objekt marrjen e një magazine me qira me afat deri në fund të vitit 2019 me sipërfaqe objekti 195 m² dhe sipërfaqe funksionale 5m².

-Nga auditimi me zgjedhje i mandat pagesave të kontratave të qirasë u konstatua se në shumë raste janë kryer me vonesë nga subjektet. Sektori i menaxhimit dhe kapaciteteve të kontratave ka llogaritur dhe faturuar kamatëvonesa e likuidimit të detyrimeve sipas kushteve të kontratës, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SHa DURRËS

shumën 626,967 lekë, për periudhën deri në 31.05.2019, në përputhje me nenin 4 pikën 4.2 paragrafi 4 të Kontratës së Qirasë ku përcaktohen detyrimet e palëve dhe thuhet: *“Qiramarrësi” në rast vonese të pagesës sipas vlerës së faturës tatimore jashtë kohës normale të përcaktuar do të shoqërohet me sanksione sipas ligjit dhe për çdo ditë vonesë do të paguaj një kamatë ditore prej 1% të vlerës së qirasë mujore.*

Nga ky sektor me shkresën nr.prot s’ka datë 22.05.2019 të shefes së sektorit drejtuar sektorit juridik të NJBMI janë ngritur problematikat lidhur me subjektet debitore N. 2000 pranë Stacionit Hekurudhor Elbasan dhe H.S. pranë Stacionit Hekurudhor Peqin duke kërkuar nisjen e procedurave ligjore për këto dy subjekte.

Nga “Hekurudhave Shqiptare”SHA, janë ngritur dy kërkesë padi konkretisht :

- Me nr.637, datë 29.05.2019 me palë të paditur znj. H.S. me objekt njohjen e detyrimit të qirasë mujore nga janari 2019-mars 2019 dhe detyrimin e pagesave të kamatë vonesave që rrjedhin nga pagesat e qirasë mujore të vitit 2017-2018 dhe 2019.
- Me nr.363/1 datë 29.05.2019 me palë të paditur personin juridik “N. 2000” me objekt njohjen e detyrimit të qirasë mujore nga janari – prill 2019 dhe detyrimin e pagesave të kamatë vonesave që rrjedhin nga pagesat e qirasë mujore të viteve 2017-2019.

Me shkresën nr.prot s’ka datë 11.07.2019 të shefes së sektorit të menaxhimit dhe kapaciteteve dhe kontratave drejtuar sektorit juridik të NJBMI janë ngritur problematikat lidhur me 9 subjektet debitorë për vitet 2017-2018 në shumën 797.721 lekë e llogaritur deri në datën e hartimit të shkresës, pra muajin korrik 2019, të cilat nuk pranojnë të paguajnë kamatë vonesat e faturuara nga HSH, duke kërkuar nisjen e procedurave ligjore për këto subjekte. Nga sektori juridik pranë NJBMI nuk kanë filluar procedurat ligjore në lidhje me detyrimet e këtyre subjekteve.

Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave më poshtë paraqiten rastet e kontratave të lidhura në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi:

Kontratë qiraje pa nr.prot, e lidhur në datë 28.12.2017 ndërmjet M.D. me vendndodhje në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe NJBMI me objekt marrje me qira ambienti për magazinë me sipërfaqe 200 m² dhe me sip funksionale 5m². Kjo kontratë është përpiluar në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, në të cilin është përcaktuar se: *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur.*

Kontrata është lidhur ndërmjet Drejtuesit të Njesisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore dhe M.D. me një afat kohor 1 vjeçar, duke e përjashtuar nga procesi i konkurrimit, në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, *“Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SHa DURRËS

poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kritere të tjera shtesë” dhe pika 6, “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”:
b) *“organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”, dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.*

Kontratë nr.20 datë 03.12.2018 lidhur midis NJMBI dhe A.T. sipërfaqja në bazë të gent planit përkatës për objektin e marrë me qira por, mungojnë fotot, planbiznesi, dhe procesverbali i dorëzimit të objektit. Sipas Gentplanit rezulton se objekti është 592.2 m², i ndarë në 4 seksione me sipërfaqe S1=222.3 m², S2=200 m², S3=83.5 m² dhe S4=86.4m². Ndërkohë që në kontratë nuk specifikohet se cili seksion është dhënë me qira.

Për sa më sipër kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, “Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kritere të tjera shtesë” dhe pika 6, “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”: b) *“organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”, dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.*

Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave dhe verifikimi i tyre më poshtë paraqiten rastet e kontratave të cilat nuk i kanë plotësuar dokumentet sipas kërkesave ligjore në përputhje me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar:

Kontratë qiraje nr.5 datë 04.04.2018 protokolluar me nr 337/1 datë 04.04.2019 lidhur ndërmjet E.K. në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe Administratorit të HSH SHA, nuk është siguracioni i kontratës, foto dhe gent plani i konfirmuar nga prefektura.

Kontratë qiraje nr.12 datë 12.11.2018 midis NJBMI dhe A.D. në Stacionin Hekurudhor Dushk-Lushnje me afat 1 vjeçar mungojnë foto.

-Gjithashtu në asnjë dosje nuk u gjenden procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit, në kundërshtim me vendimin nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika VI “Monitorimi i kontratave”, pika 2 ku përcaktohet: “Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të emfiteozës kryen këto detyra: “Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të emfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose emfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas gentplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose emfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Mungojnë gjenet e objekteve të kërkuara, konfirmimi nga ZVRPP përkatëse sipas kërkesave të VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. U konstatua se për periudhën objekt auditimi nga sektori i menaxhimit të kontratave nuk janë ushtruar kontrole periodike për asnjë kontratë në ambientet e dhëna me qira mbi zbatimin e kushteve të kontratës, gjithashtu nuk ka evidenca nëse ka objekte të zëna në mënyrë të jashtë ligjshme pronë e “H.Sh.” ShA., dhe nuk janë verifikuar informacionet e shefave të nën njësiteve rajonale në terren në kundërshtim me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Hekurudhës SHA, neni 103-109.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. E.S. me detyrë Shef i sektorit të menaxhimit të kapaciteteve dhe kontratave në Njësinë e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës,
2. A.D. me detyrë specialist i kontratave të qiradhënies në Sektorin e menaxhimit të kapaciteteve dhe kontratave në Njësinë e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës.
3. D.O. me detyrë Shefe e Sektorit të Pasurisë në Njësinë e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës,
4. E.D. ish-Drejtuës i Njësisë së Bisnesit Menaxhimit Infrastrukturës.

10. Përdorimi i subvencioneve shtetërore.

1.Titulli i gjetjes: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionim si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Situata: Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron qartazi një krizë të mprehtë likuiditeti të Shoqërisë “H.Sh.”. Për posë krizës, Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj, në vlerën 1,895,812 mijë lekë .

Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, jo vetëm është në krizë të mprehtë likuiditeti, por është plotësisht e falimentuar.

Më datë 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat : Raiffeisen Bank (7 numra llogarie), ABI Bank (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Kombëtare Tregtare (11 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Credins (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Pro Credit Bank (1 numër llogarie), Fibank (2 numër llogarie), Alpha Bank (2 numër llogarie), Union Bank (2 numër llogarie), Tirana Bank (1 numër llogarie), Intesa San Paulo (5 numra llogarie) Veneto Bank (1 numër llogarie), Societe Generale (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra llogarie me urdhëra sekuestro nr.11 në vlerën totale 44,938,145 lekë .

Referuar sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Përpos sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk i është dhënë vëmendja e duhur në investime shtetërore, që s’duhet ti mungonin si e vetmja shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtareve, ashtu siç i jepen infrastrukturës automobilistike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot, datë 20.06.2018, ka çuar për indicie për ndjekje penale për përdorimin e subvencionit për vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Aplit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr (11-2019-1312)309 datë 06.03.2019 të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe **pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale** nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019

Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 58 të nenit 5 të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet përkufizimi i rrjetit hekurudhor konkretisht: *“Rrjet” janë linjat, stacionet, terminallet dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.*” Pra rrjeti nuk është veprimtari (subjekt) por objekt.

Referuar sa mësipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga H.Sh., duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kriteri: Ligji nr.9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ligji nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.8, datë 02.02.2007 ,i ndryshuar me vendimin nr.15, datë 15.03.2007, nr.33, viti 2010 dhe nr.35 viti 2011.

Ndikimi/efekti: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga H.Sh., duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Shkaku: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdor subvencionin **si të vetmin instrument** për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh. ShA. Durrës, pasi Shoqëria aktualisht ndodhet përpara një krize të mprehtë likuiditeti.

Rëndësia: Risk i lart

Rekomandimi: Që të mundësohet funksionimi i Shoqërisë dhe të mos krijohen probleme sociale me punonjësit, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëreshëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri. Shoqëria aktualisht ndodhet përpara një krize të mprehtë likuiditeti dhe që, thjeshtë të vazhdojnë punë (të mos falimentoj), do të duhet ndihmë urgjente shtetërore shtesë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

- Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.

-Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë e strukturës së flotës hekurudhore krahasuar me kërkesat e tregut duke përcaktuar numrin e lokomotivave dhe vagonëve të nevojshëm për nivelet koherente të aktivitetit.

-Organet drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa për uljen e personelit. Duhet përcaktuar një politikë e qartë e shkurtimit vjetor të personelit gjatë tre-pesë viteve të ardhshme, me plan dhe afate të qarta për arritjen e niveleve mesatare të produktivitetit të personelit, si ato të hekurudhave fqinje, si Mali i Zi, Serbia Maqedonia, Kosova etj.. Kjo politikë duhet bazuar në një parashikim të kujdesshëm të nevojave e cili do të kërkojë përditësim të rregullt.

- Ndarja e qartë e llogarive të njësisë së biznesit të mallit, njësisë së biznesit të udhëtarëve, njësisë së biznesit të menaxhimit të infrastrukturës dhe njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse, duke u dhënë mundësi njësisve ta llogarisin produktivitetin e personelit në bazë të formulave specifike për secilin aktivitet duke ofruar informacion më të saktë për vlerësimin e rezultateve të secilës njësi.

-Transportuesit hekurudhor privatë të vihen në kushte të barabarta përsa i përket licensimit, çertifikatave të nevojshme sipas përcaktimve ligjore, kapacitetit të mjeteve (lokomotiva dhe vagon), si gjendjes teknike të tyre duke u pajisur me dëshmitë përkatëse.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Viti 2018.

Për vitin 2018, Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës, subvencioni i është akorduar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar) me shkresën nr.4222.prot, datë 29/02/2017 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2018” në emërtimin “Transport hekurudhor” në vlerën 400'000'000 lekë.

Me shkresën nr.954/2 prot., datë 05.02.2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), detajimin e limitit mujor të subvencionit për vitin 2018, ja ka dërguar Degës ë Thesarit Durrës dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke e klasifikuar në llogarinë ekonomike 6029999 dhe të ndarë konkretisht për muajin janar-korrik 2018 me 35,000,000 lekë në muaj dhe gusht-dhjetor me 31,000,000 lekë në muaj. Në fakt në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, llogaria 6029999 nuk ekziston, ndofta lapsus, ekziston llogaria 602 “Shpenzime të tjera operative” me nënstrukturë 6029099 “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative”. Në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, për subvencionin ekziston ekziston llogaria 6030 “Subvencione për diferencë çmimi” dhe konkretisht llogaria 6030005 “Subvencione për transport hekurudhor”.

Për periudhën 01.01-31.12.2018 subvencioni paraqitet sipas urdhër shpenzimeve si më poshtë :

1. Urdhër-shpenzimi nr.1, datë 23.01.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
2. Urdhër-shpenzimi nr.2, datë 08.02.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
3. Urdhër-shpenzimi nr.5, datë 08.03.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
4. Urdhër-shpenzimi nr.8, datë 04.04.2018, me vlerë 35,000,000 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

5. Urdhër-shpenzimi nr.10, datë 08.05.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
6. Urdhër-shpenzimi nr.13, datë 05.06.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
7. Urdhër-shpenzimi nr.14, datë 05.07.2018, me vlerë 35,000,000 lekë
8. Urdhër-shpenzimi nr.16, datë 06.08.2018, me vlerë 31,000,000 lekë
9. Urdhër-shpenzimi nr.17, datë 04.09.2018, me vlerë 31,000,000 lekë
10. Urdhër-shpenzimi nr.18, datë 03.10.2018, me vlerë 31,000,000 lekë
11. Urdhër-shpenzimi nr.27, datë 05.11.2018, me vlerë 31,000,000 lekë
12. Urdhër-shpenzimi nr.31, datë 04.12.2018, me vlerë 31,000,000 lekë

Shuma totale për vitin 2018 është në vlerën 400,000,000 lekë

Programi ekonomik për vitin 2018, është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr.4 datë 04/04/2018. Në këtë program subvencioni është përfshirë në të ardhurat për shoqërinë.

Me shkresën nr.392/2 prot., datë 18.06.2018 Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, miratimin e programit ekonomik.

Programi ekonomik është miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.6291/5 prot., datë 09/07/2018, si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.13425/1 prot., datë 20/07/2018.

Pas miratimit të programit ekonomik nga MFE, është hartuar nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE me shkresën nr.827prot., datë 25/07/2018. MIE deri më datën 31.07.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk ka kthyer asnjë përgjigje, pra kontrata për vitin 2018 nuk është nënshkruar.

Zbatimi i përdorimit të fondit të akorduar për subvencion

Urdhër Shpenzimet, janë firmosur nga Administratori dhe A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë Ekonomike, si dhe nëpunësi i thesarit. Në urdhër shpenzimet subvencionet janë klasifikuar në numrin e llogarisë 6030005 “Subvencione për transport hekurudhor” dhe jo në llogarinë ekonomike 6029999 të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.954/2 prot., datë 05.02.2018, që në fakt në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, llogaria 6029999 nuk ekziston, ndofta lapsus, ekziston llogaria 602 “Shpenzime të tjera operative” me nënstrukturë 6029099 “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative”. Urdhër shpenzimet janë shoqëruar me situacion drejtuar degës thesarit, situacion i cili është legalizuar me vulë nga Dega e Thesarit Durrës.

Ky situacion është në kundërshtim me strukturën e shpenzimeve të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.954/2 prot., datë 05.02.2018, që në fakt llogaria ekonomike 6029099, ka të përcaktuar “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative”, pra nuk ka paga, sigurime shoqërore, amortizim, kuot pjesëmarrje amortizim, taksa e infrastrukturës, shpenzime administrative etj.

Në urdhër-shpenzime është përcaktuar përfituesi H.Sh. me nipt J61811547D dhe numri i llogarisë ku do xhirohen fondet 0001003673 pra llogarisë së drejtorisë së përgjithshme. Në këto kushte dhe situacioni duhej të ishte hartuar dhe firmosur(nënshkruar) nga Drejtoria e Përgjithshme dhe jo nga Njësia e Biznesit të Udhëtarit.

Pra vet Drejtoria e Thesarit Durrës, nuk ka zbatuar shkresën nr.954/2 prot, datë 05.02.2018 të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit) për tu zbatuar nga Dega e Thesarit Durrës. Njëkohësisht edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtorja e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), edhe pse është vënë në dijeni të kësaj shkrese edhe pse është kërkuar nënshkrimi i marrëveshjes nga H.Sh., jo vetëm nuk e ka nënshkruar, por dhe as e ka refuzuar këtë marrëveshje .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Në bazë të vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.8, datë 02.02.2007, detyrohet Ministria e Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe H.Sh. ShA., të lidhin kontratën për subvencionin, si dhe të kryejnë llogaritjen e saktë të vlerës që H.Sh. mund të përfitojë për të ofruar këtë shërbim publik. Në këtë vendime përcaktohet gjithashtu se në rast se nuk do të kompensohet e gjithë shuma e nevojshme për ofrimin e shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, atëherë të lejohet H.Sh. të përshtatë tarifën për vlerën e pambuluar nga subvencionin.

Më pas Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me vendimin nr.15, datë 15.03.2007, e lë në fuqi Vendimin nr.8, datë 02.02.2007 dhe gjithashtu përcakton se në rast moszbatimi të këtij vendimi nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe H.Sh. ShA., Komisioni i Ndihmës Shtetërore është i detyruar të fillojë procedurat për ndihmën e paligjshme dhe H.Sh. ShA., Durrës detyrohet të kthejë të gjithë vlerën e subvencionit të marrë, së bashku me interesat.

Në opinionin e grupit të auditimit Emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 58 të nënit 5 të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet përkufizimi i rrjetit hekurudhor konkretisht: *“Rrjet” janë linjat, stacionet, terminalët dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.* Pra rrjeti nuk është veprimtari (subjekt) por objekt.

Referuar sa mësipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuzë dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga H.Sh., duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore, duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga 400,000,000 lekë të subvencionuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2018 +1,103,450 gjendje fillestare etj, vlera 401,103,451 lekë nuk është përdorur për subvencion, por është përdorur për paga në vlerën 313,004,435 lekë, sigurime shoqërore+shëndetësore në vlerën 87,502,840 lekë dhe shpenzime përmbartimore në vlerën 596,176, lekë, nuk është për biznesin e mallit, por për të gjithë hekurudhën, pra është ndërruar destinacioni i dhënë nga vetë Ministria e Ekonomisë dhe Financave, i miratuar për shpenzim (ndrim destinacioni), po nga vet Ministria e Ekonomisë dhe Financave në cilësinë e Aksionerit të kësaj Shoqërie. Pra, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka çel fondin e subvencionit dhe po ajo nëpërmjet Degës së Thesarit Durrës e ka kontrolluar përdorimin e këtij fondi.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.8, datë 02.02.2007, i ndryshuar me vendimin nr.15, datë 15.03.2007, nr.33, viti 2010 dhe nr.35 viti 2011.

Për pasojë vlera 400,000,000 lekë përbën shkelje të disiplinës buxhetore, çka ngarkon me përgjegjësi Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorinë e Përgjithshme e Thesarit), Degën e Thesarit Durrës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtorinë e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), dhe për Hekurudhën Shqiptare A.H. me detyrë Drejtues i Njësisë ekonomike dhe P.T. me detyrë Drejtues i Njësisë së biznesit të udhëtarit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Pavarësisht shkeljes së dispozitave ligjore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer me qëllim të drejtpërdrejt për shlyerjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore të punonjësve të Hekurudhës Shqiptar

Për vitin 2019

Për vitin 2019, subvencioni është dërguar nga MIE me shkresën nr.15503/4 prot., datë 17/01/2019 me objekt “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2019, për shpenzimet korrente. Në adresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me emërtimin “Rrjet hekurudhor i subvencionuar”, si dhe me shkresën nr.761/4, datë 22.02.2019.

Programi ekonomik financiar për vitin 2019, është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.1 datë 10/01/2019.

Me shkresën nr.31 prot., datë 11/01/2019 i është dërguar MIE për miratim, e cila nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

Është ridërguar përsëri me shkresën nr.31/1 prot., datë 21/02/2019, përsëri asnjë reagim.

Ridërgohet përsëri me shkresën nr.31/3.prot, datë 17/04/2019, përsëri asnjë reagim nga MIE.

MFE kërkon me shkresën nr.7810 prot., datë 26/04/2019, Shoqërisë “H.Sh.” ShA. dorëzimin e programit ekonomik për miratim. Hekurudha i shpjegon arsyet e vonesës duke theksuar se nuk ka ardhur miratimi nga MIE.

MFE me shkresën nr.8344/1 prot., datë 10/05/2019 i kërkon MIE-s, të bëjë miratimin e programit ekonomik të Shoqërisë “H.Sh.” ShA.. Këtë shkresë e dërgon për dijeni edhe pranë H.Sh. ShA..

Përsëri duke u nisur nga shkresa e MFE me shkresën nr.31/3prot., datë 06/05/2019, Shoqëria “H.Sh.” ShA. i kërkon në MIE miratimin e programit ekonomik. Ky miratim ende nuk ka ardhur. Pra H.Sh. për periudhën 01.01-31.07.2019, nuk ka program të miratuar nga MIE dhe MFE.

Edhe pse programi ekonomik nuk është miratuar nga MIE dhe MFE është hartuar nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE me shkresën nr.136 prot., datë 31/10/2019. MIE deri më datën 31.07.2019 datë në të cilën përfundoj auditimi nuk ka kthyer asnjë përgjigje, pra kontrata për vitin 2019, nuk është nënshkruar.

Për periudhën 01.01-31.05.2019 subvencionit paraqitet sipas urdhër shpenzimeve si më poshtë

1. Urdhër-shpenzimi nr.1, datë 16.01.2019, me vlerë 33,000,000 lekë
2. Urdhër-shpenzimi nr.7, datë 06.02.2019, me vlerë 33,000,000 lekë
3. Urdhër-shpenzimi nr.10, datë 04.03.2019, me vlerë 34,000,000 lekë
4. Urdhër-shpenzimi nr.12, datë 03.04.2019, me vlerë 33,000,000 lekë
5. Urdhër-shpenzimi nr.16, datë 06.05.2019, me vlerë 33,000,000 lekë

Shuma totale për 5-mujorin e vitit 2019 është në vlerën 166,000,000 lekë.

Nga 166,000,000 lekë të subvencionuar nga Buxheti i Shtetit për 5-mujorin 2019 +100,108 lekë gjendje fillestar etj, vlera 166,100,108 lekë nuk është përdorur për subvencion, por është përdorur për paga në vlerën 131,924,475 lekë, sigurime shoqërore+shëndetësore në vlerën 34,175,633 lekë, pra është ndërruar destinacioni i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Përdorimi dhe raportimi i subvencionit është bërë identik siç është pasqyruar në vitin 2018

Për pos sa trajtuar sa më sipër.

Duke u zhveshur subvencionit si e ardhur e shoqërisë, humbjet janë thelluar për vitin 2016,2017,2018 dhe program 2019 respektivisht në vlerat 928.914 mijë lekë, 817,365 mijë lekë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

827,239 mijë lekë dhe 623,260 mijë lekë, nga 538,914 mijë lekë, 417,365 mijë lekë, 527,239 mijë lekë dhe 223,260 mijë lekë respektivisht për vitet 2016,2017,2018 dhe program 2019. Në mënyrë të detajuar tabela si më poshtë vijon.

VITI	Në 000/ lekë			
	2016/Fakt	2017/Fakt	2018/Fakt	2019/Programi
TE ARDHURA	566,778	939,533	719,642	1,124,470
SHPENZIME	1,105,692	1,356,898	1,246,881	1,347,730
REZULTATI	(538,914)	(417,365)	(527,239)	(223,260)

*Tabela 12 Programi ekonomik dhe realizimi
Burimi i të dhënave H.Sh.*

Ndërsa e zhveshur nga subvencioni paraqitet si më poshtë

VITI	000/ lekë			
	2016/Fakt	2017/Fakt	2018/Fakt	2019/Programi
TE ARDHURA	176,778	539,533	319,642	724,470
SHPENZIME	1,105,692	1,356,898	1,246,881	1,347,730
REZULTATI	(928,914)	(817,365)	(927,239)	(623,260)

*Tabela 13 Programi ekonomik dhe realizimi zhveshur nga subvencioni
Burimi i të dhënave H.Sh.*

Referuar sa më sipër Ecuria e treguesve ekonomik-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron **qartazi paaftësi likuiduese** të Shoqërisë “H.Sh.”. Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principlial dhe interesa, fatura për blerje etj, në vlerën 1,895,812 mijë lekë .

Në opinionin e grupit të auditimit se

Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, jo vetëm është në gjendjen e paaftësisë paguese, por është plotësisht e falimentuar.

Më datë 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat: Raiffeisen Bank (7 numra llogarie), ABI Bank (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhra sekuestro, Banka Kombëtare Tregtare (11 numra llogarie) me të njëjtët urdhra sekuestro, Banka Credins (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Pro Credit Bank (1 numër llogarie), Fibank (2 numër llogarie), Alpha Bank (2 numër llogarie), Union Bank (2 numër llogarie), Tirana Bank (1 numër llogarie), Intesa San Paulo (5 numra llogarie) Veneto Bank (1 numër llogarie), Societe Generale (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra llogarie me urdhra sekuestro nr 11 në vlerën totale 44.938.145 lekë .

Referuar sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdor subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh. ShA. Durrës.

Përpos sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk i është dhënë vëmendja e duhur në investime shtetërore, që s’duhet ti mungonin si e vetmja shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtareve, ashtu siç i jepen infrastrukturës automobilistike.

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot, datë 20.06.2018, ka çuar për indicie për ndjekje penale për përdorimin e subveconit për vitin 2017, në prokurorinë e rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Aplit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr (11-2019-1312)309 datë 06.03.2019 të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe **pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale** nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURREËS

Opinion i grupit të auditimit është se “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë e kanë përdor subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.”, kjo përforcohet edhe për sa më poshtë vijon

-Gjendja e Infrastrukturës hekurudhore.

Rrjeti hekurudhor Shqiptar që nga ndërtimi tij është realizuar vetëm me përdorimin në mënyrë manuale të makinerive, kështu shpejtësia e lëvizjes së mjeteve hekurudhore, nuk e ka kaluar nivelin e shpejtësisë 55 km/ore për trenat e udhëtarëve dhe 45 km/ore për trenat e mallit.

Rrjeti Hekurudhor Shqiptar që nga ndërtimi i tij dhe deri më 31.07.2019 (datë në të cilën përfundon auditimi), asnjëherë nuk i është nënshtruar një riK.i total të superstrukturës së saj.

Në Shqipëri kanë munguar si dhe mungojnë edhe sot, shoqëri të specializuara për riK.in i infrastrukturës hekurudhore.

Gjendja e elementeve të superstrukturës të krejt sistemit hekurudhor në Shqipëri është me tregues të ulët teknik, çka ka sjellë që shpejtësia aktuale e lëvizjes së trenave në hekurudhore, të jetë 35 deri në 40km/ore dhe në zona të veçanta 10 deri në 15 km/orë.

Burimi i informacionit H.Sh., VKM nr.811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020.

-Sinjalizimi dhe Ndërlidhja në rrjetin hekurudhor Shqiptar.

Në vitin 1980 në rreth 30% të rrjetit hekurudhor shqiptar u implementua sistemi elektrik i sinjalizim- ndërlidhjes, i kontrollit dhe i komandimit të lëvizjes trenave, sipas modelit gjermano-lindor.

Aktualisht ky sistem sot është komplet jashtë përdorimit.

Si rrjedhim transporti hekurudhor konsiderohet se nuk ka një sistem qendror të menaxhimit të lëvizjes të trenave, si dhe nuk ka një kontroll fiks, funksional dhe të sigurt të lëvizjes të këtyre trenave.

Operacioni i lëvizjes të trenave midis stacioneve kryhet me radio, duke u kontrolluar dhe orientuar nga Dispečeria Qendrore.

Lëvizja e trenave nga njeri stacion në tjetrin sigurohet në marrëdhënien e inspektorit të stacionit me mashinistin e lokomotivës, nëpërmjet lëshimit nga ana e inspektorit të stacionit të një letre pranim – nisje për mashinistin sipas drejtimit të lëvizjes të trenit.

Kjo sistem i tillë është një rrezik prezent dhe nuk është aspak i sigurt dhe humb shumë kohë për përshkrimin e distancës hekurudhore.

Burimi i informacionit H.Sh., VKM nr.811, datë 16.11.2016 “Per miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020.

-Mjetet tërheqëse dhe të transportit.

Tërheqja e mjeteve hekurudhore të transportit të mallrave dhe atyre të udhëtarëve realizohet me lokomotiva të tipit diezel elektrik me naftë CKD T 669, të prodhimit çek të viteve 1980, të cilat kanë një kapacitet tërheqës 1340 kuaj fuqi (kf) ose 993 kilovat (Kv), peshojnë 117 ton, kanë shpejtësi të projektuar deri në 90 km/orë dhe në tërheqjen e trenave të mallit këto lokomotiva me gjendjen e tyre teknike që kanë sot, mund të tërheqin deri në 1000 ton mallra bruto. Një gjendje e tillë ka ardhur si pasojë e mungesës totale të riparimeve kapitale apo të mesme për gjatë një periudhe 25 vjeçare duke filluar nga viti 1992.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA Durrës

Një arsye tjetër e gjendjes të rëndë teknike të lokomotivave është edhe mungesa e pjese të këmbimit dhe e agregateve të tyre, pasi ndërtimi konstruktiv i këtyre lokomotiva është e një teknologjie të vjetër dhe tipi i tyre pothuajse po shkon drejt zhdukjes.

Gjithsej për realizimin e tërheqjes se trenave të udhëtarëve dhe të mallit janë 21 lokomotiva nga të cilat 9 për transportin e trenave të udhëtarëve dhe 12 për transportin e trenave të mallit.

Në transportin e trenave të udhëtarëve përdorimi i këtyre lokomotivave është shumë i kushtueshëm dhe aspak ekonomik, pasi fuqia tërheqëse e tyre deri në 1000 ton nuk i përgjigjet numrit dhe peshës të vagonëve që ato tërheqin që është maksimalisht deri në 120 ton ose dy - tre vagonë.

Burimi i informacionit H.Sh., VKM nr.811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020.

-Transporti mallrave.

Treguesit ekonomik.

Sasia e mallrave të transportuar me hekurudhë dhe të ardhurat në vitet e fundit janë :

Viti 2013	‘	150.500	ton.	153,2	milion lekë.
Viti 2014	‘	338.000	ton	269,4	milion lekë.
Viti 2015	;	197.772	ton.	161.3	milion lekë
Viti 2016	‘	75.632	ton	65.6	milion lekë
Viti 2017		149.999	ton	155.5	milion lekë.
Viti 2018		198.900	ton	142.9	milion lekë.

Për realizimin e trafikut të brendshëm të mallrave në dispozicionin të Njesisë të Biznesit të Mallrave janë 7 lokomotiva diesel dhe rreth 40 vagonë, te inventarit të H.Sh..

Transport ndërkombëtar i mallrave nga Evropa në drejtim të rrjetit hekurudhor Shqiptar kryhet me vagonë të huaj të siguruara nga spedicioneret që kryejnë këtë transporti në drejtim të Shqipërisë.

Vagonët hekurudhore shqiptare të mallrave dhe të udhëtarëve, nuk plotësojnë kërkesat e rregullores për përdorimin e përbashkët të vagonëve të mallrave në transportin ndërkombëtar hekurudhor RIV, dhe si të tillë nuk mund të lëvizin jashtë rrjetit hekurudhor shqiptar.

Nëpërmjet stacionit kufitar të Bajzës, nga Evropa në drejtim të Shqipërisë, transportohen mallra për ndërmarrjet industriale në stacionin Vidhas të Elbasanit si, skrap, qymyr koks, elektroda etj.

Në stacionin e Vorës dhe të Sukthit, transportohen dhe shkarkohen mallra ushqimore si sheqer, vaj, si dhe mallra industriale.

Vendet transportuese janë Serbia, Bosnja Hercegovina, Hungaria, Kroacia, Sllovenia.

Transporti i mallrave nga jashtë përbën strukturën kryesore të transportit, dhe në këtë strukturë transporti i hekurit për skrap për llogari të shoqërisë K. përbën rreth 75% të sasisë të përgjithshme të transportuar në transportin ndërkombëtar.

Me vagonë të inventarit të H.Sh. realizohet transporti i brendshëm i mallrave në rrjetin hekurudhor shqiptar, ne veçanti të mallrave që hyjnë dhe dalin nga Porti i Durrësit për llogari të Biznesit Vendas dhe të huaj, kryesisht në drejtimin Port – Metalurgji dhe në drejtimin Metalurgji – Port që është prodhim i gatshëm i Metalurgjikut - hekur prokat.

Aktualisht sasia e mallrave të transportit të brendshëm është në sasinë 1/3 e trafikut vjetor të mallrave.

Burimi i informacionit H.Sh., VKM nr.811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Transporti udhëtarëve.

H.Sh. kryhen vetëm transport kombëtar të udhëtarëve brenda rrjetit hekurudhor shqiptar dhe nuk kryhen transport ndërkombëtar të udhëtarëve.

Stacionet kryesore të udhëtarëve janë ai i Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Lezhës dhe Laçit.

Linja hekurudhore që ka me shumë trafik të udhëtarëve është ajo e drejtimit Shkodër – Lezhë – Laç.

Segmenti hekurudhor Librazhd – Pogradec i pjesës jug – lindore të Shqipëri me gjatësi 52 km, është i bllokuar në vitin 2011, për lëvizjen e trenave për shkak të gjendjes të rëndë teknike të superstrukturës të tij.

Në inventarin e Njesisë të Transportit të Udhëtarëve janë gjithsej 34 vagonë të tipit Italian dhe Gjerman të cilët kanë qenë të përdorur në rrjetin hekurudhor Evropian dhe pasi janë rikonstruktuar më parë në Itali dhe Gjermani, janë blerë dhe importuar në Shqipëri.

Numri i udhëtarëve të transportuar me hekurudhë dhe të ardhurat në tre vitet e fundit janë si më poshtë :

Viti 2013	329.080	persona	14.5	milion lekë
Viti 2014	186.600	persona	10.7	milion lekë
Viti 2015	189.710	persona	9.9	milion lekë
Viti 2016	86.700	persona	5.2	milion lekë
Viti 2017	66.000	persona	3.12	milion lekë.
viti 2018	75.880	persona	4.22	milion lekë

Siç shikohet ka një ulje të të ardhurave nga transporti i udhëtarëve nga viti 2013 pasi, trenat e udhëtarëve janë mjaft të ngadaltë, vagonët e udhëtarëve përjashtuar 12 copë të prodhimit gjerman e kanë komfortin të një cilësie shumë të dobët, si dhe nuk janë adekuat për tregun e sotëm të transportit publik, pasi janë shumë të vjetër.

Koha e udhëtimit me tren e udhëtarëve midis qyteteve është tepër e lartë dhe qytetarët në këto kushte preferojnë shërbimin e transportit rrugor ndaj atij hekurudhor edhe pse kostoja e biletës të transportit me tren është rreth 50% më e ulët se ajo me auto.

Godinat e stacioneve janë të atilla që shërbimet ndaj udhëtarëve nuk pasqyrojnë ndryshimet që kanë ndodhur në Shqipëri.

Ulja drastike të numrit të udhëtarëve me hekurudhë ka filluar në 2013, dhe ka ardhur si shkak i mbylljes së aktivitetit të stacionit hekurudhor të Tiranës.

Burimi i informacionit H.Sh., VKM nr.811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020.

11. Hartimi, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre.

1.Titulli i gjetjes: Mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare.

Situata: Nga auditimi është konstatuar mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që H.Sh., ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve,.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Janë kontabilizuar vetëm principli mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësive dhe jo penalitetet.

- Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro.

- UIC (International union of railëays) dhe SK (serbia cargon) kanë organizuar në 18/09/2018 forumet e debitorëve/kreditorëve, për të cilat janë kërkuar borxhet e hekurudhave të Byroja e borxheve (Beograd Serbi).

Ministria përgjegjëse merr përsipër administrimin e borxhit sipas Neni 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”. Në referencë me nenin 12.4 të ligjit të sipërpërmendur, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar (të përlllogaritur) deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji. Për këtë qëllim, H.Sh. ka dorëzuar bilancet (31.12.2017) në formë zyrtare pranë Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë, duke përfshirë çështjet e transportit hekurudhor dhe pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si aksionere e vetme e kësaj shoqërie. Deri më datë 31.07.2019, datë në të cilin përfundoj auditimi, borxhet ndaj hekurudha të huaja rëndojnë mbi hekurudhën shqiptare (janë në kontabilitetin e kësaj shoqërie). Nuk ka asnjë veprim konkret, nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kriteri: Neni 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.

Ndikimi/efekti: Mos likuidimi për një kohe të gjatë, ka ndikuar dhe në performancën e H.Sh. ndaj Hekurudhave të Huaja, problem ky i cili është ngritur në forumet ndërkombëtare hekurudhore (Byroja e borxheve, Beograd Serbi) në datën 18/09/2019. Hekurudhat Bullgare, Polake apo Gjermane, kanë filluar të refuzojnë nisjen e mallrave nga importi me origjinë nga vendet e tyre me vagonët e tyre.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Rëndësia: Risk i lart

Rekomandimi: Nga organet drejtuese të shoqërisë ti kërkohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit), si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Ministria monitoruese dhe e hartimit të politikave), rregullimin dhe administrimin e vlerës 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro që përfaqëson detyrimin që Shoqëria “H.Sh.” SHA. ka ndaj Hekurudhave të Huaja, në zbatim të nenit 12, pika 4 i ligjit 142 dt 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.

2.Titulli i gjetjes: Mos përkthim në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor).

Situata: Përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) është bërë pjesërisht nga punonjësit e H.Sh.. Përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, deri në 31.07.2019 datë në të cilën përfundon auditimi, nuk është bërë e qartë nga punonjësit mënyra e llogaritjes. Përfshirja në kontabilitet ka ndikuar direkt në rezultatin financiar, duke krijuar vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet H.Sh. ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

Kriteri: Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve (RIV) dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Ndikimi/efekti: Paqartësi dhe vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet HSH-së ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga Sektori i Marketingut dhe specialisti i mardhënijeve me jashtë i kësaj shoqërie.

Rëndësia: Risk i mesëm.

Rekomandimi: Të merren masa nga Sektori i Marketingut dhe specialisti i mardhënijeve me jashtë, për kompletimin e dokumentacionit të transportit ndërkombëtar të mallrave, me aktet e rregullores RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të kryhen veprimet financiare dhe kontabël, dhe tu vihet në dispozicion punonjësve që merren me zbatimin e këtyre kërkesave ligjore

3.Titulli i gjetjes: Përgjithësisht kontratat e lidhura me transportuesit hekurudhor nuk janë plotësuar me të gjitha gjenalitet konformë kodit civil dhe librit tarifor (Ato nuk kanë të përcaktuar afatin, sasinë, distancë dhe tarifën).

Situata: Për vitin 2018 për transportin e mallrave nga Nj.M.B janë lidhur 9 kontrata Konkretisht:
1. Kontrata me P. lidhur me 27/09/018 sasia 500 ton, në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 2. Kontrata me A. lidhur me 01/03/2019, nuk përcakton afat, për sasinë 100 ton në të cilën nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 3. Kontrata me M. Konst lidhur me 21/05/2018 nuk përcakton afat për sasinë 12000 ton. 4. Kontrata me A. lidhur me 19/01/018 sasia 20.000,ku përcakton distancë dhe tarifën për ton/km. 5. Kontrata me K. lidhur me 22/02/2018 për sasinë 40000 ton, nuk përcakton tarifë transporti. Me datë 02/05/2018 është amenduar. 6. Kontrata me M.-2 lidhur me datë 18/01/2018 sasia 80.000-100.000 ton, nuk përcakton tarifë me afat deri më 31/12/2018 (kjo kompani është tërhequr ka prishur në mënyrë të njëanshme kontratën, por nuk aplikuar penalitet, pasi kontrata nuk e ka të përcaktuar penalitet). 7. Kontrata me pansped lidhur me 25/01/2018 me afat deri më 31/12/2018 sasia 10.000-15.000, nuk ak përcaktuar distancë dhe tarifë (nuk ka të bashkëngjitur librin tarifor). 8. Kontrata me Misped lidhur me 12/01/2018, nuk ka të përcaktuar afat, sasi, distancë dhe tarifë. 9. Kontrata me 16 February lidhur me 12/12/018 me afat 31/12/2018 pa përcaktuar sasi, distancë dhe tarifë.

Për vitin 2019 janë lidhur 3 kontrata me M. 2 data e lidhjes së kontratës 15/01/019, sasia 80.000-100.000 ton, por pa bashkëngjitur tarifën sipas librit tarifor, me Milsped datë e lidhjes së kontratës 01/02/2019 pa sasi dhe distancë dhe me 16 February datë e lidhjes kontratës 02/03/2019 sasia 30.000-70,000 ton, pa përcaktuar destinacionin.

Kriteri: Libri Tarifor i miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.3 dt 27/03/2019 “Për miratimin e tarifave të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave”.

Ndikimi/efekti: Krijimi i një situatë konfuze dhe të paqartë në llogaritje e detyrimeve që kanë transportuesit hekurudhor ndaj hekurudhës shqiptare.

Shkaku: Mos vlerësimi sa dhe sic duhet nga sektori juridik, ekonomik dhe njësia e biznesit të mallit.

Rëndësia: Risk i lart

Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të merret masat që kontratat me transportuesit hekurudhor për përdorimin e rrjetit hekurudhor të maksimalizojnë jo vetëm zbatimin e tarifave në fuqi, por dhe të mos cënohet qëndrueshmëria dhe aftësia konkurruese e transportit hekurudhor të mallrave.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH A DURRËS

Njësia e Biznesit të Mallit (NjBM), ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj transportin e mallrave në rrjetin hekurudhor shqiptar me operatorë vendas dhe të huaj, sipas kontratave në përputhje me programet e miratuara. NjBM funksionon në bazë të Rregullores së brendshme (neni 23-30), miratuar me vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhës (D.P.H) nr.40/24, datë 31.12.2009, dhe në rregulloren e re miratuar me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr.17 dt 13/11/2018 (neni 62-87).

H.Sh. operon me 14 hekurudha të huaja, konkretisht me Hekurudhën Sllovake, Sllovene, Bullgare, Rumune, Polake, Gjermane, Austriake, Hungareze, Gysev, Çeke, Kroate, Serbe, Bosnje Hercegovinë dhe të Malit të Zi.

H.Sh. është anëtare e UIC-it (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor), e për pasojë zbaton të gjitha rregulloret Hekurudhore Ndërkombëtare, të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet rrjeteve hekurudhore Evropiane në aspektet kryesore të veprimtarisë së tyre, siç janë:

AIM – Marrëveshje mbi transportin ndërkombëtar të mallrave me hekurudhë.

CIM – Rregulla uniforme të marrëveshjes së transportit ndërkombëtar të mallrave me hekurudhë.

PIM – Rregullat mbi transportin ndërkombëtar të mallrave.

RID – Rregullorja mbi transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshëm.

RIV – Marrëveshja mbi shkëmbimin dhe shfrytëzimin e vagonëve të mallrave ndërmjet ndërmarrjeve hekurudhore.

Aneksi II RIV – Rregullat mbi ngarkimin e vagonëve të mallit, si dhe të UIC-it me rregulla më të detajuara për probleme të ndryshme të rregulloreve të mësipërme.

Transporti ndërkombëtar i mallrave të ndryshëm si skrap, qymyr (koks), sheqer, grurë etj, bëhet mbi bazën e kontratave që lidhen me klientë të ndryshëm duke respektuar tarifat e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë HSH ShA. Durrës.

Ndjekja dhe realizimi i transportit ndërkombëtar bëhet në dy forma:

-Nëpërmjet spedicionerëve hekurudhor (Pansped-Serbi, 16 Februar-Mali Zi,M.-2 dhe Milsped albania) me të cilët HSH ka lidhur kontratat përkatëse, ku këta spedicionerët kanë marrë përsipër likuidimin e detyrimeve të transportit për llogari të pritësit të mallit për destinacionin Stacioni kufitar Bajzë – stacioni hekurudhor pritës.

-Nëpërmjet vetë subjekteve të ndryshme, të cilët paguajnë detyrimet e transportit për relacionin Stacioni Bajzë.

Transporti bëhet duke përdorur vagonët e hekurudhave të huaja nëpërmjet vijës hekurudhore kufitare Bajzë-Tuz, e cila është vija e kalimit kufitar Shqipëri-Mal i Zi. Në zbatim të VKM nr.426, datë 28.06.2006 *“Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për organizimin e trafikut të kufitar hekurudhor ndërmjet të dy vendeve”*, dorëzimi dhe marrja në ngarkim e vagonëve të mallrave, dokumenteve, kontenierëve, paletave dhe pajisjeve të ngarkimit bëhet në stacionin e ndërrimit, midis personelit të shërbimit hekurudhor të stacionit të ndërrimit, sipas dispozitave ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje: *“Konventa mbi Transportin Hekurudhor Ndërkombëtar (COTIF)”* dhe *“Marrëveshja mbi Shkëmbimin dhe Shfrytëzimin e Vagonëve të Mallrave ndërmjet Ndërmarrjeve Hekurudhore (RIV)”*. Në përgjithësi likuidimi i faturave të transportit të mallrave nga klientët bëhet sipas kushteve të kontratës.

Në fund të çdo muaji, Stacioni Hekurudhor Bajzë depoziton pranë NjBM evidencën e hyrje-daljeve të vagonëve të huaj duke regjistruar numrin e vagonëve, llojin e mallrave, datën dhe orën e hyrjes, datën dhe orën e daljes së vagonëve. Të dhënat regjistrohen mbi bazën e listë-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH A DURRËS

kalimit të vagonëve që përpilohet nga personeli komercial, respektivisht i stacioneve Bajzë dhe Tuz, që nënshkruhet nga të dyja palët. Ky veprim faktori dokumentimin e hyrje-daljeve të vagonëve që bëjnë transportin e mallit në territorin shqiptar. Evidenca e hyrje daljes të vagonëve kontrollohet në fund të çdo muaji nga dega e kontrollit të trafikut dhe marketingut.

-H.Sh. nuk ka shlyer detyrimet e prapambetura për përdorimin e vagonëve në pronësi të hekurudhave të huaja. Mos likuidimi ndaj hekurudhave të huaja, ka shkaktuar penalitete në dëm të shoqërisë, duke bërë që detyrimet të rriten vazhdimisht, pasi hekurudhat e huaja, në zbatim të kapitullit 3.5, pika 91.3 të RIV, kanë aplikuar kamatëvonesa për shkak të mos likuidimit të detyrimeve financiare. Nga hekurudhat e huaja vijnë vazhdimisht fatura në lidhje me dëmshpërblimin për kamatëvonesat që rezultojnë nga mos likuidimi i detyrimeve të prapambetura të HSH-së. Mos shlyerja e këtyre detyrimeve përbën një problem kryesor të aktivitetit të H.Sh..

Detyrimet e HSH-së ndaj hekurudhave të huaja “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin shqiptar” paraqitet si më poshtë:

Tabela 1

Emërtimi	Detyrim viti 2018	Detyrim 5-mujori viti 2019	Totali në euro për periudhën 2009- 5-mujori 2019
Hekurudha Rumune	-		13.606.30
Hekurudha Sllovaqe	3.848.21	619.94	46.098.92
Hekurudha Sllovene	262.69		18.951.00
Hekurudha e Malit të Zi	1.283.07	2.604.12	91.241.01
Hekurudha Kroate	2.809.63	161.25	104.689.48
Hekurudha Gjermane			222.30
Hekurudha Çeke	3.058.88		13.480.41
Hekurudha Austriake	879.36	4.654.32	196.836.92
Hekurudha Hungareze	12.176		228.063.42
Hekurudha Serbe	59.943.6	40.931.46	816.012.24
Hekurudha Bullgare	-		55.376.00
Hekurudha e Bosnje Hercegovinës	15.431.31	7.777.47	169.115.52
Hekurudha Gysev (Hungari)	276.36	121.26	11.261.90
Polake	5.241.61		8.162.08
Hekurudha Serbe Detyrim për dëmtim vagoni			14.744.95
Total	105.110.72	56.869.82	1.787.862.45

Tabela 14 Detyrimet e HSH-së ndaj hekurudhave të huaja për orë qëndrimet e vagonëve në territorin shqiptar
Burimi i të dhënave “H.Sh.”

Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr 8, datë 01/07/2016, ka miratuar tarifat e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të përcaktuara në “Librin Tarifor”, të cilat kanë ndryshuar me vendim Këshilli Mbikëqyrës nr.3 dt 27/03/2019 “Për miratimin e tarifave të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të përcaktuara në “Librin Tarifor”. Sipas Librit Tarifor të transportit të mallrave, llogaritja e shpenzimeve për transportin kryhet mbi bazën e llojit të mallit (klasës tarifore), sasisë së dërgesës, llojit të vagonëve (vagonë në pronësi të hekurudhave të huaja, vagonë privat apo të marrë me qira), si dhe distancave të transportit. Tarifat e transportit të mallrave janë përcaktuar dhe në kontratat e lidhura midis NjBM-së dhe klientëve. Deklarimet tatimore të TVSH në librin e shitjeve mujore bëhen mbi bazën e faturave tatimore të lëshuara për efekt parapagimi.

Në transportin ndërkombëtar të mallrave, zbatohet parapagimi i detyrimeve që rrjedhin. Me arkëtimin e parapagimeve, të cilat bëhen sipas kërkesës së klientëve me e-mail, në periudha të ndryshme, lëshohen fatura tatimore për parapagim transport malli, për sasi të e volumeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHa DURRËS

mallrave që pritet të realizohen. Në momentin që ngarkesat hekurudhore hyjnë në territorin shqiptar, hartohet një faturë e dytë tatimore për ngarkesën faktike për çdo dërgesë. Në faturën e dytë tatimore që lëshohet për klientin, për çdo rast kur është kryer parapagimi, zbriten vlerat e faturave tatimore sipas numrit të faturës të parapaguar. Faturat tatimore, të lëshuara për të dytën herë për çdo ngarkesë, raportohen me vlerën zero në librin e shitjeve mujore, për shkak se është raportuar në faturën tatimore parapagim të lëshuar më parë.

Nga auditimi u konstatuan problemet si më poshtë:

-Mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaja, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për HSH. Detyrimet që H.Sh. ka ndaj hekurudha të tjera “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e H.Sh.”.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që H.Sh. ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve, penalitete të cilat si rrjedhojë e mos llogaritjes nuk janë kontabilizuar, por është kontabilizuar vetëm principli. Principli është kontabilizuar mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë. Çka do të thotë që vlera totale ndaj hekurudha të tjera është më e madhe.

Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” SHA ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” SHA ndaj hekurudhave të Huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro.

UIC(International union of railways) dhe SK(serbia cargon) kanë organizuar në 18/09/2018 forumet e debitorëve/kreditorëve, për të cilat janë kërkuar borxhet e hekurudhave të Byroja e borxheve (Beograd Serbi).

Neni 12, pika 4 i ligjit 142 dt 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”, i cili ka hyrë në fuqi 1 vit pas publikimit në fletoren zyrtare me nr.265 publikuar në dt 12/01/2017 dhe dispozita përfundimtare ky ligj hyri në fuqi në datën 12.01.2018.

Në referencë me nenin 12.4 të ligjit të sipërpërmendur, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar (të përlllogaritur) deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji. Për këtë qëllim, H.Sh. ka dorëzuar bilancet (31.12.2017) në formë zyrtare pranë MIE (Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë, duke përfshirë çështjet e transportit hekurudhor) dhe pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si aksionarë e vetme e kësaj shoqërie. Deri më datë 31.07.2019, datë në të cilin përfundoj auditimi, borxhet ndaj hekurudha të huaja rëndoj mbi Hekurudhën Shqiptare (janë në kontabilitetin e kësaj shoqërie). Nuk ka asnjë veprim konkret, nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për pos më sipër;

a. Hekurudhat e huaja kanë filluar të paraqesin në Hekurudhën Shqiptare edhe detyrimin për kamate vonesat në likuidimin e detyrimeve (borxheve), si Hekurudha Mavi Hungari dhe Hekurudha Serbe SK. Shkresa e fundit nr.1/2019-3869 prot., datë 11.07.2019 drejtuar H.Sh. akoma nuk i është përcjell MIE, si Ministri përgjegjëse për transportet. Në të njëjtën kohë, HSH ka informuar me takime dhe me shkresë Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, i cili kryesohet nga drejtorja e programeve të infrastrukturës (MIE) dhe ka për anëtar përfaqësuesit e Ministrisë pronare (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) etj. Kjo hekurudhë partnere SK(Serbi Kargo) e cila kryeson Byronë e borxhit të ngritur në nivel të vendeve të Evropës Jug-Lindore me qendër në Beograd, Serbi dhe bashkë-kryesohet nga UIC Bashkimi Ndërkombëtar Hekurudhor (qendra



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

në Paris) dhe sekretariati i kësaj Byroje të borxhit për vendet e SEE (Evropës J-L) e mban MAV Hekurudha Shtetërore Hungareze, e cila nga ana e vet ka pretendimet e saj ndaj HSH.

b. Hekurudhat Bullgare, Polake apo Gjermane, kanë filluar të refuzojnë nisjen e mallrave nga importi me origjinë nga vendet e tyre me vagonët e tyre.

c. Mos likuidimi për një kohë të gjatë, ka ndikuar dhe në performancën e H.Sh. ndaj Hekurudhave të Huaja, problem ky i cili është ngritur në forumet ndërkombëtare hekurudhore (Byroja e borxheve, Beograd Serbi) në datën 18/09/2019.

-Nuk kryhet asnjë veprim financiar dhe kontabël në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë nga kamatëvonesat për orë qëndrimet e vagonëve të huaj, ndaj hekurudhave të huaja. Ky mosveprim nga ana e HSH-së, nuk krijon besueshmëri për raportimin saktë dhe të besueshëm të detyrimeve dhe rezultateve financiare, për shkak se kamatëvonesat e dërguara nga hekurudhat e huaja pranohen të mirëqena, pa bërë përlllogaritjen e penalteteve dhe përfshirjen e tyre në raportimet e pasqyrave financiare.

Përkthimi në gjuhën shqipe e marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), është bërë pjesërisht nga punonjësit e HSH, por përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, deri në 31.07.2019 datë në të cilën përfundon auditimi, nuk është e qartë nga punonjësit mënyra e llogaritjes së tyre e përfshirjes së tyre në kontabilitet duke ndikuar direkt në rezultatin financiar, pasi kjo krijon vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet HSH-së ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

Për vitin 2018 për transportin e mallrave nga Nj.M.B janë lidhur 9 kontrata Konkretisht:

1. Kontrata me P. lidhur me 27/09/018 sasia 500 ton, në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 2. Kontrata me A. lidhur me 01/03/2019, nuk përcakton afat, për sasinë 100 ton në të cilën nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 3. Kontrata me M. konst lidhur me 21/05/2018 nuk përcakton afat për sasinë 12000 ton. 4. Kontrata me A. lidhur me 19/01/018 sasia 20.000,ks përcakton distancë dhe tarifën për ton/km. 5. Kontrata me K. lidhur me 22/02/2018 për sasinë 40000 ton, nuk përcakton tarifë transporti. Me datë 02/05/2018 është amenduar. 6. Kontrata me M.-2 lidhur me datë 18/01/2018 sasia 80.000-100.000 ton, nuk përcakton tarifë me afat deri më 31/12/2018 (kjo kompani është tërhequr ka prishur në mënyrë të njëanshme kontratën, por nuk aplikuar penaltet, pasi kontrata nuk e ka të përcaktuar penaltet). 7. Kontrata me pansped lidhur me 25/01/2018 me afat deri më 31/12/2018 sasia 10.000-15.000, nuk ak përcaktuar distancë dhe tarifë (nuk ka të bashkëngjitur librin tarifor). 8. Kontrata me Misped lidhur me 12/01/2018, nuk ka të përcaktuar afat, sasi, distancë dhe tarifë. 9. Kontrata me 16 February lidhur me 12/12/018 me afat 31/12/2018 pa përcaktuar sasi, distancë dhe tarifë.

Për vitin 2019 janë lidhur 3 kontrata me M. 2 data e lidhjes së kontratës 15/01/019, sasia 80.000-100.000 ton, por pa bashkëngjitur tarifat sipas librit tarifor, me Milsped datë e lidhjes së kontratës 01/02/2019 pa sasi dhe distancë dhe me 16 February datë e lidhjes kontratës 02/03/2019 sasia 30.000-70,000 ton, pa përcaktuar destinacionin.

Nga auditimi me zgjedhje i faturave të transportit për periudhën Tetor 2018-Mars 2019 rezultuan këto gjetje:

-Ka korrigjime të faturave të shitjes dhe të fletë-ngarkesave. Konkretisht faturat nr.354 datë 12.11.2018, nr.393 datë 04.12.2018 dhe nr.400 datë 07.12.2018. *Këto veprime bien ndesh me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 36 e nenit 4/26 të ligjit 10296 datë 08.07.2010 për MFK.*

-Në 7 raste mungon bashkëngjitur fletë-ngarkesat.

-Ka raste ku fletëngarkesat ndërkombëtare (CIM) nuk përputhen me tonazhin e shënuar në faturë si në faturën nr.346 datë 06.11.2018 për Pansped tonazhi sipas Cimeve është 181.85 ton ndërsa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

sipas faturës e fletëngarkesës është 179.15 ton pra faturuar më pak 2.7 ton = **21.8 euro**. Vlerë e cila duhet të arkëtohet nga Pansped. Në faturën nr.23 dt 03/02/2019 për M.-2 faturuar 548 ton, kur sipas çmimeve duhet 558.28 ton diferenca 10.28 ton = **83 euro**, të arkëtohet nga M. -2.

-Në 1 rast nuk është aplikuar drejt tarifa sipas librit tarifor si në faturën nr.13 dt 13/01/2019 me M.-2 faturuar me pak **44.5 euro**.

Për sa mësipër mbajnë përgjegjësi K.Sh. me detyrë Drejtues i Njesisë së mallit, dhe A.H. me detyrë Drejtues i Njesisë ekonomike.

12. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr.8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Procedurat e arkivimit të dokumentacionit në shoqërinë H.Sh. janë bazuar në Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Modeli nr.8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, referuar këtij ligji.

Përpilimi dhe shtypja e dokumenteve që kanë dalë nga institucioni përgjithësisht janë konform Modelit nr.8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha dokumentet janë të pajisura me Stemën e Republikës së Shqipërisë, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse, numrin e regjistrimit të korrespondentit, formulën në përgjigje ose vijim të shkresës sipas rastit, numrin e lidhjeve tekstin e dokumentit, funksionin ,emrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Këto dokumente kanë datën, numrin e protokollit dhe firmën e titullarit. Statistika e dokumenteve të hyra dhe të dala gjatë gjithë periudhës së auditimit jepet si më poshtë:

Vitet	2018		Janar-Maj 2019	
	Dokumente të hyra	Dokumente të dala	Dokumente të hyra	Dokumente të dala
	428	818	263	511

*Tabela 15 Të dhënat e shkresave të arkivës për vitet 2018- 2019 në Hekurudhën Shqiptare
Burimi i të dhënave H.Sh.*

Vendimet, urdhëratë, materialet e mbledhjeve si dhe dokumentet e tjera të brendshme janë të pajisur me gjithë elementet e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës.

Dokumentet e brendshëm të cilat i janë dërguar një organi tjetër janë shoqëruara me shkresë përcjellëse. Këto dokumente janë të gjitha të protokolluara dhe të firmosura nga titullari i institucionit.

Dokumentet që dalin jashtë subjektit shtetëror mbylleen në zarfe ose në pako, dhe janë të evidentuara ne librin e dorëzimit. Dokumentet hyrëse, nga ana tjetër janë të regjistruara në regjistrin e korespondencës, mbi to është shënuar numri i protokollit dhe data e marrjes, i janë dhënë titullarit dhe sipas destinacionit janë shpërndarë në sektorët përkatës kundrejt firmës.

Nga kontrolli i inventarit të dosjeve është konstatuar se ky inventar është hartuar nga arkivi në bashkëpunim me sektorët përkatës. Procesi i punës i inventarit të dosjeve është kryer duke u bazuar në inventarin e dosjeve të viteve të mëparshme, në drejtimet e veprimtarisë së subjektit dhe në listën e dokumenteve të subjektit me afatet e ruajtjes.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH A DURRËS

Gjatë auditimit është konstatuar gjithashtu se janë përpiluar pasqyrat emërtuese në bazë të gjithave kriterëve arkivore të cilat janë: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territoriale – administrative, të llojit të dokumentit, të kohës. Kjo pasqyrë hyn në fuqi mbasi miratohet nga titullari. Të gjitha pasqyrat emërtuese të çeljeve të dosjeve janë hartuar veç për ato me vlerë ruajtje të përkohshme dhe janë bërë në dy ekzemplar ku njëri qëndron në arkiv që është i përgjithshëm për të gjithë sektorët dhe tjetri është i veçantë për çdo sektor dhe ju është shpërndarë sektorëve përkatëse. Është konstatuar se arkivi brenda 6- muorit të parë të çdo viti pasardhës ka mbyllur dosjet e hapura sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre .

13. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë ne rrjetit hekurudhor në pronësi të H.Sh..

1.Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë ne rrjetit hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., si dhe mos mbikëqyrje e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie

Situata: Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.” ShPK., A., Shoqëria “H.Sh.” ShA. si dhe po bëhet gati të fillojë operatori “A.”.

Transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK.

Transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK. i pajisur me leje veprimtarie të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo leje nuk ka të përcaktuar afatin e vlefshmërisë, si dhe nuk ka të përcaktuar segmentin hekurudhor ku do të ushtrohet veprimtaria për mallra. Kjo leje nuk ndodhet e publikuar në QKB, “Në licencat e lëshuara jashtë QKB”.

Ky transportues hekurudhor nuk është i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke ***ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019)***, pasi edhe pse, ligji nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2018, ende ky operator është i pa pajisur me veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 ‘Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë’, ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, ‘Për liçencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo ndërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta’ të ndryshuar, të VKM nr.657, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e autoritetit licencues hekurudhor” të Urdhrit të Ministrit nr.847, datë 07.12.2018 “Mbi procedurën e miratimit të liçencave, nëpërmjet QKB” në veprimtarinë e nënkategorisë VII.6.1, Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-Vazhdimi i veprimtarisë së këtij transportuesi, mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, pasi ky transportues;

- është i pa pajisur me çertifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, nei 65 dhe 66 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur), me çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo çertifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga kompania 16 february dhe montecargo, nuk konsiderohen dokumente të vlefshme për të vërtetuar gjendjen teknike të tyre për tu pranuar në transport hekurudhor.

Ky operator, ka paraqitur deklaratë nga Kompania 16 February Podgoricë me nr.50-54/572, datë 01.06.2016 për 21vagona dhe 2 lokomotiva, ku ndër të tjera në pikën 4 shprehet në mënyrë eksplicite se “*Riparimet e lokomotivave dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimi i fundit kapital i tyre është gjithashtu në ofiçinën e kombinatit në vitin 2010*”. Bëhet fjalë për lokomotiva të vitit 1987.

Pika 5 e kësaj deklarate shpreh në mënyrë eksplicite se: “*Riparimet e 21 vagonëve dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimet kapitale të sistemit kryesor të frenimit dhe shkarkimit janë bërë në vitin 2008 në ofiçinën G.eli REVOM d.o.o dobosnica në Bosnjë dhe Hercegovinë*”. Bëhet fjalë të vagonëve të TIPIT EAMO prodhuar në vitin 1976 në fabrikën Kaliningrad në Bashkimin e Republikave Sovjetike. Pra ky operator ka përfutur këtë leje të veprimtarisë për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor në Hekurudhën Shqiptare me vagon mbi 40 vite, si dhe për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur), me çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo çertifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “H.Sh.” dhe nga Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në **vlerën 3,228,427 lekë**, për të cilat Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi operatori B. ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria “H.Sh.” respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

Transportuesi Hekurudhor A.

Transportuesi Hekurudhor A. i pajisur me liçencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan me objekt transport i mallrave. Kjo licencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.201, pasi nuk disponon mjetet tërheqëse (lokomotivat). Me kërkesë nr.48 prot., datë 19.07.2019 drejtuar B.B., Ministre e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, A.D., Ministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit Mbikëqyrës së H.Sh. dhe A.D. me detyrë Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., ky operator ka kërkuar që të ushtrojë aktivitetet të veprimtarisë transportuese hekurudhore në rrjetin hekurudhor shqiptar, **pasi këtij operatori i është refuzuar kryerja e këtij aktiviteti, nga mos dhënia me qira e mjeteve tërheqëse, lokomotivave.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA Durrës

Ndërmjet këtij operatori dhe Shoqërisë “H.Sh.” ShA., nuk ka një kontratë të lidhur mes dy palëve për transportin në hekurudhë të mallrave në segmentin hekurudhor Bajz - Durrës dhe Durrës-Elbasan referuar liçencës së dhënë.

Po nga ky operator, nuk disponohet (është i pa pajisur), me **çertifikatë sigurie**, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhor” ,botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011. Theksojmë se çertifikata e sigurisë, lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret në fuqi (referenca neni 65 i Kodit Hekurudhor).

Për mjetet e tërhequra (vagon hekurudhor) ky operator ka paraqitur kontratë qiraje me kompaninë N. doo N. sad më datë 11 tetor 2018 për 15 vagonë të cilët për gjendjen teknike të tyre nuk është paraqitur çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo çertifikatë duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Me procesverbal të datës 12.06.2019. të mbajtur nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, është kryer kontrolli i gjendjes teknike të vagonëve në gjendje statike. Në këtë procesverbal është lënë detyrë që 14 vagonët duhet të testohen edhe në gjendje lëvizëse.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk mund të provohet/vërtetohet se këto vagonë plotësojnë standartet e lëvizjes pa rrezik në rrjetin Hekurudhor Shqiptare.

Transportuesi hekurudhor A.

Operatori A. i pajisur me liçencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr LN-6425-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin Fier-Vlorë, Fier-Ballsh me objekt transport i mallrave dhe udhëtarëve. Kjo liçencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/216 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.pasi:

Për 23 mjete tërheqëse vagonë ka kontratë qiramarrje nr.39018 lidhur datë 26.02.2019 me kompaninë G.R. Austri për 23 vagonë të tipit GATX 1465 cisterne për transport naftës bruto, është dokument i fotokopjuar i noterizuar nga noter A.M., me vulë të njomë pa vulë të thatë, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre.”

Transportuesi Hekurudhor Shoqëria “H.Sh.” ShA.

Për ushtrimin e aktivitetit nëpërmjet 4 Njësive të mësipërme, H.Sh. SHA është pajisur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me NUIS J61811547D datë 17.11.2000, pa afat, për transport mallrashe, udhëtarësh dhe ngarkim – shkarkim.

Për të realizuar këtë veprimtari në përbërje të H.Sh. janë këto katër Njësi Biznesi.

- Njësia e Biznesit të Transportit të Mallit.
- Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve
- Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

-Njësia e Biznesit të Mirëmbajtjes të mjeteve tërheqëse (Lokomotiva) dhe të mjeteve të tërhequra (vagonë)

Për kryerjen e transportit hekurudhor të mallrave dhe të udhëtarëve, njësitë përkatëse disponojnë inventarin e mëposhtëm:

Njësia e Biznesit të Mallit, disponon 12 lokomotiva dhe 94 vagonë të transportit të mallrave.

Njësia e Biznesit të Udhëtarëve, disponon 9 lokomotiva dhe 34 vagonë të transportit të udhëtarëve.

Të gjithë mjete tërheqëse (lokomotiva) dhe ato të tërhequra (vagonë), kanë pasaportat e tyre teknike në të cilat janë të cilësuar karakteristikat e tyre teknike, si data e prodhimit dhe e fillimit të punës së tyre, kilometrat e përshkruara, ndryshimet në K. që ato pësojnë gjatë riparimit të tyre.

Nga ana e sektorit teknik të njësive përkatëse evidentohen kryesisht kilometrat e përshkruara për çdo vit të mjeteve të mësipërme, dhe në bazë të kilometrave të përshkruara. planifikojnë në vitin e ardhshëm pranë Njesisë të Mirëmbajtjes Mjeteve Hekurudhore, llojin e riparimit psh., riparim të mesëm, riparim vjetor apo riparim kapital. Nga ana tjetër Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse harton grafikun e riparimit të këtyre mjeteve në vitin në vijim.

Mjetet hekurudhore që qarkullojnë në rrjetin hekurudhor, duhet të plotësojnë kushtet e pranimit teknik dhe të pranimit për shfrytëzim, të përcaktuara në Rregulloren e Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhave dhe të Rregullores nr.16 datë 30.09.1998 “Për riparimin dhe shfrytëzimit e mjeteve hekurudhore” të miratuara nga Ministri Transporteve. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, ndjek procedurat gjatë pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore kur dalin nga riparimi i tyre. Të gjitha mjetet hekurudhore dalin për shfrytëzim pasi janë të miratuara (certifikuara), nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Asnjë mjet hekurudhor si dhe personel i transportit nuk mund të lëvizë për qarkullim në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve pa u pajisur me leje përkatëse.

Gjithashtu personeli që punon me trena, si të mallit ashtu edhe të udhëtarit, si kryetar treni, shkarkuese treni, frenues, kontrollor frenash, janë të pajisur me dëshmi aftësie për punën që ato kryejnë. Kjo dëshmi rinovohet sipas një periudhe të përcaktuar në RSHT. Dëshmitë lëshohen nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhore.

Shoqëria “H.Sh.” ShA. disponon 420 km linjë hekurudhore kryesore nga të cilat operative janë 275.2 km, ku kryhet transporti i mallrave dhe ai i udhëtarëve.

Mirëmbajtja e Linjës Hekurudhore kryhet në mbështetje të Rregullores nr.14 datë 30.09.1998 “Për Mirëmbajtjen e Vijave Hekurudhore” të Ministrisë të Transporteve.

Gjendja e Infrastrukturës hekurudhore është jo në kushtet që përcakton Rregullorja e mësipërme. Në këto kushte për të siguruar lëvizjen e trenave pa rrezik si dhe vijueshmërinë e transportit hekurudhor, shpejtësia e lëvizjes të trenave është mesatarisht 30 deri 35 km/ore dhe në zona të veçanta ajo është deri në 10 km/orë.

Një veprim i tillë mbështetet në amendamentin nr.558/5 datë 21.7.1998 të Ministrisë të Transporteve, sipas Rregullores nr.14 datë 30.9.1988 të mësipërme.

Në zbatim të Rregullores të Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhave (R.SH.T) neni 51 pika d, çdo fund viti, një grup i përbashkët nga Infrastruktura dhe Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, kryejnë kryesisht në këmbë kontrollin periodik të linjës hekurudhore, me mision për të kontrolluar gjendjen e Linjës Hekurudhore si dhe përcaktojnë masat për përmasimin e saj.

Kriteri: Ligji Nr.142/2016 ‘Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë’, ligji nr.10081, datë 23.02.2009, ‘Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo ndërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

përbashkëta’ të ndryshuar, VKM nr.657, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e autoritetit liçencues hekurudhor”, Urdhri i Ministrit nr.847, datë 07.12.2018 “Mbi procedurën e miratimit të liçencave, nëpërmjet QKB” në veprimtaritë e nënkategorisë VII.6.1, Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

Ndikimi/efekti: Dëmtim të rrjetit Hekurudhor Shqiptar në *vlerën 3,228,427 lekë*, risk i lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të çojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike.

Shkaku: Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë në rrjetit hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., si dhe nga mos mbikëqyrja e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor e kësaj veprimtarie.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

- Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatohen procedurat ligjore për *pezullimin e lejes së veprimtarisë të përkohshme* nr.1 datë 18.07.2016 për transportuesin hekurudhor “B.C.” ShPK. dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi ende ky operator është i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019 dhe vazhdimi i veprimtarisë pa certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie mund të çojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit.

-Shoqëria “H.Sh.” ShA. të pezullojë lidhjen e kontratës për përdorimin e vijës hekurudhore për vitin 2020 me transportuesin hekurudhor “B.C.” ShPK., deri në pajisjen e tij me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), si dhe pajisjen me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

-Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatohen procedurat ligjore për heqjen e lejes së veprimtarisë për operatorin “A.” ShPK., pasi ky transportues hekurudhor, i pajisur me leje veprimtarie nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, nuk zotëron mjetet lëvizëse hekurudhore, si dhe mjetet tërheqëse nuk janë në gjendjen e kërkuar teknike, kriter i përcaktuar në rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”.

-Shoqëria “H.Sh.” ShA. të pezullojë lidhjen e kontratës për përdorimin e vijës hekurudhore për periudhën shtator-dhjetor 2019 dhe vitin 2020 me transportuesin hekurudhor “A. ShPK.”, deri në rivlerësimin e lejes veprimtarisë me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), si dhe pajisjen me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit

Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “H.Sh.” dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK., ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në *vlerën 3,228,427 lekë*, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi operatori “B.C.” ShPK., ndërsa dëmi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

është përcaktuar nga Shoqëria “H.Sh.” respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

Ndikimi/efekti: Dëmtim të rrjetit Hekurudhor Shqiptar në **vlerën 3,228,427 lekë**, risk i lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike.

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 3,228,427 lekë lekë nga “B.C.” ShPK. Kjo vlerë ka të bëjë me dëmtim të rrjetit hekurudhor gjatë ushtrimit të aktivitetit. Vlera 3,228,427 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “H.Sh.” dhe Buxhetin e Shtetit. Në rast mos likuidimi të aplikohen saksionet përkatëse bazuar në kontratën e nënshkruar me këtë transportues hekurudhor.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.” ShPK., A., Shoqëria “H.Sh.” ShA. si dhe po bëhet gati të fillojë operatori “A.”.

Transportuesi Hekurudhor A.

Transportuesi Hekurudhor A. i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan me objekt transport i mallrave. Kjo licencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.201, pasi nuk disponon mjetet tërheqëse (lokomotivat). Me kërkesë nr.48 prot., datë 19.07.2019 drejtuar B.B., Ministre e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, A.D., Ministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit Mbikëqyrës së H.Sh. dhe A.D. me detyrë Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., ky operator ka kërkuar që të ushtrojë aktivitet të veprimtarisë transportuese hekurudhore në rrjetin hekurudhor shqiptar, ***pasi këtij operatori i është refuzuar kryerja e këtij aktiviteti, nga mos dhënia me qira e mjeteve tërheqëse, lokomotivave.***

Ndërmjet këtij operatori dhe Shoqërisë “H.Sh.” ShA., nuk ka një kontratë të lidhur mes dy palëve për transportin në hekurudhë të mallrave në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan referuar licencës së dhënë.

Po nga ky operator, nuk disponohet (është i pa pajisur), me **çertifikatë sigurie**, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhor” ,botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011. Theksojmë se çertifikata e sigurisë, lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret në fuqi (referenca neni 65 i Kodit Hekurudhor).

Për mjetet e tërhequra (vagon hekurudhor) ky operator ka paraqitur kontratë qiraje me kompaninë N. doo N. sad më datë 11 tetor 2018 për 15 vagonë të cilët për gjendjen teknike të tyre nuk është paraqitur çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo çertifikatë duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Me procesverbal të datës 12.06.2019. të mbajtur nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, është kryer kontrolli i gjendjes teknike të vagonëve në gjendje statike. Në këtë procesverbal është lënë detyrë që 14 vagonët duhet të testohen edhe në gjendje lëvizëse.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk mund të provohet/vërtetohet se këto vagonë plotësojnë standartet e lëvizjes pa rrezik në rrjetin Hekurudhor Shqiptare.

Transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK.

Operatori “B.C.”, i pajisur me leje veprimtarie të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. ***Kjo leje nuk ka të përcaktuar afatin e vlefshmërisë, si dhe nuk ka të përcaktuar segmentin hekurudhor ku do të ushtrohet veprimtaria për mallra. Kjo leje nuk ndodhet e publikuar në QKB, “Në liçencat e lëshuara jashtë QKB”.***

Ndërmjet këtij operatori dhe HSH është lidhur kontratë mes dy palëve më datë 01.06.2017 me afat 31.12.2017 e firmosur nga E.D. për Hekurudhën Shqiptare, me detyrë Drejtor i Njësisë Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës dhe jo nga Administratori i Shoqërisë, në tejkallim të kompetencës dhe për operatorin nga Marjan Fierza në cilësinë e Administratorit dhe për segmentin Bajz-Koplik-Sukth e firmosur dhe 27.05.2019 me afat deri më 31.12.2019 firmosur nga administratori A.D. dhe për Shoqërinë nga Eduard Pllumbaj. Po nga ky operator nuk disponohet (është i pa pajisur) **çertifikatë sigurie**, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011. Theksojmë se çertifikata e sigurisë lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret në fuqi (referenca neni 65 i Kodit Hekurudhor).

Për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur), me çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo çertifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga kompania 16 february dhe montecargo, nuk konsiderohen dokumente të vlefshme për të vërtetuar gjendjen teknike të tyre për tu pranuar në transport hekurudhor.

Ky operator, ka paraqitur deklaratë nga Kompania 16 February Podgoricë me nr.50-54/572, datë 01.06.2016 për 21vagona dhe 2 lokomotiva, ku ndër të tjera në pikën 4 shprehet në mënyrë eksplicite se “*Riparimet e lokomotivave dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në oficinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimi i fundit kapital i tyre është gjithashtu në oficinën e kombinatit në vitin 2010*”. Bëhet fjalë për lokomotiva të vitit 1987.

Pika 5 e kësaj deklarate shpreh në mënyrë eksplicite se: “*Riparimet e 21 vagonëve dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në oficinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimet kapitale të sistemit kryesor të frenimit dhe shkarkimit janë bërë në vitin 2008 në oficinën G.eli REVOM d.o.o dobosnica në Bosnjë dhe Hercegovinë*”. Bëhet fjalë të vagonëve të TIPIT EAMO prodhuar në vitin 1976 në fabrikën Kaliningrad në Bashkimin e Republikave Sovjetike. ***Pra, ky operator ka përfutur këtë leje të veprimtarisë për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor në Hekurudhën Shqiptare me vagon mbi 40 vite, si dhe për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk***



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

disponohet (është i pa pajisur), me certifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të liçencës, nga kompani riparuese e liçencuar. Kjo certifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Ky operator, ka paraqitur deklaratë me nr.2936, datë 18.05.2016 nga kompania Montecargo Podgoricë për vitet e prodhimit të vagonëve, vitet e prodhimit të 2 lokomotivave, numrin e serisë se tyre, si dhe punën që ato kanë kryer, si dhe shërbimet, deklaratë e cila nuk mund të merret në konsideratë, pasi është lëshuar para deklaratës të Kompanisë 16 february Podgoricë me nr.50-54/572, datë 01.06.2016.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion është paraqitur dhe një deklaratë e Kompanisë 16 February Podgoricë, datë 21.12.2015, e fotokopjuar, dhe e përkthyer nga përkthyes H.Q., i pa noterizuar, në të cilën deklarohet se, “Me anë të kësaj deklarate vërtetojmë se lokomotivat dizel nr.744-05 dhe nr.744-10 të serisë 744, të prodhuar në vitin 1987 në bashkimin sovjetik, janë në gjendje të rregullt teknike, kënaqin të gjitha standartet e qarkullimit hekurudhor dhe janë të përcaktuara për transport koloseket (linjat sh.p) europiane, me gjerësi 1435 mm, gjerësi e cila është dhe gjerësia e kolosekeve në udhët e hekurta shqiptare”.Ky dokument është i pa vlefshëm për tu marrë në konsideratë, pasi nga kjo kompani nuk provohet se është e certifikuar në shtetin Mail i Zi, për dhënien e certifikatave të gjendjes teknike të lokomotivave dhe vagonëve, por është edhe kontradiktore pasi po me deklaratën e vet kësaj kompanie me nr.50-54/572, datë 01.06.2016 për 21vagona dhe 2 lokomotiva ku ndër të tjera në pikën 4 shprehet në mënyrë eksplicite se; “Riparimet e lokomotivave dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimi i fundit kapital i tyre është gjithashtu në ofiçinën e kombinatit në vitin 2010”, si dhe me faktin që kjo kompani në praktikat e procedurave të prokurimit të kryera nga Shoqëria “H.Sh.” rezulton “Për prodhimin dhe tregtimin e tranvesave të drurit për hekurudhat”.

Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “H.Sh.” dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në vlerën 3,228,427 lekë, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi operatori B. ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria “H.Sh.” respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

Edhe pse ligji nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2018, ende ky operator është i pa pajisur me liçencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke **ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019)**, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 ‘Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë’, ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, ‘Për liçencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo ndërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta’ të ndryshuar, të VKM nr.657, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e autoritetit liçencues hekurudhor” të Urdhrit të Ministrit nr.847, datë 07.12.2018 “Mbi procedurën e miratimit të liçencave, nëpërmjet QKB” në veprimtaritë e nënkategorisë VII.6.1, Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

Transportuesi hekurudhor A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Operatori Albreil i pajisur me licensë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr LN-6425-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin Fier-Vlorë, Fier-Ballsh me objekt transport i mallrave dhe udhëtarëve. Kjo liçencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/216 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtare të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011,pasi: Për 23 mjete tërheqëse vagonë ka kontratë qiramarrje nr.39018 lidhur datë 26.02.2019 me kompaninë G.R. Austri për 23 vagonë të tipit GATX 1465 cisterne për transport naftës bruto, është dokument i fotokopjuar i noterizuar nga noter A.M., me vulë të njomë pa vulë të thatë, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre.*"

Pranë drejtorisë së Inspektimit hekurudhor është paraqitur një kërkesë nga shoqëria A. për inspektimin e vagonëve cisterne që do të operojnë në segmentin hekurudhor Fier-Vlorë për transportin e naftës bruto.

Transportuesi hekurudhor Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës.

Për ushtrimin e aktivitetit nëpërmjet 4 Njësive të mësipërme, “H.Sh.” ShA. është pajisur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me NUIS J61811547D datë 17.11.2000, pa afat, për transport mallrash, udhëtarësh dhe ngarkim-shkarkim.

Për të realizuar këtë veprimtari në përbërje të H.Sh. janë këto katër Njësi Biznesi.

-Njësia e Biznesit të Transportit të Mallit.

-Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve

-Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore

-Njësia e Biznesit të Mirëmbajtjes të mjeteve tërheqëse (Lokomotiva) dhe të mjeteve të tërhequra (vagonë)

Për kryerjen e transportit hekurudhor të mallrave dhe të udhëtarëve, njësitë përkatëse disponojnë inventarin e mëposhtëm:

Njësia e Biznesit të Mallit, disponon 12 lokomotiva dhe 94 vagonë të transportit të mallrave.

Njësia e Biznesit të Udhëtarëve, disponon 9 lokomotiva dhe 34 vagona të transportit të udhëtarëve.

Të gjithë mjete tërheqëse (lokomotiva) dhe ato të tërhequra (vagonë), kanë pasaportat e tyre teknike në të cilat janë të cilësuar karakteristikat e tyre teknike, si data e prodhimit dhe e fillimit të punës së tyre, kilometrat e përshkruara, ndryshimet në K. që ato pësojnë gjatë riparimit të tyre.

Nga ana e sektorit teknik të njësive përkatëse evidentohen kryesisht kilometrat e përshkruara për çdo vit të mjeteve të mësipërme, dhe në bazë të kilometrave të përshkruara. planifikojnë në vitin e ardhshëm pranë Njesisë të Mirëmbajtjes Mjeteve Hekurudhore, llojin e riparimit p.sh., riparim të mesëm, riparim vjetor apo riparim kapital. Nga ana tjetër Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse harton grafikun e riparimit të këtyre mjeteve në vitin në vijim.

Mjetet hekurudhore që qarkullojnë në rrjetin hekurudhor, duhet të plotësojnë kushtet e pranimit teknik dhe të pranimit për shfrytëzim, të përcaktuara në Rregulloren e Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhave dhe të Rregullores nr.16 datë 30.09.1998 “Për riparimin dhe shfrytëzimit e mjeteve hekurudhore” të miratuara nga Ministri Transporteve. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, ndjek



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

procedurat gjatë pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore kur dalin nga riparimi i tyre. Të gjitha mjetet hekurudhore dalin për shfrytëzim pasi janë të miratuara (certifikuara), nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Asnjë mjet hekurudhor si dhe personel i transportit nuk mund të lëvizë për qarkullim në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve pa u pajisur me leje përkatëse.

Gjithashtu personeli që punon me trena, si të mallit ashtu edhe të udhëtarit, si kryetar treni, shkarkuese treni, frenues, kontrollor frenash, janë të pajisur me dëshmi aftësie për punën që ato kryejnë. Kjo dëshmi rinovohet sipas një periudhe të përcaktuar në RSHT. Dëshmitë lëshohen nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhore.

Shoqëria “H.Sh.” ShA. disponon 420 km linjë hekurudhore kryesore nga të cilat operative janë 275.2 km, ku kryhet transporti i mallrave dhe ai i udhëtarëve.

Mirëmbajtja e Linjës Hekurudhore kryhet në mbështetje të Rregullores nr.14 datë 30.09.1998 “Për Mirëmbajtjen e Vijave Hekurudhore” të Ministrit të Transporteve.

Gjendja e Infrastrukturës hekurudhore është jo në kushtet që përcakton Rregullorja e mësipërme. Në këto kushte për të siguruar lëvizjen e trenave pa rrezik si dhe vijueshmërinë e transportit hekurudhor, shpejtësia e lëvizjes të trenave është mesatarisht 30 deri 35 km/ore dhe në zona të veçanta ajo është deri në 10 km/orë.

Një veprim i tillë mbështetet në amendamentin nr.558/5 datë 21.7.1998 të Ministrit të Transporteve, sipas Rregullores nr.14 datë 30.9.1988 të mësipërme.

Në zbatim të Rregullores të Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhave (R.SH.T) neni 51 pika d, çdo fund viti, një grup i përbashkët nga Infrastruktura dhe Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, kryejnë kryesisht në këmbë kontrollin periodik të linjës hekurudhore, me mision për të kontrolluar gjendjen e Linjës Hekurudhore si dhe përcaktojnë masat për përmirësimin e saj. Për mos zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., me risk të lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, që vjen nga mos mbikëqyrja e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie, përsa mw sipër ngarkon me përgjegjësi Ahmet Allamani me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për Opinionin.

Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000):

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kualifikuar :

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) në administrimin e shpenzimeve, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur *nga gabime materiale*, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar*.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi mbi zbatimin e subvencioneve, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi.: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionim si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron qartazi një krizë të mprehtë likuiditeti të Shoqërisë “H.Sh.”. Për posë krizës, Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj, në vlerën 1,895,812 mijë lekë .

Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria “H.Sh.” ShA. Durrës, jo vetëm është në krizë të mprehtë likuiditeti, por është plotësisht e falimentuar.

Më date 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat : Raiffeisen Bank (7 numra llogarie), ABI Bank (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Kombëtare Tregtare (11 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Banka Credins (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhëra sekuestro, Pro Credit Bank (1 numër llogarie), Fibank (2 numër llogarie), Alpha Bank (2 numër llogarie), Union Bank (2 numër llogarie), Tirana Bank (1 numër llogarie), Intesa San Paulo (5 numra llogarie) Veneto Bank (1 numër llogarie), Societe Generale (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra llogarie me urdhëra sekuestro nr.11 në vlerën totale 44,938,145 lekë .

Referuar sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “H.Sh.” ShA. Durrës.

Përpos sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës nuk i është dhënë vëmendja e duhur në investime shtetërore, që s’duhet ti mungonin si e vetmja shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtareve, ashtu siç i jepen infrastrukturës automobilistike.

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot, datë 20.06.2018, ka çuar për indicie për ndjekje penale për përdorimin e subvencionit për vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Aplit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr (11-2019-1312)309 datë 06.03.2019 të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe **pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale** nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019

Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 58 të nenit 5 të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet përkufizimi i rrjetit hekurudhor konkretisht: “Rrjet” janë linjat, stacionet, terminallet dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.” Pra rrjeti nuk është veprimtari (subjekt) por objekt.

Referuar sa mësipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtorja e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga H.Sh., duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 10 në faqet 106-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1.: Që të mundësohet funksionimi i Shoqërisë dhe të mos krijohen probleme sociale me punonjësit, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri. Shoqëria aktualisht ndodhet përpara një krize të mprehtë likuiditeti dhe që, thjeshtë të vazhdojnë punë (të mos falimentoj), do të duhet ndihmë urgjente shtetërore shtesë.

- Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.

-Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë e strukturës së flotës hekurudhore krahasuar me kërkesat e tregut duke përcaktuar numrin e lokomotivave dhe vagonëve të nevojshëm për nivelet koherente të aktivitetit.

-Organet drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa për uljen e personelit. Duhet përcaktuar një politikë e qartë e shkurtimit vjetor të personelit gjatë tre-pesë viteve të ardhshme, me plan dhe afate të qarta për arritjen e niveleve mesatare të produktivitetit të personelit, si ato të hekurudhave fqinje, si Mali i Zi, Serbia Maqedonia, Kosova etj.. Kjo politikë duhet bazuar në një parashikim të kujdesshëm të nevojave e cili do të kërkojë përditësim të rregullt.

- Ndarja e qartë e llogarive të njësisë së biznesit të mallit, njësisë së biznesit të udhëtarëve, njësisë së biznesit të menaxhimit të infrastrukturës dhe njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse, duke u dhënë mundësi njësisve ta llogarisin produktivitetin e personelit në bazë të formulave specifike për secilin aktivitet duke ofruar informacion më të saktë për vlerësimin e rezultateve të secilës njësi.

-Transportuesit hekurudhor privatë të vihen në kushte të barabarta përsa i përket licensimit, çertifikatave të nevojshme sipas përcaktimve ligjore, kapacitetit të mjeteve (lokomotiva dhe vagon), si gjendjes teknike të tyre duke u pajisur me dëshmitë përkatëse.

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SHa DURRËS

2. Gjetje nga auditimi:

Në shkresën nr.1313/11 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr. 50, datë 17.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës i janë lënë për zbatim 23 masa organizative, 9 masa për shpërblim dëmi, 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 16 masa disiplinore.

Nga 23 masa organizative të lëna për zbatim, janë pranuar 100% e tyre. Nga masat e rekomanduara 5 (21.7%) janë zbatuar plotësisht dhe 18 (78.3%) janë në proces zbatimi.

Nga 9 masa për shpërblim dëmi, masa 4.1 dhe 4.2, janë revokuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr.1313/15 prot., datë 01.08.2018. Nga masat për shpërblim dëmi të rekomanduara, 2 masa (22.2%) në vlerën 14,223,134 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, 5 masat e tjera në vlerën 8,473,988 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në vlerën 1,474,183,493 lekë, 2 masa (40%) në vlerën 1,230,000,000 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, ndërsa 3 masa (60%) në vlerën 1,474,183,493 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar plotësisht 100%.

Mos zbatimi i rekomandimeve sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c dhe ka shkaktuar mungesë eficiencë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë H.Sh.” ShA., Durrës, si pasojë e mos korrektesës institucionale të organeve drejtuese të shoqërisë në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 në faqet 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1.: Nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi:

-Mos zbatim i rekomandimeve të KLSH, si dhe krijim provizione në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore në funksion të tyre, ardhur nga diziformimi që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë Shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i njësisë ekonomike, për krijimin e provigjoneve për debitorët pa shpresë arkëtimi”, në vlerën 44,321,985 lekë. Konkretisht:

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 201.12.2018 dhe vendimi i Administratorit të Shoqërisë nr.14, datë 05.11.2018, për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, është marrë mbi bazën e informacionit pa numër protokollit, datë 11.10.2018 i firmosur nga SH.Xh. me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i Njësisë Ekonomike.

Ky informacion është diziformues dhe i pa vërtetë (i rrem) për sa i përket: Zbatimit të procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 24,280,462 lekë nga Kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe Shoqërtia “S.S.” ShPK. Durrës për arkëtimin e vlerës 20,041,523 lekë nga personi fizik jo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” SH A DURRËS

tregtar Xh.GJ.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 në faqet 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 3.1.: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të merren masat për kthimin në gjendjen fillestare në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të vlerës 44,321,985 lekë, si dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e kësaj vlere. Kjo vlerë ka të bëjë me diziformimin që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga SH.Xh. me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H. me detyrë drejtues i Njesisë Ekonomike, lidhur me provigjonimet në pasqyrat financiare të vitit 2018. Konkretisht për subjektin tregtar Xh.GJ. në vlerën 20,041,523 lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson diferencë gazoili e ndodhur në vitin 2009 dhe i vlerës 24,280,462 lekë, nga kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.” ShPK. Durrës, për transportin i mineralit të hekur-nikelit nga stacioni hekurudhor të Gurit të Kuq-Elbasan me destinacion Kinë, detyrim i krijuar që nga viti 2007.

Rekomandimi 3.2.: Nga Administratori i shoqërisë të ngrihet grup pune për të llogaritur **kamatat ligjore të arrira** që prej datës së fillimit të vonesës së debitorëve Xh.GJ. **në vlerën 20,041,523 lekë** dhe kompania “K.SH.G.” Gjermani dhe “S.S.” ShPK. Durrës në vlerën **vlerën 24,280,462 lekë**, ndaj Shoqërisë “H.Sh.” ShA., në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 450, vendimit unifikues të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë 932/2000, të interpretuar me vendimin unifikues nr.40, datë 12.04.2002 (vendimi unifikues 40/2002), për të cilat SH.Xh. me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe A.H. me detyrë drejtues i Njesisë Ekonomike, duhet ti kishin llogaritur dhe dhënë informacion Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Brenda datës 31.12.2019

Nga auditimi i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të H.Sh., u konstau që:

4. Gjetje nga auditimi: Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., si dhe mos mbikëqyrje e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie. Konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.” ShPK., A., Shoqëria “H.Sh.” ShA. si dhe po bëhet gati të filloj operatori “A.”.

Transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK.

Transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK. i pajisur me leje veprimtarie të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo leje nuk ka të përcaktuar afatin e vlefshmërisë, si dhe nuk ka të përcaktuar segmentin hekurudhor ku do të ushtrohet veprimtaria për mallra. Kjo leje nuk ndodhet e publikuar në QKB, “Në licencat e lëshuara jashtë QKB”.

Ky transportues hekurudhor nuk është i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke ***ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019)***, pasi edhe pse, ligji nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2018, ende ky operator është i pa pajisur me licencë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 ‘Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë’, ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, ‘Për licencat, autorizimet dhe lejet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo ndërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta’ të ndryshuar, të VKM nr.657, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e autoritetit licencues hekurudhor” të Urdhrit të Ministrit nr.847, datë 07.12.2018 “Mbi procedurën e miratimit të licencave, nëpërmjet QKB” në veprimtarinë e nënkategorisë VII.6.1, Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-Vazhdimi i veprimtarisë së këtij transportuesi, mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, pasi ky transportues;

- është i pa pajisur me çertifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe 66 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur) çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo çertifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga kompania 16 February dhe Montecargo, nuk konsiderohen dokumente të vlefshme për të vërtetuar gjendjen teknike të tyre për tu pranuar në transport hekurudhor.

Ky operator, ka paraqitur deklaratë nga Kompania 16 February Podgoricë me nr.50-54/572, datë 01.06.2016 për 21vagona dhe 2 lokomotiva, ku ndër të tjera në pikën 4 shprehet në mënyrë eksplicite se “*Riparimet e lokomotivave dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimi i fundit kapital i tyre është kryer gjithashtu në ofiçinën e kombinatit në vitin 2010*”. Bëhet fjalë për lokomotiva të vitit 1987.

Pika 5 e kësaj deklarate shpreh në mënyrë eksplicite se: “*Riparimet e 21 vagonëve dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimet kapitale të sistemit kryesor të frenimit dhe shkarkimit janë bërë në vitin 2008 në ofiçinën G.eli REVOM d.o.o dobosnica në Bosnjë dhe Hercegovinë*”. Bëhet fjalë për vagonë të TIPIT EAMO prodhuar në vitin 1976 në fabrikën Kaliningrad në Bashkimin e Republikave Sovjetike. Pra ky operator ka përfituar këtë leje të veprimtarisë për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor në Hekurudhën Shqiptare me vagon mbi 40 vite, si dhe për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur) çertifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo çertifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “H.Sh.”ShA., dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në **vlerën 3,228,427 lekë**, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

drejtori është ngarkuar me përgjegjësi operatori B., ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

Transportuesi Hekurudhor A.

Transportuesi Hekurudhor A. i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan me objekt transport i mallrave. Kjo leje është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.201, pasi nuk disponon mjetet tërheqëse (lokomotivat). Me kërkesë nr.48 prot., datë 19.07.2019 drejtuar B.B., Ministre e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, A.D., Ministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “H.Sh.” ShA., dhe A.D. me detyrë Administrator i shoqërisë “H.Sh.” ShA., ky operator ka kërkuar që të ushtrojë aktivitet të veprimtarisë transportuese hekurudhore në rrjetin hekurudhor shqiptar, pasi këtij operatori i është refuzuar kryerja e këtij aktiviteti, nga mos dhënia me qira e mjeteve tërheqëse, lokomotivave. Ndërmjet këtij operatori dhe Shoqërisë “H.Sh.” ShA., nuk ka një kontratë të lidhur mes dy palëve për transportin në hekurudhë të mallrave në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan referuar licencës së dhënë.

Po nga ky operator, nuk disponohet (është i pa pajisur), certifikatë sigurie, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhor” ,botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011. Theksojmë se çertifikata e sigurisë, lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret në fuqi (referenca neni 65 i Kodit Hekurudhor).

Për mjetet e tërhequra (vagon hekurudhor) ky operator ka paraqitur kontratë qiraje me kompaninë N. doo N. Sad më datë 11 tetor 2018 për 15 vagonë të cilët për gjendjen teknike të tyre nuk është paraqitur certifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo certifikatë duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Me procesverbal të datës 12.06.2019. të mbajtur nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, është kryer kontrolli i gjendjes teknike të vagonëve në gjendje statike. Në këtë procesverbal është lënë detyrë që 14 vagonët duhet të testohen edhe në gjendje lëvizëse.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk mund të provohet/vërtetohet se këto vagonë plotësojnë standartet e lëvizjes pa rrezik në rrjetin hekurudhor Shqiptar.

Transportuesi hekurudhor A.

Operatori Albreil i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr LN-6425-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin Fier-Vlorë, Fier-Ballsh me objekt transport i mallrave dhe udhëtareve. Kjo licencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/216 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011,pasi: Për 23 mjete tërheqëse vagonë ky operator, ka kontratë qiramarrje nr.39018 lidhur datë 26.02.2019 me kompaninë G.R. Austri për 23 vagonë të tipit GATX 1465 çisternë për transport



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH A DURRËS

të naftës bruto, ky dokument është i fotokopjuar e noterizuar nga noter A.M., me vulë të njomë por pa vulë të thatë, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre.”

Për mos zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., me risk të lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, që vjen nga mos mbikëqyrja e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie, ngarkohet me përgjegjësi Ahmet Allamani me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor (*Më hollësisht trajtuar në pikën 13 në faqet 123-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1.: Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatohen procedurat ligjore për pezullimin e lejes së veprimtarisë të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 për transportuesin hekurudhor “B.C.” ShPK. dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi ende ky operator është i pa pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke ushtruar aktivitetet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019 dhe vazhdimi i veprimtarisë pa certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit.

Brenda datës 31.12.2019

Rekomandimi 4.2.: Shoqëria “H.Sh.” ShA. të pezullojë lidhjen e kontratës për përdorimin e vijës hekurudhore për vitin 2020 me transportuesin hekurudhor “B.C.” ShPK., deri në pajisjen e tij me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), si dhe pajisjen me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Brenda datës 31.12.2019

Rekomandimi 4.3.: Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatohen procedurat ligjore për heqjen e lejes së veprimtarisë për operatorin “A.” ShPK., pasi ky transportues hekurudhor, i pajisur me leje veprimtarie nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.LN-6424-12-2018 datë 26.12.2018, nuk zotëron mjetet lëvizëse hekurudhore, si dhe mjetet tërheqëse nuk janë në gjendjen e kërkuar teknike, kriter i përcaktuar në rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”.

Menjëherë

Rekomandimi 4.4.: Shoqëria “H.Sh.” ShA. të pezullojë lidhjen e kontratës për përdorimin e vijës hekurudhore për periudhën shtator-dhjetor 2019 dhe vitin 2020 me transportuesin hekurudhor “A. ShPK.”, deri në rivlerësimin e lejes veprimtarisë me nr.LN-6424-12-2018 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

26.12.2018, dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), si dhe pajisjen me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

5. Gjetje nga auditimi: Në 2 procedura prokurimi për vlerën 22,330 mijë lekë, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 7 procedura prokurimi për vlerën 63,946 mijë lekë, në urdhrat e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, por është cilësuar, ngarkohet njësia e prokurimit pranë H.Sh. ShA. Durrës, për zbatimin e këtij urdhri, në kundërshtim me VKM nr.914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”.

-Për 4 procedura prokurimi për vlerën 46,713 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 3 procedura prokurimi për vlerën 40,047 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 3 raste për vlerën 34,169 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në 3 raste për vlerën 1,790,556 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave për punë publike dhe i mallrave, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 63-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5.1.: Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:

- Përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ose zyrtari i deleguar prej Tij, për çdo procedurë, urdhrat e prokurimit të përcaktojnë specifikisht emrat e njësisë së prokurimit.

-Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:

6. Gjetje nga auditimi.

- Nga analizimi i dokumenteve ligjore me të cilët është rregulluar veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës të “H.Sh.” ShA., Durrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ato nuk janë të harmonizuara dhe të bashkërenduara nga pikëpamja juridike, konkretisht përsa i përket mbledhjes së këshillit, zgjedhjes së kryetarit dhe zv/kryetarit dhe shpërblimit të këshillit.

Në statut neni 9 përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar ndërsa në udhëzim nr.318 datë 08.04.2009 të Ministrit të ish-METE, i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi, kryetari i këshillit zgjidhet me propozim të Ministrit, neni 10.1 i statutit të shoqërisë përcakton se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se 2 herë në vit, ndërsa në VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, pika 8, dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 pika 9, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

herë në vit, neni 12 i statutit për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, i cili aktualisht është i shfuqizuar dhe statuti duhet t’i referohet VKM nr.570 dt 03.10.2018 në nenin 11. Pika 4 të statutit, nuk ka një rregullore të organizimit dhe funksionimit të veprimitarisë së këshillit

-Statuti i shoqërisë neni 8.2 përcakton se kohëzgjatja e anëtarëve të KM është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje, nga auditimi u konstatua se dy prej anëtarëve të këshillit e kanë mbaruar afatin 3 vjeçar por, nuk ka asnjë shkresë nga Ministria për rizgjedhjen e tyre, konkretisht K.M. emëruar në datë 01.07.2015 dhe Th.Xh. emëruar në 01.07.2016. Gjithashtu edhe A.Sh. anëtarë tjetër i Këshillit Mbikëqyrës ka paraqitur dorëheqjen gjatë fazës së auditimit nga grupi në subjekt, situatë kjo e cila ndikon në kuorumin e organit kolegjal.

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka zgjedhur zv/kryetarin, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreut II, pika 5 (i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi) dhe statutit të shoqërisë neni 9 pika 9.1, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar. Sipas statutit nenit 9.3 dhe 10.1, këshilli mbledhet me kërkesë të kryetarit ose në mungesë të tij të zv/kryetarit. Zgjedhja e zv/ kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 23-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandime 6.1: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës/ kryetari të njoftojë Ministrinë e Financave dhe të kërkojë zgjidhjen sa më të shpejtë të situatës së krijuar në organin kolegjal të shoqërisë “H.Sh.” ShA. dhe më pas të zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij dhe një zv/kryetar në mënyrë që të vazhdojë funksionimi normal i tij duke e kthyer në gjendje të ligjshme dhe duke shmangur pengimin e punës në rastet kur nuk mund të jetë kryetari.

Menjëherë

Rekomandimi 6.2: Këshilli Mbikëqyrës (KM) i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës të marrë masa për implementimin dhe harmonizimin e të gjitha ndryshimeve të bazës ligjore për funksionimin e këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare me statutin e shoqërisë, si dhe të hartojë një rregullore për funksionimin e tij me qëllim mbarëvajtjen e punës duke përcaktuar qartë detyrat funksionale të këshillit.

Brenda datës 31.12.2019

7. Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 04.12.2017 është emëruar Administrator i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., A.D.. Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë sipas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.17516 prot., datë 04.12.2017. Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë me Administratorin e “H.Sh.” ShA. , veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statutin e shoqërisë neni 11, pika i, ku përcaktohet se me emërimin e administratorit të shoqërisë, këshilli lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 23-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Rekomandimi 7.1.: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës të marrë masa për të rregulluar marrëdhënien juridike të punës me administratorin e shoqërisë duke lidhur kontratë me të për periudhën e mbetur të emërimit, me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve mbështetur në interesat e ligjshëm të shoqërisë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë shqyrtimit të vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se në shumicën e tyre këshilli nuk është i shprehur qartë dhe nuk ka dhënë një vendim të argumentuar, fakt i cili lë vend për interpretim nga ana e shoqërisë.

Psh: Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.6 datë, 30.04.2018, këshilli shprehet se miratohet struktura organizative e Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj por, nuk përcakton numrin e drejtorive dhe numrin e punonjësve respektiv. E njëjta situatë konstatohet edhe me vendimet e miratimit të strukturës organizative për vitin 2019 me vendimin nr.5 datë 7.03.2019. Vendimi nr.2, datë 02.02.2018 për miratimin e Strukturës Organizative dhe Organigramës së “H.Sh.” ShA. me fillim zbatimi nga 01.04.2018 (nga 1068 punonjës do të operohet me 992 punonjës, duke shkurtuar 76 punonjës në total.) Por, numri i punonjësve të miratuar për vitin 2018 ka qenë 1100 punonjës dhe jo 1068 siç shprehet këshilli dhe për të shkuar në numrin 992 duhet të shkurtohen 110 punonjës. Në këtë vendim këshilli është bazuar në programin ekonomik të parashikuar nga strukturat e shoqërisë dhe jo në atë të miratuar nga vetë këshilli më përpara. Vendimi nr.8, datë 30.04.2018 dhe vendimi nr.4 datë 27.03.2019 ku këshilli shprehet se vendosi në zbatim të vendimit nr.54 datë 05.02.2014 kreu II pika 1/d të Këshillit të Ministrave të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në njësinë e infrastrukturës sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë por, nuk është shprehur për numrin e këtyre ambienteve ose lista e paraqitur nga administratori të firmosej nga këshilli. Vendimi nr.12 datë 18.07.2018 për miratimin e Kodit të Etikës të Auditit të Brendshëm. Vendim ky i panevojshëm pasi ky kod është i miratuar me urdhrin nr.56 datë 2015 të Ministrit të Financave dhe është detyrimisht i zbatueshëm për të gjithë audituesit e brendshëm të sektorit publik pa kërkuar një miratim të dytë nga këshillat mbikëqyrës i sha-ve. Pra, ky kod nuk ka dashur miratimin e këshillit që të bëhej i zbatueshëm nga njësia e auditit të brendshëm. Vendimi nr.21 datë 20.12.2018 për miratimin në parim të materialit të paraqitur për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri në 31.12.2017. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë materialin për krijimin e provigjioneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguara deri më 31.12.2017. Ky vendim nuk ka të përcaktuar numrin e rasteve dhe vlerën përkatëse, si dhe nuk është firmosur as nga këshilli as nga hartuesit e saj, pasqyra e detyrimeve debitorë llogaria 4671 “Detyrime të tjera në konflikt” gjendje datë 31.12.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 23-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 8.1.: Këshilli Mbikëqyrës në të ardhmen të shqyrtojë dhe të analizojë me përgjegjësi relacionet e projekt-vendimeve të shoqërisë H.Sh. ShA. duke kërkuar paraprakisht një vlerësim juridik nga strukturat përkatëse të shoqërisë, me qëllim që vendimet e marra nga ana e tij të kenë bazueshmëri të saktë ligjore, të shprehen qartë duke mos lënë vend për keq interpretim, si dhe në rastet kur e përcakton ligji të mos anashkalohet miratimi i tyre nga ministri përkatës.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik, u konstatua që:

9. Gjetje nga auditimi. Në Hekurudhën Shqiptare ShA. konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik. Qëllimi i programit ekonomik në përgjithësi është arritja e synimeve të Shoqërisë sipas prioriteteve të saj. Për vitin 2018 sipas analizave të treguesve të buxhetit, realizimi i të ardhurave në raport me planin e të ardhurave, është në masën 93.2 %. Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, performanca e treguesve ekonomik-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet. Në Shoqërinë H.Sh. ShA. për çdo lekë të shpenzuar në vitin 2017 është përftuar një e ardhur prej 0.69 lekë, në vitin 2018 për çdo lekë të shpenzuar është përftuar një e ardhur prej 0.58 leke. Për vitin 2019 për pesëmujorin e parë të vitit për çdo lekë të shpenzuar është përftuar një e ardhur prej 0.53 lekë. Pra siç vërehet për vitin 2018 ka një ulje 0.11 lekë nga viti paraardhës 2017, ndërsa për pesëmujorin e parë të vitit 2019 ka një zvogëlim me 0.05 lekë nga viti 2018. Risku bazë para të cilit ndodhet Shoqërisë “H.Sh.” ShA. është risku i gjendjes të pamjaftueshme të likuiditeteve. Një kompani me aftësi paguese është ajo që zotëron më shumë se sa u detyrohet të tjerëve, me vlerë neto pozitive e borxh të menaxhueshëm. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2018, paraqitet 1.4 % (1.148.514 mijë detyrime /81.895.037 mijë lekë) me tendencë rritje për vitin 2019. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvecion nga buxheti i shtetit për vitin 2016, 2017, 2018 dhe për vitin 2019 në vlerat respektive 390.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyrë të ndjeshme rezultatin financiar (humbje), *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 29-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 9.1.: Nga ana e organeve drejtuese duhet të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:

10. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave për vitin 2018 është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2018, ku niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri në dhjetë vjet dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet por, *ky nivel nuk është miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit të vetëm).* E njëjta situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 08.05.2019, janë miratuar tabelat e pagave për punonjësit e Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, duke filluar nga data 01.05.2019. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite *“Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre”.* Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti P.Sh. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 01.01.2018-01.03.2018, B.A. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, si përfaqësues të Ministrisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

së Financave dhe Ekonomisë. Theksojmë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm (Pronari) i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti T.B. në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 21.03.2018-31.05.2019, si përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është në detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në këtë Ministri. Theksojmë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Shoqërinë “H.Sh.”, është Ministria e Linjës që monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë shoqëri (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandime 10.1.: Nga organet drejtuese të shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës të rikërkohët miratimi i nivelit të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria Ekonomisë dhe Financës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i tabelës së pagave konstatohet se nuk është ruajtur raporti i tyre ndërmjet shkallëve të vjetërsisë dhe kategorive të punës, për punonjësit që paguhen me kategori, kryesisht ato të riparimit të mjeteve hekurudhore është barazuar paga e kategorisë I-rë me atë të kategorisë IV dhe në disa raste me atë të kategorisë V. Për punonjësit e sektorit të lëvizjes dhe mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, është barazuar paga për vjetërsi në punë 1-5 vjet me atë mbi 25 vjet. Paga minimale është përafshuar dhe në disa raste është barazuar dhe me pagën e punonjësve në përbërje të personelit administrativ. Situata e cila krijon demotivimin e punonjësve për punë dhe mund të bëhet shkak për largimin e specialistëve të kualifikuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandime 11.1.: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë “H.Sh.” ShA. të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në shkallën e vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2019

12. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës/ Sektori Juridik në Njësinë e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore nuk provohet përfaqësimi në 5 raste në gjykatë, si palë e paditur nga ish-punonjësit e larguar. Konkretisht për çështjen me palë paditëse ish punonjësit M.A., A.K., A.K., D.D..

Gjatë auditimit rezultoi se për këto çështje janë protokolluar shkresat e ankimit në Shoqërinë “H.Sh.” ShA. Durrës, brenda afateve ligjore të ankimit por, nuk është marr protokoll i Gjykatës së Apelit, fakt i cili nuk dokumenton nëse procedura e ankimit është vazhduar brenda afateve ligjore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 12.1.: Shoqëria “H.Sh.” ShA. duhet të jetë shumë e kujdesshme në marrëdhëniet me Gjykatat, për arsye se nga mos paraqitja në gjykatë dhe mos parashtrimi i fakteve mbrojtëse për HSH ShA. (prapësimeve ndaj padisë), përbën shkak për humbjen e çështjeve gjyqësore, humbje të cilat ndikojnë negativisht në situatën financiare të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 11 vendime të formës së prerë në vitet 2018, 5-mujori 2019 me vlerë të efektit negativ financiar në shumën 10,953,875 lekë. Ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjykimit, fakt i cili riskon ta rëndojë akoma më tej situatën financiare të shoqërisë në të ardhmen n.q.s këto procese do të fitohen nga ish-punonjësit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 13.1.: Për çështje gjyqësore të hapura në vitet e kaluara me punonjës të larguar, për të cilat konfirmohet se janë çështje të humbura Administratori i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës të njohë provizionet për të gjitha vendimet gjyqësore si ngjarje detyruese të ndodhur para datës së raportimit, për të cilat është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për shoqërinë dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij (Referenca ligjore SKK6).

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, Bankë (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj), u konstatua që:

14. Gjetje nga auditimi.: Shpenzimet e shoqërisë janë rënduar nga vendimet gjyqësore, si pasojë e mos likuidimeve në kohë të faturave ndaj kreditorëve në 1 rast për vlerën 1,655,413 lekë, si dhe për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi në vlerën 3,988,638 lekë në vitin 2012, i marr në zbatim të KPP. Shoqëria ka paguar penalitete për mos likuidim në kohë të faturës (detyrimeve), ndaj operatorit ekonomik “S.ShPK.”, i cili e ka fituar këtë të drejtë me Vendim Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Durrës nr.111, datë 29.01.2018 ku shuma e interesave ligjorë është 1,655,413 lekë.

Po me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.946, datë 26.05.2015, shoqëria është penalizuar në vlerën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi të kryer në vitin 2012, me fond limit 35,000,000 lekë, në të cilën Operatori ekonomik S. ShPK., është shpallur fitues në fazën e parë të vlerësimit të ofertave. Më pas është bërë ankesë nga operatori “Z. ShPK. në KPP, i cili e ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “S.” duke shpallur fitues “Z. ShPK.”. Ky vendim i KPP-së, është ankimuar nga operatori “S. ShPK.” më pas në shkallët e tjera të Gjykimit, i cili ka fituar një dëmshpërblim në shumën 3,988,638 lekë për s’kualifikim të padrejtë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 48-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 14.1.: Nga Administratori i shoqërisë dhe njësia ekonomike, të merren masat që faturat e kreditorëve të likuidohen mbi bazën e kriterit të maturimit kronologjik, duke i trajtuar të gjithë kreditorët në mënyrë të drejtë, duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, nuk kanë të bashkëlidhura listëpagesat, ato mbahen në njësitë respektive. Urdhër transfertat e kryera për pagat e punonjësve për Administratën Qendër dhe Njësitë e tjera, në të gjitha rastet nuk kanë të bashkëlidhur listëpagesat përkatëse si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

dokumentacion justifikues. Theksojmë se listëpagesat mbahen në secilën njësi, pavarësisht se ku bëhet likuidimi, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësit zbatues të cilët kanë hartuar dhe nënshkruar Urdhër Transfertat përkatëse (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 48-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 15.1.: Nga Njësia ekonomike, të marren masat që dokumentacionit vërtetues për kryerjen e shpenzimeve për paga dhe shpërblime ti bashkëlidhet dhe dokumentacioni justifikues i shpenzimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Procedura prokurimi të blerjeve me vlera të vogla, të kryera jo në përputhje me Legjislacionin e Prokurimit Publik, kjo pasi:

-Autoriteti Kontraktor H.Sh. ShA., Durrës i kryen këto procedura pa patur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion, pra janë lidhur kontrata apo janë pranuar fatura tatimore për blerje mallrash apo shërbimesh në nivel të konsiderueshëm në 54% për të gjithë vitin 2018 dhe në 83% për 5-mujorin e parë të vitit 2019.

-Në të gjitha rastet e audituara rezulton se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë, kjo pasi urdhri i prokurimit i shoqëruar me ftesën për ofertë, i cili u drejtohet operatorëve ekonomikë, nuk ka të përcaktuar të dhënat e nevojshme të operatorëve të përzgjedhur, që lidhen me objektin e prokurimit.

-Në 18 raste fatura tatimore e pranuar nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, por nënshkruhet vetëm nga njëri prej anëtarëve apo magazinieri i njësisë, ndërkohë që fatura tatimore duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

-Në të gjitha rastet e audituara, llogaritja e fondit limit të procedurës, nuk është e dokumentuar, pavarësisht se në disa raste komisioni i cili ka llogaritur fondin limit, shprehet se është bazuar në kontrata të mëparshme, apo në testime tregu, në dosje nuk evidentohet asnjë referencë në të cilën është bazuar komisioni për nxjerrjen e fondit limit përkatës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, pika 2, Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pikat 5, 7 dhe 19 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 48-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 16.1.: Administratori i Shoqërisë, Njësia Ekonomike dhe komisioni i blerjeve të vogla të marrin masat e duhura që për shpenzimet për blerjet me vlera të vogla, përpara lidhjes së kontratave, të sigurojnë mjetet e nevojshme financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 16.2.: Komisioni i blerjeve të vogla, në çdo rast, të dokumentojnë mënyrën e llogaritjes së fondit limit duke specifikuar referencat përkatëse, të argumentojë dhe dokumentojë operatorët e përzgjedhur si dhe të nënshkruajë si komisioni i blerjeve të vogla faturat tatimore të pranuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Pagesa nëpërmjet arkës jashtë limitit ditor të pagesave. Rezulton se në 25 raste janë kryer pagesa nëpërmjet arkës me para në dorë duke tejkaluar limitin ditor të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

veprimeve në arkë, kryesisht për likuidim faturash telekom, shërbime postare, fatura uji dhe likuidime për shpenzime blerje me vlera të vogla. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 64 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 48-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 17.1.: Nga Administratori i Shoqërisë, të nxirret akti përkatës (vendimi/ose urdhri) për vendosjen e limitit ditor të veprimeve që do të kryhen për pagesat nëpërmjet arkës, gjithashtu ky akt t’u vihet në dispozicion të gjitha Njësive të shoqërisë H.Sh. ShA. për zbatim.

Menjëherë

Nga auditimi i mbajtjes së evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:

18. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, huatë afatgjata dhe huat e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,258,197 mijë lekë. Në këtë shumë Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Siç përmendet në shënimin nr.11, Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Për më tepër, në lidhje me detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, bazuar në shkresën me numër protokoll 505 të paraqitur nga shoqëria, pretendimet aktuale nga hekurudhat e huaja përveç shumës së principalit, janë 1,140,580 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pallogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, çka mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 18.1.: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

Brenda datës 31.12.2019

19. Gjetje nga auditimi:-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “H.Sh.” ShA., Durrës. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore për vitin 2018 është në vlerën 382,798,300 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 34% për vitin 2018, e zënë kërkesat e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 47,823,005 lekë dhe Tvsh me saldo debitore në vlerën 53,242,511 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH.A DURRËS

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2018, kjo gjendje paraqitet në vlerën 47,823,005 lekë. Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 1,148,514,060 lekë. Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitorë zë 18 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 18% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 32% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 55% për vitin 2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 19.1.: Organet Drejtuese të Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës., (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare nuk është pasqyruar penaliteti që ka Shoqëria “H.Sh.” ShA. që vjen si pasojë e mos likuidimit të detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja lidhur me transportin e mallrave për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e H.Sh.. Pasqyrimi në kontabilitet dhe pasqyrat financiare bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit) pa u llogaritur kamatëvonesat. Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 20.1.: Nga Administratori i Përgjithshëm, Njësia Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatë vonesave për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja, konformë udhëzimeve të kodeve UIC 304 dhe 311, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Brenda datës 31.12.2019

21. Gjetje nga auditimi: H.Sh. ShA., në sistemin kontabël që përdor përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 21.1.: Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Brenda datës 31.12.2019

22. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë jashtë bilancit në shumën 3,274,893 mijë lekë paraqitet vlera e aktiveve afatgjata materiale të cilat priten ti transferohen Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

edhe në pozicionin financiar nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 22.1.: Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës 3,274,893 mijë lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale të cilat janë në proces transferimi ndaj Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Brenda datës 31.12.2019

23. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, aktivet afatgjata materiale paraqiten në vlerën 84,156,200 mijë lekë (2017: 84,941,444 mijë lekë), Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve të veta. Aktivet afatgjata materiale, sipas politikave kontabël mbeten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. SKK 5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale” kërkon që nëse një kompani zgjedh modelin e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-ve do të kryhej në datën e raportimit. Rivlerësimi më i fundit i aktiveve të shoqërisë daton në vitin 2013; 5 vjet më parë dhe normat e amortizimit të aplikuara nga shoqëria gjatë 2018 janë ato të miratuara me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 24, datë 18.12.2006 të 11 viteve më parë. SKK 5 kërkon kryerjen e një testi zhvlerësimi në datën e mbylljes së bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies së vlerës, e cila nuk është kryer nga shoqëria. Grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë efektet që ky vlerësim do të kishte në pasqyrat financiare. Aktualisht Shoqëria është në proces rivlerësimi të aktiveve, kjo sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarit me nr.120 datë 11.10.2018. Sipas kontratës së lidhur me grupin e eksperteve të miratuar për këtë qëllim, procedura e rivlerësimit pritet të përfundojë brenda vitit 2019. Veprime në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr.5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale”, Ligjin nr.33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 56-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 23.1.: Nga Shoqëria të merren masa që pasuritë e patundshme troje dhe ndërtesa të mbështeten plotësisht në dokumente pronësie ,duke sjellë në këtë mënyrë, paraqitje të plotë dhe të saktë të vlerës së trullit në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria “H.Sh. ” ShA. Durrës, asetet nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 në faqet 100-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 24.1: Nga Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 30.06.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” SH.A DURRËS

Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që.

25. Gjetje nga auditimi: Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të ardhurat në përgjithësi janë korrekte dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Dobësitë e identifikuara në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit dhe kontabilitetin, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë, si psh harxhimin e karburantit për shkak të makinerive të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, dëmshpërblimet nga zgjidhjet e pa arsyeshme të kontratave të punësimit, transportit të mallrave dhe mungesën e një rregulloreje për provizione etj.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nuk ka ndërmarr *aktivitete shitesë* për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut, pasi.

- Gjurmët e auditimit nuk janë hartuar, miratuar dhe arkivuar nga çdo njësi biznesi.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, funksionon në nivel Drejtorie, por jo për çdo njësi biznesi, si dhe regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi biznesi.

-Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Sektorët nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Ka struktura të tepërta që duhet të suprimohen.

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës.

-Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe janar-maj 2019 me vendimin nr.7 datë 08/05/2019 i cili përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 gërma a.

-Kontabiliteti i njësisë mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve nuk janë hartuar nga çdo njësi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 në faqet 95-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 25.1: Për forcimin e performancës së shoqërisë, duke siguruar se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit, që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të marr masa për:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

- Funkcionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik si në nivel të Drejtorie, ashtu edhe për çdo njësi biznesi.
- Të hartuar, regjistrin e riskut nga çdo njësi biznesi, si dhe miratuar dhe arshivuar gjurmët e auditimit nga çdo njësi biznesi.
- Përmirësim e strukturës organizative, ku sektorët të organizohen në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj, të suprimohen strukturat e tepërta, si dhe klasifikimi i punonjësve, përveçese të lidhet ngushtësisht me detyrat që i ngarkohen secilit të emëruar sipas pozicionit përkatës, por dhe me masën e shpërblimit, pasi ky është dhe qëllimi i klasifikimit, pasi pozicioni i punës përbën një shërbim ose punë që kryhet kundrejt pagës së merituar.
- Shpenzimet e karburantit të mos administrohen nga NjBU, por të krijohet një strukturë e veçantë nën varësinë e Njësisë Ekonomike, e cila të merret me llogaritjen e nevojave për karburant, ndjekjen e kontratës, magazinimin, shpërndarjen, zberthimin e grafikut të lëvizjes dhe dokumentimin e tij, kontrollin e konsumit sipas normativave etj.
- Të rishikohet niveli i pagës së sektorit të Auditit të Brendshëm, duke e konsideruar si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bën. Ky sektor auditon punën e Drejtuesve të Njësisë, shefave të sektorëve etj, por pagesa e tyre është shumë më e ulët se paga e personave që auditojnë.
- Regjistrat themeltarë të aktiveve duhet të hartohen nga çdo njësi, si dhe të merren masa për marrjen në dorëzim, inventarizimin dhe daljen nga përdorimi të aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, u konstatua që:

26. Gjetje nga auditimi: Kontratë qiraje pa nr.prot, e lidhur në datë 28.12.2017 ndërmjet M.D. me vendndodhje në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe NJMBI me objekt marrje me qira ambienti për magazinë me sipërfaqe 200 m² dhe me sipërfaqe funksionale 5m². Kjo kontratë është përpiluar në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Kontrata është lidhur ndërmjet Drejtuesit të Njësisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore dhe M.D. me një afat kohor 1 vjeçar, duke e përjashtuar nga procesi i konkurrimit. Kontratë nr.20 datë 03.12.2018 lidhur midis NJMBI dhe A.T. sipërfaqja në bazë të gentplanit përkatës për objektin e marrë me qira por, mungojnë fotot, plan biznesi, dhe procesverbali i dorëzimit të objektit. Sipas gent planit rezulton se objekti është 592.2 m², i ndarë në 4 seksione me sipërfaqe S1=222.3 m², S2=200 m², S3=83.5 m² dhe S4=86.4m². Ndërkohë që në kontratë nuk specifikohet se cili seksion është dhënë me qera.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, pika 6/b) dhe me paragrafin II, pika 1, germa a) “Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.

- Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave u konstatuan rastet e kontratave të cilat nuk i kanë plotësuar dokumentet sipas kërkesave ligjore konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Për kontratën e qerasë nr.5 datë 04.04.2018 protokolluar me nr 337/1 datë 04.04.2019 lidhur ndërmjet E.K. me vend ndodhje në Stacionin Hekurudhor Elbasan dhe Administratorit të Shoqërisë H.Sh. ShA., foto, dhe gentplani i konfirmuar nga prefektura.

Për kontratën e qerasë nr.12 datë 12.11.2018 midis NJBMI dhe zA.D. me vend ndodhje në Stacionin Hekurudhor Dushk-Lushnje me afat 1 vjeçar mungojnë foto. Gjithashtu konstatohet se në asnjë dosje nuk u gjenden procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit.

Mungojnë gentplanet e objekteve të kërkuara, konfirmimi nga ZVRPP përkatëse dhe nga sektori i menaxhimit të kontratave nuk janë ushtruar kontrole periodike për asnjë kontratë në ambientet e dhëna me qira mbi zbatimin e kushteve të kontratës dhe nuk janë verifikuar informacionet e shfave të nën njësive rajonale në terren (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 në faqet 100-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 26.1: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat për zbatimin e kriterëve të konkurrimit të drejtat kompetencat dhe afatet në dhënien me qira ose emfiteozë me qëllim shmangien e diskriminimit duke krijuar kushtet për konkurrim.

Në vijimësi

Rekomandimi 26.2: Nga Drejtuesi i NJBMIH, Sektori Juridik dhe Sektori i kontratave, të merren masat e duhura për ushtrimin e kontroleve përkatëse ndaj operatorëve të cilët kanë marrë ambiente me qira pronë e H.Sh. ShA., duke verifikuar dhe plotësuar të gjithë dokumentacionin ligjor të dosjeve të kontratave të qirave. Gjithashtu hartohet një program i detajuar vjetor mbi ushtrimin e kontroleve periodike dhe të merren masat përkatëse për këto subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga auditimi i hartimit, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre, u konstatu që:

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që H.Sh., ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve,.

Janë kontabilizuar vetëm principiali mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë dhe jo penalitetet.

- Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA., Durrës. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penalitetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “H.Sh.” ShA. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penalitetet 211,431 euro.

- UIC (International union of railëays) dhe SK (serbia cargon) kanë organizuar në 18/09/2018 forumet e debitorëve/kreditorëve, për të cilat janë kërkuar borxhet e hekurudhave të Byroja e borxheve (Beograd Serbi).

Ministria përgjegjëse merr përsipër administrimin e borxhit sipas Neni 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”. Në referencë me nenin 12.4 të ligjit të sipërpërmendur, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar (të përlllogaritur) deri në hyrjen në fuqi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

të këtij ligji. Për këtë qëllim, H.Sh. ka dorëzuar bilancet (31.12.2017) në formë zyrtare pranë Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë, duke përfshirë çështjet e transportit hekurudhor dhe pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si aksionere e vetme e kësaj shoqërie. Deri më datë 31.07.2019, datë në të cilin përfundoj auditimi, borxhet ndaj hekurudha të huaja rëndojnë mbi hekurudhën shqiptare (janë në kontabilitetin e kësaj shoqërie). Nuk ka asnjë veprim konkret, nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11 në faqet 116-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 27.1.: Nga organet drejtuese të shoqërisë ti kërkohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit), si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Ministria monitoruese dhe e hartimit të politikave), rregullimin dhe administrimin e vlerës 1,787.982.7 euro ose 220.686.808 lekë me penalitetet 211,431 euro që përfaqëson detyrimin që Shoqëria “H.Sh.” ShA., Durrës ka ndaj Hekurudhave të Huaja, në zbatim të nenit 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.

Brenda datës 31.12.2019

28. Gjetje nga auditimi.: Përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) është bërë pjesërisht nga punonjësit e H.Sh.. Përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, deri në 31.07.2019 datë në të cilën përfundon auditimi, nuk është bërë e qartë nga punonjësit mënyra e llogaritjes. Përfshirja në kontabilitet ka ndikuar direkt në rezultatin financiar, duke krijuar vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet H.Sh. ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11 në faqet 116-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 28.1.: Të merren masa nga Sektori i Marketingut dhe specialisti i mardhënijeve me jashtë, për kompletimin e dokumentacionit të transportit ndërkombëtar të mallrave, me aktet e rregullores RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të kryhen veprimet financiare dhe kontabël, dhe tu vihet në dispozicion punonjësve që merren me zbatimin e këtyre kërkesave ligjore.

Brenda datës 31.12.2019

29. Gjetje nga auditimi: Përgjithësisht kontratat e lidhura me transportuesit hekurudhor nuk janë plotësuar me të gjitha gjenalitetet konformë kodit civil dhe librit tarifor (Ato nuk kanë të përcaktuar afatin, sasinë, distancë dhe tarifën).

Për vitin 2018 për transportin e mallrave nga Nj.M.B janë lidhur 9 kontrata. Konkretisht:

1. Kontrata me P. lidhur me 27/09/2018 sasia 500 ton, në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 2. Kontrata me A. lidhur me 01/03/2019, nuk përcakton afat, për sasinë 100 ton në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë. 3. Kontrata me M. Konst lidhur më 21/05/2018 nuk përcakton afat për sasinë 12000 ton. 4. Kontrata me A. lidhur më 19/01/2018 sasia 20.000 kg nuk përcakton distancë dhe tarifën për ton/km. 5. Kontrata me K. lidhur më 22/02/2018 për sasinë 40,000 ton, nuk përcakton tarifë transporti. Më datë 02/05/2018 është amenduar. 6. Kontrata me M.-2 lidhur më datë 18/01/2018 sasia 80,000-100,000 ton, nuk përcakton tarifë me afat deri më 31/12/2018 (kjo kompani është tërhequr ka prishur në mënyrë të njëanshme kontratën, por nuk është aplikuar penalitet, pasi kontrata nuk e ka të përcaktuar penalitet). 7.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHOQIPTARE” ShA DURRËS

Kontrata me Pansped lidhur më 25/01/2018 me afat deri më 31/12/2018 sasia 10.000-15.000, nuk ka përcaktuar distancë dhe tarifë (nuk ka të bashkëngjitur librin tarifor). 8. Kontrata me Misped lidhur më 12/01/2018, nuk ka të përcaktuar afat, sasi, distancë dhe tarifë. 9. Kontrata me 16 February lidhur më 12/12/018 me afat 31/12/2018 pa përcaktuar sasi, distancë dhe tarifë.

Për vitin 2019 janë lidhur 3 kontrata me M. 2 data e lidhjes së kontratës 15/01/019, sasia 80,000-100,000 ton, por pa bashkëngjitur tarifën sipas librit tarifor, me Milsped datë e lidhjes së kontratës 01/02/2019 pa sasi dhe distancë dhe me 16 February datë e lidhjes së kontratës 02/03/2019 sasia 30,000-70,000 ton, pa përcaktuar destinacionin (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11 në faqet 116-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 29.1: Nga Administratori i shoqërisë të merret masat që kontratat me transportuesit hekurudhor për përdorimin e rrjetit hekurudhor të maksimalizojnë jo vetëm zbatimin e tarifave në fuqi, por dhe të mos cënohet qëndrueshmëria dhe aftësia konkurruese e transportit hekurudhor të mallrave.

Menjherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në km 138+200 deri në km 138+800, perigoni Bajzë-Hani i Hotit”, nga Shoqëria “G. K. M” ShPK. Ballsh, është përfutur padrejtësisht vlera 531,744 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me punime të likuiduara por të pa kryera. Konkretisht në preventiv specifikohet se materiali mbushës është material shkëmbor çakull ndërsa në specifikime teknike flitet për material mbushës zhavorr lumi. Nga konstatimi në terren u verifikua se materiali i hedhur në vend është zhavorr lumi i papastër i përzier me rërë, material i cili nuk i përmbush kërkesat për qëndrueshmëri të skarpatës dhe të filtrimit ujit. Çmimi i ofertës fituese për këtë zë punimesh është 600 lekë ndërkohë që zhavorri i lumit sipas manualit të çmimeve në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 është 316 lekë.

Gjatë verifikimit të punimeve në terren u konstatua se materiali mbushës nuk është hedhur gjatë gjithë gjatësisë sipas kilometrave të përcaktuar në projekt por vetëm në një zonë rreth 15m të gjatë në një skarpaf afërsisht 10m të lartë. Nga verifikimi është konstatuar se materiali që është hedhur përbën volumn prej 180 m³ dhe vlerën 108,000 lekë pa TVSH, ndërkohë që sasia 220m³ në vlerën 132,000 lekë pa TVSH ose 158 400 me TVSH është zë punimesh i pakryer. Transporti i materialit mbushës për shkak të topografisë së terrenit në këtë pikë është kryer me tren me vagonë vetëshkarkues V.S të cilët kanë një vëllim prej 30 m³. Nga përlllogaritjet rezulton së janë hedhur vetëm 6 vagonë me material mbushës.

Materiali që është hedhur në terren që përbën vëllimin 180 m³ është zhavorr lumi dhe jo çakull dhe duhet konsiderohet me çmimin 316 lekë pra duhet të përbente vlerën 56,880 lekë ndërkohë që kontraktori është paguar me vlerën 600 lekë (180*600 =108,000 lekë) diferenca 51,120 pa TVSH ose 61,344 me TVSH lekë përbën dëm ekonomik.

Gjithashtu është konstatuar se nuk janë kryer gërmime për heqjen e materialit të dobët sipas projektit por materiali mbushës është hedhur direkt mbi skarpaf. 250m³ gërmime në vlerën 150,000 pa tvsh ose 180,000 me TVSH janë punime të pakryera për të cilat kontraktori është paguar. Gjithashtu në zonën e punimeve janë transportuar vetëm 180m³ material dhe jo 400m³ pra vlera e transportimit të materialit është 90,000 lekë dhe diferenca 110,000 pa TVSH ose



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

132,000 me TVSH është zë punimi i pakryer (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 63-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, *arkëtimi i vlerës 531,744 lekë*, nga Shoqëria “G. K. M” ShPK., për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në km 138+200 deri në km 138+800, perigonmi Bajzë-Hani i Hotit vlerë e cila për Shoqërinë “Hekurudhën Shqiptare” ShA., Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Mbrojtja e urës së Drojës”, viti 2018, nga bashkimi i operatorëve “M.” ShPK. Dibër, & K.- D. ShPK. Kruje & E.A. ShPK. Dibër, është përfituar padrejtësisht vlera 470,812. Kjo vlerë ka të bëjë për punime të likuiduara por të pa kryera. Konkretisht në preventivin përfundimtar të punimeve ndodhet zëri “mbushje me zhavorr pas kapërderdhësit” në sasinë 540m³ me çmim 726 lekë dhe vlerë totale 392,040 lekë. Ky zë punimesh nuk figuron fare në vizatimet e projektit pra preventivi nuk përputhet me projektin, në kundërshtim me kushtet teknike të projektimit dhe vendimi nr.68 datë 15.2.2001 për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu procesverbali i punimeve të maskuara i mbajtur me datë 05.10.2018 për këtë proces pune nuk është i shoqëruar me dokumentacion justifikues të punimeve të maskuara në kundërshtim me udhëzim nr.1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të këshillit të ministrave “për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Në specifikimet teknike të projektit cilësohet së pas murit përforcues do të bëhet mbushja me zhavorr lumi deri në kuotën e vendosjes së gabioneve. Mbi gabionet do të hidhet një shtresë betoni C16/20. Në ditarin e punimeve procesi i punës së mbushjes me zhavorr zgjat nga data 1.10.2018 deri në ditën e përfundimit të kontratës. Pra pas mbushjes duhet të ndërtohej pjesa pas kapërderdhësit i murit me gabiona dhe në fund shtresa e betonit C16/20. Rend pune që nuk përputhet me ditarin e punimeve.

Në librezën e masave zëri mbushja me zhavorr pas kapërderdhësit është dhënë në planimetri për çdo sipërfaqe të murit të gabionave në trashësinë 2.2 m pas hedhjes së betonit C16/20.

Mospërputhja e rendit të punës mes librezës së masave, ditarit të punimeve dhe specifikimeve teknike, paqartësia e vendodhjes së mbushjes me zhavorr dhe mungesa e evidencës mbi vendosjen e këtij zëri punimesh çojnë në konkluzionin se mbushja me zhavorr pas kapërderdhësit është një punim i pakryer në vlerën 470,812 lekë.

Nga sa mësipër vlera 470,812 lekë përbën dëm ekonomik për Hekurudhën Shqiptare dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga bashkimi i operatorëve “M.” ShPK. Dibër, K.- D. ShPK. Kruje, dhe E.A. ShPK. Dibër.

Situacioni pjesor nr.1 në dosjen e zbatimit është i pa firmosur nga investitori H.Sh. ShA. dhe nuk mban asnjë datë. Gjithashtu situacioni është firmosur vetem nga operatori M. ShPK. dhe jo nga operatorët e tjerë K.-D. ShPK. Krujë, dhe E.A. ShPK. Dibër respektivisht sipas përqindjeve përkatëse të punimeve. Pa datë është dhe situacioni përfundimtar i cili përsëri është firmosur vetëm nga operatori M. ShPK. dhe jo nga operatorët K.-D. ShPK. Krujë, dhe E.A. ShPK. Dibër respektivisht sipas përqindjeve përkatëse. E njëjta situatë është edhe për kontratën edhe për librezën e masave ku i vetmi që ka firmosur është M. ShPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 63-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Rekomandimi 2.1.: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 470,812 lekë me TVSH**, nga bashkimi i operatorëve “M.” ShPK. Dibër, & K.- D. ShPK. Kruje & E.A. ShPK. Dibër, për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës “Mbrojtja e urës së Drojës”, viti 2018, vlerë e cila për Shoqërinë “Hekurudhën Shqiptare” ShA., Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2019

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje aksesor dhe pajisje hekurudhore” për vitin 2017, nga Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar tenderin dhe është likuiduar nuk provohet (vërtetohet) që pajisjet të janë ato për të cilat shoqëria ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Konkretisht: Me urdhër transfertën datë 27.12.2016 nëpërmjet Raiffeissen Bank është likuiduar Shoqëria “Gj.” ShPK. për vlerën 888,000 lekë. Pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatë cilësie (test raport fabrike), certifikatë sigurie, certifikatë origjine, certifikate euro 1, list paketim, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e certifikatës së cilësisë (test raport fabrike), që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Veprim në kundërshtim me ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë, grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të japë opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Pra në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të jap opinion e Tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmoj që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.

Deri në paraqitjen nga “Gj.” ShPK. të certifikatë cilësie (test raport fabrike), certifikatë sigurie, certifikatë origjine, certifikatë euro 1, list paketim, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “Gj.” ShPK. ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar, vlera 888,000 lekë për Shoqërinë “H.Sh.” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**, dhe n.q.s nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga “Gj.” sh.p.k (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 63-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 3.1: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolauditimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “Gj.” nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje nuk janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës vlera 888,000 lekë** nga Shoqëria “Gj.” ShPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

Brenda datës 31.12.2019

4. Gjetje nga auditimi: Dëmtim të rrjetit Hekurudhor Shqiptar në **vlerën 3,228,427 lekë**, risk i lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të çenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike nga transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK. Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “H.Sh.” dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në **vlerën 3,228,427 lekë**, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi transportuesi hekurudhor “B.C.” ShPK., ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria “H.Sh.” respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 13 në faqet 123-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1: -Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 3,228,427 lekë nga Shoqëria “B.C.” ShPK. Kjo vlerë ka të bëjë me dëmtim të rrjetit hekurudhor gjatë ushtrimit të aktivitetit. Vlera **3,228,427 lekë** përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “H.Sh.” dhe Buxhetin e Shtetit. Në rast mos likuidimi të aplikohen sanksionet përkatëse bazuar në kontratën e nënshkruar me këtë transportues hekurudhor.

Brenda datës 31.12.2019

5. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “H.Sh.” është penalizuar në dy raste në vlerën 3,068,020 lekë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L.G. në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016 në vlerën 1,914,720 lekë, si dhe B.Gj. në vlerën 1,153,300 lekë, veprim në kundërshtim ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 5.1: Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera 3,068,020 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me penalizimin në dy raste të shoqërisë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L.G. në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016, në shumën totale të likuidimit në vlerën 1,914,720 lekë, si dhe B.Gj. në shumën totale 1,153,300 lekë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “H.Sh.” ShA. dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik”.

Brenda datës 31.12.2019

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË
“HEKURUDHA SHQIPTARE” ShA DURRËS

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 11 vendime të formës së prerë në vitet 2018-5-mujori 2019 me vlerë të **efektit negativ financiar në shumën 10,953,875 lekë**. Ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjykimit e cila riskon ta rëndojë akoma më tej situatën financiare të shoqërisë në të ardhmen (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1.: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “H.Sh.”ShA., Durrës, duhet të shqyrtojë efektin financiar në vlerën totale **10,953,875 lekë**, i cili ka ardhur si pasojë e zgjidhjes së pa arsyeshme të kontratës së punësimit të punonjësve.

Brenda datës 31.12.2019

VI. ANEKSET

A. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit
LPP	Ligji prokurimit publik
RRPP	Rregullat e prokurimit publik
HSH	H.Sh.
NJBM	Njësia e biznesit të mallit
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
SK	Serbia cargon
RIV	Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve
UIC	Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK	Standardet kombëtare të Kontabilitetit

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT